# BULETINI I BANKËS SË SHQIPËRISË

## 6-MUJORI I DYTË 2012

*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.*
*Botuar nga: Banka e Shqipërisë,*
*Sheshi "Avni Rustemi", Nr.24, Tiranë.*
*Tel: 355-4-241 93 01/02/ 03; 355-4-241 94 01/2/3;*
*Faks: 355-4-241 94 08*
*E-mail: public@bankofalbania.org*

www.bankofalbania.org

# P Ë R M B A J T J A

*Editorial*
*Ndërtesa e re e Qendrës së Emisionit të Monedhës* 5

*Fjalime e prezantime të administratorëve të Bankës së Shqipërisë* 7
*në aktivitete brenda e jashtë vendit*

*Analiza periodike* 75
*Analiza e ndërmjetësimit financiar, T4 – 2012* 76
*Erjona Suljoti, Sofika Note, Olta Manjani*

*Informacion mbi tregues ekonomikë e monetarë të disa vendeve të Evropës* 84
*Qendrore Lindore dhe Juglindore, T4 – 2012*
*Doriana Lama, Medvin Shehu*

*Analizë e zhvillimeve në sektorin e jashtëm të ekonomisë, T3 – 2012* 95
*Merita Boka, Olti Mitre*

*Studime e artikuj* 105
*Trajnimi, tranzicioni, dhe zhvillimi: Roli i Joint Vienna Institute* 106
*Albina Demollari*

*Shënjestrimi i PBBN-së: Rasti i Shqipërisë* 114
*Endrit Yzeiraj*

*Banka e Shqipërisë në harkun kohor, korrik-dhjetor 2012* 125

*Vendime të politikës monetare* 133

*Ngjarjet juridike, korrik-dhjetor 2012* 134

*Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 31 dhjetor 2012* 143

*Bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga* 144
*Banka e Shqipërisë, deri në 31 dhjetor 2012*

*Publikime të botuara nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2012* 148

# EDITORIAL
# NDËRTESA E RE E QENDRËS SË EMISIONIT TË MONEDHËS

Në kuadër të përmirësimit të standardeve infrastrukturore dhe teknologjike, Banka e Shqipërisë, në datën 26 tetor 2012 inauguroi godinën e re të Qendrës së Emisionit të Monedhës.

Ndërtesa e Qendrës së Emisionit të Monedhës është ndërtuar në frymën e një arkitekture moderne, ku spikasin dy skajet rrethore të saj të cilat simbolizojnë monedhën. Ndërtesa prej një sipërfaqe totale prej 1800 $m^2$, ndodhet në Tiranë dhe operon me një staf prej 43 punonjësish. Ambientet kryesore operacionale të kësaj ndërtese përfshijnë vend-hyrjen e automjeteve të blinduar që realizojnë transportin e parasë, sportelin e kryerjes së veprimeve me degët e Bankës së Shqipërisë dhe bankat tregtare, dhomat kasafortë, sallën e përpunimit të kartëmonedhave, sallën e grirjes *offline* dhe briketimit të kartëmonedhave të dëmtuara, sallën e prodhimit dhe përpunimit të monedhave metalike, laboratorin e Qendrës Kombëtare të Analizës, si dhe sallën e konferencave dhe seminarëve.

Ndërtesa e re karakterizohet nga një nivel i lartë infrastrukture dhe është e pajisur me sisteme teknologjike të përparuara që do të përdoren për përpunimin e parasë. Kështu, sisteme të automatizuara kryejnë përpunimin e kartëmonedhave me shpejtësi deri në 20 kartëmonedha në sekondë. Këto sisteme kontrollojnë kartëmonedhat për autenticitet dhe njëkohësisht veçojnë kartëmonedhat fizikisht të përshtatshme nga ato të papërshtatshme për riqarkullim, kontrolle të cilat mundësohen nga sensorët e avancuar me të cilat sistemet janë pajisur. Kështu, verifikimi i autenticitetit realizohet falë matjeve të përpikta vizuale, si dhe të elementëve magnetikë, fosforeshentë, e infra të kuqe të kartëmonedhave. Kontrolli i përshtatshmërisë mundësohet duke matur dimensionet, ndotjen, njollat, defektet fizikë si vrimat dhe grisjet, degjenerimin struktural të kartëmonedhave nga përdorimi, praninë e shiritave ngjitës, dhe detektimin e mbishkrimeve. Vlen të përmendet që sistemet e përpunimit të instaluar në Qendrën e Emisionit janë të njëjta me ato që përdoren edhe në bankat e tjera qendrore evropiane. Pas përpunimit, kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim kalojnë në sistemin e paketimit, ndërsa kartëmonedhat e dëmtuara asgjësohen në mënyrë automatike. Përsa i përket përpunimit të parasë, është investuar gjithashtu në pajisje të reja përpunuese të monedhave metalike. Në të ardhmen, planifikohet dhe instalimi i një sistemi tërësisht të automatizuar për ambalazhimin e mëtejshëm të monedhave metalike të përpunuara.

Në Qendrën e re të Emisionit është duke u ngritur dhe një laborator modern si pjesë e Qendrës Kombëtare të Analizës. Nëpërmjet këtij laboratori, Qendra Kombëtare e Analizës do të mund të kryejë ekspertime profesionale, duke

analizuar në detaje karakteristikat dhe elementët teknikë të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara si të falsifikuara. Laboratori bashkëkohor nuk do të ndihmojë vetëm në forcimin e luftës ndaj falsifikimit dhe rritjen e sigurisë së parasë shqiptare, por njëkohësisht do të plotësojë dhe një angazhim të shtetit shqiptar në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Kapitulli 32 i kësaj marrëveshjeje, i titulluar "Kontrolli Financiar", përcakton detyrimin e shtetit shqiptar për mbrojtjen e euro-s nga falsifikimi, detyrim i cili përmbushet me ngritjen e kësaj infrastrukture. Gjithashtu, në ambientet e godinës së re, do të zhvillohen seminare informues dhe trajnime për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, bankat tregtare, si edhe për grupe të tjera të interesit.

Me modernizimin e infrastrukturës dhe sistemeve teknologjike të përdorura në përpunimin e parasë do të përmirësohen dhe funksionalitetet dhe do të standardizohen proceset e punës që kryhen në këtë qendër. Përmirësimi i funksionaliteteve në Qendrën e re të Emisionit të Monedhës do të shoqërohet dhe me një kuadër të ri rregullator mbi kontrollin për autenticitet dhe përshtatshmërinë për riqarkullim të kartëmonedhave shqiptare. Ky kuadër rregullator, i cili hyn në fuqi së shpejti, është realizuar duke u përafruar me standardet e vendosura nga Bashkimi Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane. Këto standarde janë të përcaktuara kryesisht në rregulloren EC 1338/2001 "Mbi masat e nevojshme për mbrojtjen e Euro-s ndaj falsifikimit" dhe rregulloren ECB/2010/14, të amenduar në shtator të vitit 2012 me vendimin ECB/2012/19, "Mbi kontrollin për vërtetësi dhe përshtatshmëri dhe riqarkullimin e kartëmonedhave Euro". Rregullorja e re plotëson boshllëkun e kuadrit rregullator mbi pajisjet automatike të përdorura në përpunimin dhe riqarkullimin e kartëmonedhave, si dhe vendos standarde të unifikuara për qarkullimin e kartëmonedhave shqiptare, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga çdo subjekt që trajton dhe përpunon kartëmonedhat.

Në përfundim, me realizimin e Qendrës së re të Emisionit të Monedhës, proceset e përpunimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike, asgjësimit të kartëmonedhave të dëmtuara, lëvizjes së fondeve, si dhe analizimit të parasë së dyshuar si falso në Bankën e Shqipërisë kryhen sipas standardeve të simotrave të saj evropiane. Standardet e reja të përpunimit rrisin cilësinë dhe sigurojnë integritetin e parasë shqiptare në qarkullim.

# FJALIME E PREZANTIME TË ADMINISTRATORËVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIVITETE BRENDA E JASHTË VENDIT

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në tryezën e diskutimit:
"Për një sistem bankar të shëndetshëm dhe eficient në Shqipëri.
Veprimtaritë dhe rezultatet e arritura në kuadrin e Projektit të Binjakëzimit",
4 korrik 2012

Të nderuar pjesëmarrës,

Strategjia e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë përfshin përafrimin e shpejtë të kuadrit institucional, ligjor dhe operacional me standardet më të mira të modelit të Bankave Qendrore të BE-së, në kuadër të prioritetit madhor të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Për të përmbushur këtë sfidë, Banka e Shqipërisë u bë palë në projektin e binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Evropian, i cili synonte përforcimin e kapaciteteve tona institucionale, veçanërisht në fushat e mbikëqyrjes bankare, statistikave, sistemeve të pagesave dhe implementimit të politikës monetare, duke përfituar nga përvoja dhe profesionalizmi i spikatur i Bankës së Italisë dhe Bankës së Francës.

Ky ishte një projekt i vështirë i cili përmbante objektiva sfidues që duhej të realizoheshin brenda një periudhe kohe relativisht të shkurtër. Suksesi i tij do të varej nga angazhimi dhe profesionalizimi i personelit të institucioneve pjesëmarrëse, si edhe aftësia e tyre për të realizuar një bashkëpunim të vërtetë.

Pas rreth 18 muajsh pune të përbashkët intensive, sot kam një kënaqësi të veçante të marr pjesë dhe të përshëndes në këtë aktivitet të rëndësishëm që kurorëzon përfundimin me sukses të projektit të binjakëzimit. Dëshiroj që me këtë rast të shpreh një falënderim të veçantë për të gjithë ekspertët dhe strukturat që u përfshinë në këtë projekt në Bankën e Italisë dhe në Bankën e Francës, për angazhimin dhe profesionalizmin e treguar. Gjithashtu, dua të falënderoj përfaqësuesit e zyrës së Bashkimit Evropian në Tiranë, për mbështetjen dhe kujdesin që treguan lidhur me monitorimin e projektit.

Projekti u bazua në 6 module kryesore të cilët janë:

- Koordinimi i Procesit të Integrimit Evropian
- Edukimi Financiar
- Mbikëqyrja dhe Stabiliteti Financiar
- Sistemet e Pagesave
- Statistikat
- Tregu Ndërbankar

Objektivi i modulit "Koordinimi i Procesit të Integrimit Evropian", u zbatua tërësisht nga Banka e Francës dhe konsistoi në zhvillimin dhe zotërimin e instrumenteve të nevojshëm koordinues të procesit të integrimit evropian me qëllim përgatitjen e takimeve në nivel evropian, si dhe koordinimi i procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Banka e Francës ofroi eksperiencën e saj

në organizimin e takimeve në nivel evropian dhe të administrimit të procesit të përafrimit të legjislacionit bankar me acquis communauitare.

Objektivi i modulit "Edukimi Financiar" konsistoi në zhvillimin e aktiviteteve të punës hulumtuese në këtë fushë, duke u mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe përvojën evropiane. Në zbatim të këtij objektivi, u zhvilluan anketime me qëllim matjen e kulturës së përgjithshme financiare në Shqipëri si dhe matjen e efektivitetit të aktiviteteve edukuese të Bankës së Shqipërisë, për arsimin e mesëm. Duke marrë shkas nga rëndësia në rritje e edukimit financiar në mbarë botën, pjesë e këtij moduli ishte organizimi i një konference të nivelit të lartë, për të sjellë në Shqipëri eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe iniciativat e ndryshme në këtë drejtim.

Statistikat dhe sistemi i pagesave janë dy fusha të tjera në të cilat Banka e Shqipërisë përfitoi nga ky projekt. Realizimi i këtij projekti mundësoi krijimin e një infrastrukture moderne për përpilimin e statistikave të ndryshme makroekonomike në Bankën e Shqipërisë, sidomos në fushën e bilancit të pagesave.

Përsa i përket sistemit të pagesave, projekti realizoi rishikimin e kuadrit rregullativ, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e tij në përshtatje të plotë me direktivat dhe praktikat aktuale të BE-së në këtë fushë. Zhvillimi i mëtejshëm i tregut ndërbankar përfaqësoi një nga komponentët e tjerë të zhvillimit të projektit, duke konsideruar rëndësinë e tij në përmirësimin e mekanizimit të transmetimit të politikës monetare në ekonomi.

Projekti pati një shtrirje të konsiderueshme në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe të stabilitetit financiar.

Ndryshimi i filozofisë mbikëqyrëse filloi në janar të vitit 2010, me krijimin e një strukture të re dinamike të orientuar drejt identifikimit dhe administrimit të rrezikut. Për këtë qëllim, përveç ndërtimit të kapaciteteve njerëzore që do të bënin të mundur aplikimin e saj në praktikë, lindi nevoja e njohjes dhe thithjes në imtësi të standardeve më të mira evropiane. Eksperienca e vyer e Bankës së Italisë si një nga institucionet më prestigjioze në Evropë, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit, bëri të mundur përshtatjen e procesit mbikëqyrës shqiptar me modelet më të mira evropiane.

Pa dashur të detajoj projektet në fjalë, çka do të bëjnë prezantuesit në vijim, do të doja të ndalesha në disa prej momenteve kyçe:

Së pari, është realizuar migrimi nga sistemi aktual i vlerësimit CAMELS drejt një modeli vlerësimi të bazuar në një spektër më të gjerë rreziqesh të veçanta, siç parashikojnë standardet e Bazel II dhe III. Ky ishte procesi më intensiv i këtij projekti, që kërkoi edhe angazhimin maksimal të stafit të Bankës së Shqipërisë përgjatë këtyre 18 muajve. Në përfundim, është realizuar një manual i ri mbikëqyrës me parime dhe metodologji evropiane, i ndarë sipas rreziqeve dhe me sisteme të veçanta vlerësimi. Pjesë e rëndësishme e këtij kuadri mbikëqyrës është përmirësimi i vlerësimit të bankave, përtej shifrave, edhe me kritere cilësore.

Së dyti, u krye rishikimi i rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, projekti i të cilit është hartuar në përputhje me BASEL II dhe Direktivën për Mjaftueshmërinë e Kapitalit. Rishikimi është shoqëruar me prezantimin e metodës standarde për rrezikun e kredisë dhe rreziqet e tregut dhe metodën e thjeshtë dhe standarde për rrezikun operacional.

Për vetë rëndësinë që ka kjo rregullore, aktualisht projekti i saj është duke u diskutuar me industrinë bankare.

Së treti, për të rritur kujdesin ndaj stabilitetit të sistemit financiar, u adoptuan disa teknika të reja që mundësuan vlerësimin më të plotë të rrezikut sistemik, u pasurua ushtrimi i provës së rezistencës me përqasjen "*bottom up*" si edhe u punua për përmirësimin e modeleve të vlerësimit të rrezikut të tërthortë të kredit it.

Të nderuar pjesëmarrës,

Projekti i binjakëzimit përqendroi pjesën me të rëndësishme të burimeve të tij në drejtim të mbikëqyrjes dhe të stabilitetit financiar. Vendosja e këtij prioriteti, përveç motivimit konstant me përsosjen e kuadrit rregullativ, veprimtarinë mbikëqyrëse dhe administrimin e rreziqeve, aktualisht bëhet më i domosdoshëm nga sfidat e shtuara që lidhen me zhvillimet specifike të viteve të fundit.

Më lejoni që në vijim të ndaj me ju qëndrimin e Bankës së Shqipërisë për përballimin dhe kapërcimin e këtyre sfidave.

Për të katërtin vit radhazi, ekonomia shqiptare është nën ndikimin e krizës ekonomike e financiare botërore. Faza e fundit e saj, kriza e borxhit sovran dhe ndërlidhja e saj me bilancet e sistemit financiar, na ka vënë ne në vijën e parë të frontit. Dy partnerët tanë më të mëdhenj tregtarë dhe financiarë, Greqia e Italia, janë ndër shtetet më të prekura prej saj. Edhe në këtë kontekst të pafavorshëm, ekonomia shqiptare ka shënuar rritje dhe ka ruajtur shëndetin e saj financiar e ekonomik.

Agjentët privatë gëzojnë përgjithësisht një pozicion financiar të shëndetshëm, duke ruajtur një nivel relativisht të ulët borxhi dhe norma pozitive kursimi gjatë kësaj periudhe. Sistemi financiar ka vazhduar të kreditojë ekonominë, ndryshe nga vendet e rajonit, ndonëse në ritme më të ngadalësuara dhe me kushte disi më të shtrënguara.

Ky reagim, i mbështetur nga një kuadër rregullator i përshtatshëm dhe fleksibël, ka qenë përcaktues në nxitjen e ristrukturimit të ekonomisë drejt sektorëve më fitimprurës. Duke parë nga e ardhmja, Banka e Shqipërisë vlerëson se rreziqet kryesore që kërcënojnë stabilitetin ekonomik të vendit lidhen me rritjen ekonomike.

Një sërë sinjalesh, që vijnë si nga sektori real ashtu dhe nga ai financiar, tregojnë se tkurrja e bilanceve të konsumatorit dhe ngadalësimi i investimeve, të përdorura deri tani nga agjentët ekonomikë privatë si masa mbrojtëse ndaj

krizës, mund të kthehen në dëm të prospektit afatmesëm të rritjes ekonomike. Tendenca e kursimit dhe e shtyrjes së investimeve rrezikon të ndikojë avantazhet konkurruese të ekonomisë dhe potencialin e rritjes së saj. Nga ana tjetër, procesi i *deleveraging*, i nxitur më së shumti nga kërkesa rregullatore që nuk lidhen me gjendjen e ekonomisë vendase, mund të dëmtojë kanalet e instaluara të financimit për ekonominë, që deri tani kanë qenë një komponent i rëndësishëm i rritjes.

Banka e Shqipërisë gjykon se situata aktuale kërkon vëmendje dhe kurajë më të madhe nga të gjithë agjentët ekonomikë, në drejtim të marrjes së vendimeve të duhura të zhvillimit dhe në përgjigje të sfidave që vijnë nga mjedisi i jashtëm.

Në një nivel më të përgjithshëm, Banka e Shqipërisë beson se zbatimi i politikave të përshtatshme makroekonomike, duke harmonizuar politikat monetare dhe fiskale, është parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit.

Ato duhet të kenë dy komponentë kryesorë: e para të mbështesin rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit, dhe e dyta, të orientojnë zhvillimin afatgjatë nëpërmjet nxitjes së reformave strukturore.

Banka e Shqipërisë vlerëson se ekonomia shqiptare është një ekonomi fleksibël, me një infrastrukturë të shërbimeve bazë, të shërbimeve financiare dhe të ambientit rregullator në rritje e përmirësim të vazhdueshëm, si dhe me një fuqi punëtore konkurrues në terma të kostos dhe me kualifikim në rritje. Megjithatë, një sërë treguesish të shkallës së konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare tregojnë se kemi ende shumë punë për të bërë në këtë drejtim, për të përballuar konkurrencën në nivel rajonal e global.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë është angazhuar në ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar të ekonomisë. Ne synojmë të realizojmë në mënyrë të vazhdueshme këtë objektiv nëpërmjet:

a) një politikë të kujdesshme monetare, duke arritur t'i sigurojmë ekonomisë shqiptare një nivel të qëndrueshëm çmimesh, duke respektuar objektivin tonë të inflacionit dhe duke ankoruar pritjet afatgjata të ekonomisë.

Kjo ka bërë të mundur rritjen e hapësirës për të harmonizuar më mirë stimulimin afatshkurtër të aktivitetit ekonomik me qëndrueshmërinë afatgjatë të saj. Në përgjigje të goditjeve që pësuam, ne kemi ndjekur një politikë monetare progresivisht lehtësuese duke filluar nga viti 2009. Kjo politikë monetare i ka sjellë normat bazë të interesit në nivelin e tyre më të ulët historik, në nxitje të konsumit e të investimeve në vend. Gjithashtu, nënçmimi i kursit nominal e real të këmbimit ka ofruar një kanal tjetër stimulimi për ekonominë shqiptare, duke nxitur eksportet dhe duke dekurajuar importet. Ne kemi përshtatur në vazhdimësi kuadrin e operacioneve tona monetare, duke garantuar një furnizim në rritje të ekonomisë me likuiditet kundrejt një baze të zgjeruar kolaterali dhe me afate maturimi në rritje. Duke ndjekur

gjendjen aktuale të ekonomisë shqiptare, ne besojmë se kahu i politikave makroekonomike duhet të jetë stimulues edhe në të ardhmen. Nevoja për politika ekonomike stimuluese kushtëzohet në radhë të parë nga fakti se ekonomia shqiptare është duke operuar nën potencialin e saj, si pasojë e pamundësisë së kërkesës për të garantuar shfrytëzim të plotë të kapaciteteve. Në radhë të dytë, ajo mundësohet nga rreziqet e kontrolluara afatshkurtra e afatmesme mbi stabilitetin ekonomik.

Në kuadër të harmonizimit mes politikës fiskale dhe monetare, Banka e Shqipërisë ka mbështetur orientimin në rritje të politikës fiskale drejt konsolidimit buxhetor. Në përgjigje të progresit në këtë drejtim, ne mbetemi të gatshëm të reagojmë në një kohë të shkurtër ndaj çdo nisme konsoliduese të sektorit publik. Masat tona lehtësuese do të mbeten brenda kuadrit ligjor të instrumenteve të Bankës së Shqipërisë dhe do të jenë në përputhje me filozofinë e konsoliduar të veprimit të bankave qendrore.

Politika monetare mund të ketë sukses, vetëm nëse mekanizmi i transmetimit të saj në ekonomi është funksional. Në këtë kontekst, sistemi bankar ka një rol mjaft të rëndësishëm, si hallka e parë e mekanizmit të transmetimit.

b) një politike të kujdesshme mbikëqyrëse e rregullatore, duke mundësuar ruajtjen e bilanceve të shëndosha të sistemit financiar dhe të sektorit privat të ekonomisë. Në sajë të marrjes në kohë të masave për kontrollin e rreziqeve të kredisë, të kapitalit dhe të likuiditetit, ekonomia shqiptare i ka rezistuar me sukses goditjes së ardhur nga tregjet financiare botërore dhe tashmë paraqitet me një stabilitet financiar të konsoliduar dhe me një sistem bankar të aftë për të bërë detyrën e tij të mbështetjes me kredi të ekonomisë shqiptare.

Ruajtja e qëndrueshmërisë së sektorit bankar, përbën një nga dy prioritetet bazë të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë. Për këtë arsye, përfitoj nga rasti t'i tërheq vëmendjen drejtuesve të industrisë bankare, që të angazhoheni maksimalisht, për të vepruar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullativ mbikëqyrës, duke respektuar njëkohësisht dhe standardet e drejtimit të shëndoshë të veprimtarisë bankare.

Objektivi ynë kryesor vazhdon të mbetet i pandryshuar dhe të ruhet i pacënuar duke forcuar më tej besimin e publikut në sektorin bankar. Për këtë qëllim, sistemi bankar duhet të:

- Të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme përshtatshmërinë dhe të synojë forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Të fuqizojë në vazhdimësi kapacitetet për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut;
- Të ruajë me çdo kusht treguesit e kapitalit dhe të likuiditetit në nivele të përshtatshme. Për këtë qëllim, sistemi duhet të monitorojë në bazë ditore, ecurinë e detyrimeve të bankës, me qëllim për të krijuar dhe ruajtur madhësinë e nevojshme të aseteve likuide për shlyerjen e tyre;
- Të faktorizojë në kërkesat për kapital, zhvillimet e pritshme në të ardhmen. Injektimi i kapitalit shtesë nga aksionerët duhet të marrë

në konsideratë krijimin e një "zone" sigurie në vlerën e kapitalit, ndaj zhvillimeve të papritura në të ardhmen. Për këtë arsye, bankat duhet të interpretojnë në mënyrë të kujdesshme kërkesat për shpërndarje të fitimit në formën e dividentit.

Ecuria e cilësisë së kredisë përfaqëson problemin kryesor me të cilin ndeshet aktualisht sektori bankar. Rritja e kredive me probleme rrit nivelin e stresit në veprimtarinë bankare dhe ul kontributin e sektorit në ndërmjetësimin financiar dhe mbështetjen e rritjes ekonomike në vend. Banka e Shqipërisë e ka ndjekur me shqetësim këtë situatë duke u fokusuar në drejtimet e mëposhtme:

- Evidentimin sa më të saktë të problemit, nëpërmjet kryerjes së inspektimeve dhe verifikimit të procedurave me të cilat bankat vlerësojnë cilësinë dhe kategorizojnë kredinë;
- Krijimin e fondeve përkatëse rezervë në madhësinë dhe në kohën e nevojshme;
- Nxitjen që bankat të trajtojnë problemin përmes nismave më të vendosura për ekzekutimin e kolateraleve të kredive të humbura.

Vlerësimi ynë ka qenë dhe mbetet se vetëm në këtë mënyrë krijohen kushtet për njohjen dhe trajtimin më të shpejtë të problemit, duke shmangur shtrirjen e tij në kohë dhe duke zvogëluar pasiguritë për të ardhmen.

Industria bankare ka shtuar reagimet për një rishikim të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, me qëllim zbutjen e tij në trajtimin e kredive me probleme. Banka e Shqipërisë është e hapur të konsiderojë çdo propozim të vlefshëm dhe realist të industrisë bankare në këtë drejtim, për sa kohë që ato nuk sjellin dobësim të aftësisë së sektorit bankar në një situatë me zhvillime të paqarta.

Duke u ndalur më konkretisht në disa opinione të kohëve të fundit, ne e vlerësojmë të papërshtatshme kërkesën e bërë për një provigjionim në vlera më të ulëta pasi kemi të bëjmë me një përmirësim jorealist të pozicionit të kapitalizimit të veprimtarisë.

Përfitoj nga rasti të sqaroj opinionin publik se në këtë drejtim, normat e aplikuara prej nesh janë plotësisht të përputhura me eksperiencat e vendeve të tjera dhe në disa raste ato janë më të ulëta.

Banka e Shqipërisë vlerëson se kuadri aktual rregullativ krijon hapësirat e nevojshme për sistemin bankar që të asistojë klientët e mirë, që përballen me vështirësi të përkohshme në situatën aktuale. Kjo asistencë mund të vijë në forma të ndryshme duke përfshirë edhe ato të ristrukturimit në mënyrën më të përshtatshme për palët. Për këtë çështje, Banka e Shqipërisë do të vlerësojë mundësitë dhe format që ky proces të bëhet më stimulues edhe për bankën.

Për sa i takon marrjes në konsideratë të vlerës së kolateralit për uljen e vlerës së aktiveve me rrezik të bankave, Banka e Shqipërisë mbetet e opinionit që përqendrimi i kolateralit në formën e pasurisë së paluajtshme si edhe vështirësitë që ende ndeshen në ekzekutimin e tij dhe rekuperimin e vlerës së kredisë së humbur, e zhvlerësojnë që në nisje një nismë të tillë.

Është e nevojshme që disa përmirësime të kuadrit ligjor dhe rregullativ, siç janë tashmë të identifikuara nga grupet e përbashkëta të punës me industrinë bankare, të zbatohen me korrektësi, në mënyrë që kolateralit të fitojë vlerën e tij optimale.

Në përfundim, industria bankare duhet të dëshmojë se është aktive në trajtimin e kredive me probleme dhe çlirimin e burimeve në bilanc për mbështetjen e mëtejshme të veprimtarisë. Kjo është edhe forma më e mirë për të testuar mundësitë reale që ekzistojnë, të cilat më pas mund të mbështeten edhe nga ndryshimet e kujdesshme të kuadrit rregullativ mbikëqyrës. Qëllimi ynë i përbashkët është që vlera e kredive me probleme të ndërpresë rritjen e saj si edhe të përmirësohet gradualisht. Në sektorin bankar ka banka që falë një pune të kujdesshme në 2-3 vitet e fundit në marrëdhënien me klientët e tyre kanë arritur të ulin ndjeshëm raportin e kredive me probleme, duke vijuar me ritme të kënaqshme kreditimin. Mënyra e organizimit dhe e drejtimit të punës së tyre, duhet të jetë një shembull për bankat e tjera në sektorin bankar.

Të nderuar pjesëmarrës,

Kuadri ligjor dhe ai rregullativ që kemi ndërtuar deri më tani është i plotë dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. Sigurisht, që si në çdo fushë tjetër ai është subjekt i nevojës për përmirësim të vazhdueshëm. Megjithatë, opinioni ynë i konsoliduar është se të gjithë NE dhe faktorët e përfshirë duhet të ezaurojmë në maksimum të gjithë hapësirat që ekzistojnë para nesh dhe sigurisht dora dorës do të hedhim hapa të tjerë për të reformuar më tej kuadrin institucional dhe atë ligjor. Më konkretisht, industria bankare dhe komuniteti i biznesit duhet të punojnë më ngushtë me njëri-tjetrin. Besoj që ka shumë hapësirë për një mirëkuptim dhe bashkëpunim më të frytshëm. Biznesi dhe sektori bankar të dalin nga transhetë dhe të kooperojnë konkretisht për sfidat e së ardhmes.

Aktualisht sistemi bankar është i gatshëm të rrisë mbështetjen e ekonomisë me kredi. Ky fakt m'u konfirmua edhe në takimin e para dy ditëve me drejtuesit e pesë bankave më të mëdha. Personalisht e kam nxitur sistemin bankar për një përqasje më aktive ndaj kreditimit.

Më besoni që bëhet fjalë për një sfidë të vërtetë, ku janë përfshirë shumë institucione dhe grupe interesi. Për këtë arsye, do t'i ftoja të gjithë aktorët e tjerë të jenë mendjehapur dhe shumë bashkëpunues në këtë drejtim me qëllim rilançimin e kredisë për ekonominë.

Së pari, do t'i sugjeroja komunitetit të biznesit të jetë më kreativ, më transparent dhe më formal në aktivitetin e tij. Ai duhet të respektojë me përpikmëri të gjithë detyrimet kontraktuale që lindin nga marrëdhënia me sistemin bankar. Kjo është e domosdoshme të kuptohet dhe të pranohet në masë të gjerë. Është i domosdoshëm një proces korrektimi në ekonomi, i cili para së gjithash do të nënkuptonte një ribalancim të çmimeve. Nuk mund të ketë ulje të kredive me probleme, rritje të kredisë për ekonominë, shëndoshje të bilanceve të bizneseve dhe të bankave, për aq kohë sa nuk do të kemi

ekzekutim të kolateraleve dhe për rrjedhojë korrektim të çmimeve të aseteve fikse. Ky proces do të çlironte burime financiare shumë të mëdha që do të ishin një serum jetik parash të freskëta për t'u injektuar sërish në ekonomi. Me para të freskëta duhet të nxisim medoemos krijimin e iniciativave të reja, efektive dhe me kthim të shpejtë mbi investimin.

Një nga mësimet e nxjerra nga kriza është që çdo para e re e shëndetshme të shkojë në një iniciativë biznesi të shëndetshëm. Aktualisht, duhet të nxisim medoemos sektorët prodhues me produktivitet të lartë. Vetëm në këtë mënyrë do të sigurojmë rivitalizimin e ekonomisë për ta bërë atë partnere të denjë evropiane.

Së dyti, do të kërkoja nga sistemi bankar që të jetë më dinamik dhe në kërkim të vazhdueshëm të mundësive që meritojnë të mbështeten me financim. Ofroni paketa financimi të besueshme, duke vendosur prioritet shëndoshjen ekonomike të vendit, e cila në kthim do të garantonte dhe suksesin afatgjatë të biznesit tuaj. Bëni çmos që të rrisni autoritetin dhe aftësinë lobuese me ekzekutivin shqiptar, me parlamentin dhe sistemin e drejtësisë. Shtoni kontaktet me shoqatat e biznesit dhe analizoni rast pas rasti çdo pretendim apo kërkesë që ngrihet qoftë dhe nga një biznes i vetëm. Mbani qëndrim publik për çdo rast në mënyrë që shkalla e spekulimit dhe abuzimit me të vërtetën të ulet në maksimum. Angazhoni të gjithë arsenalin tuaj financiar, njerëzor, mediatik për një ankorim më solid të pritshmërive tuaja me publikun. Bëjeni publikun ankorën tuaj më të fuqishme.

Së treti, do të dëshiroja që ekzekutivi shqiptar të rrisë besimin dhe mbështetjen ndaj sistemit bankar, veçanërisht përsa i përket finalizimit të ndryshimeve ligjore që lidhen me ekzekutimin e kolateralit.

Bashkëpunimi mes organeve shtetërore dhe sistemit bankar mund të jetë i frytshëm edhe në një drejtim të prezantimit më specifik të programeve zhvilluese dhe të mbështetjes me ndihmë financiare dhe koncensionare për sektorë, degë, operatorë të rëndësishëm, përfshirë dhe investitorët e huaj.

Së katërti, do ta vlerësoja jetike një mirëkuptim dhe konsensus të gjerë të të gjithë spektrit politik në mbështetje të përpjekjeve dhe lëvizjeve të Bankës së Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makrofinanciar të vendit. Ne mbetemi të hapur që të shpjegojmë në vazhdimësi, me transparencë dhe në mënyrë të përgjegjshme vendimmarrjen tonë institucionale të kaluar si dhe atë që do të vijojë në të ardhmen. Ne mbetemi të pandryshuar në qëndrimin tonë se një bankë qendrore është e suksesshme dhe gëzon besimin e publikut kur vendimmarja e saj është e pavarur, largpamëse dhe plotësisht transparente. Në kohët që jetojmë, parësore për Bankën e Shqipërisë është garancia e padiskutueshme që ajo i jep publikut për stabilitetin makro - financiar të vendit.

Së pesti, do të inkurajoja median vendase dhe atë të huaj që të vazhdojnë si deri më sot, të pasqyrojnë me vërtetësi dhe në kohë reale zhvillimet ekonomiko financiare të vendit, ku një pjesë të rëndësishme zë dhe aktiviteti i Bankës së Shqipërisë dhe sistemi financiar.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, do të doja që publiku i gjerë shqiptar të vazhdojë të tregohet i matur dhe besimplotë ndaj arkitekturës financiare që kemi ndërtuar. Është për t'u përshëndetur kujdesi i shtuar i tij, i cili pasqyrohet në prirjen për të rritur kursimet. Për rrjedhim, bilanci i individëve vazhdon të jetë pozitiv, një tregues ky që përçon sinjale të qarta për një konsum potencial në rritje në të ardhmen e afërt dhe atë më të largët. Përfitoj nga rasti të përsëris edhe njëherë që me qëndrimin tonë optimist t'i japim formë të tashmes dhe të ardhmes sonë. Ne vlerësojmë se ka ardhur momenti që sentimenti konsumator i popullatës të fillojë rritjen. Kjo do të krijonte atë reaksion zinxhir aq të dëshiruar të përshpejtimit të qarkullimit të parasë dhe mallrave në ekonomi duke mundësuar kështu gjallërimin e aktivitetit ekonomik të vendit në parametrat e parakrizës.

Në përfundim, le të shërbejë ky takim i sotëm si një forum i hapur për të gjithë aktorët institucionalë, në veçanti organet legjislative dhe gjyqësore për sa i përket ekzekutimit të kolateraleve. Bashkëpunimi i politikës, i institucioneve shtetërore dhe sistemit bankar, nga njëra anë dhe publikut të gjerë, nga ana tjetër, është i domosdoshëm dhe do ta konsideroja një sfidë kombëtare, garanci për qëndrueshmërinë e sistemit bankar në të ardhmen dhe nxitjen e rritjes afatgjatë ekonomike të vendit.

Më lejoni që edhe një herë të shpreh vlerësimin tim personal dhe të Bankës se Shqipërisë, për Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës, për ndihmën dhe partneritetin që treguan gjatë projektit të binjakëzimit. Në fund të realizimit të këtij projekti, Banka e Shqipërisë ka përmirësuar kuadrin organizativ dhe atë operacional të departamenteve të saj kryesore, duke iu afruar kështu simotrave të saj evropiane.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën e nivelit të lartë të organizuar nga
Joint Vienna Institute me rastin e 20 vjetorit të krijimit,
12 korrik 2012

Të nderuar zonja e zotërinj,

Është një nder dhe privilegj për mua të përshëndes këtë konferencë që shënon përvjetorin e 20-të të Joint Vienna Institute. Është gjithashtu kënaqësi e madhe për mua, që më jepet mundësia të ndaj me ju mendimet e mia, lidhur me zhvillimet aktuale globale dhe implikimet e tyre për ekonomitë tona.

Pavarësisht nga disa episode të caktuara të çrregullimeve dhe zhbalancimeve, pjesa më e madhe e dy dekadave të fundit është karakterizuar nga një angazhim i përgjithshëm politik drejt tregut të lirë dhe reformave në mbarë rajonin e Evropës Juglindore. Për pasojë, të gjitha ekonomitë shënuan arritje të jashtëzakonshme, të cilat çuan në konvergjencë të shpejtë dhe të qëndrueshme. Këto zhvillime u mbështetën nga një angazhim i ngjashëm nga ana e sektorëve publikë dhe atyre privatë të BE-së, veçanërisht nga sektori financiar, drejt ekonomive të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Shqipëria, deri tani, është një nga këto histori suksesi. Për 20 vite me radhë, vendi ynë ka ndërmarrë reforma të konsiderueshme, me qëllimin e vetëm të afrimit me familjen e bashkuar evropiane.

Nga reformat e dhimbshme të liberalizimit të gjerë të çmimeve, të pasuara nga fillimi i zbatimit të një regjimi të lirë të kursit të këmbimit dhe liberalizimi i plotë i llogarisë korrente dhe i asaj kapitale, e deri tek reformat më të sofistikuara aktuale, Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në drejtim të vendosjes së demokracisë dhe të parimeve të tregut të lirë.

Në pjesën më të madhe të kësaj periudhe, aktiviteti ekonomik ka qenë i qëndrueshëm dhe treguesit kryesorë, si inflacioni, deficiti buxhetor, kursi i këmbimit dhe norma e papunësisë, kanë pasur një ecuri pozitive, duke siguruar një mjedis makroekonomik të shëndoshë dhe të qëndrueshëm. Sistemi financiar është bërë faktor i rëndësishëm në mbështetjen e aktivitetit ekonomik.

Industria bankare, segmenti mbizotërues i sektorit financiar, ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimet e përgjithshme, duke rritur ndjeshëm ndërmjetësimin financiar. Procesi ka reflektuar dhe është dominuar nga përfshirja e grupeve të rëndësishme bankare evropiane që veprojnë në Shqipëri, si dhe në vende të tjera të Ballkanit.

Pas kësaj tabloje të shkurtër, më lejoni të bëj disa komente mbi sfidat e fundit dhe vështirësitë, me të cilat po përballen ekonomitë tona.

Viti i kaluar dhe gjysma e parë e këtij viti treguan se kriza që filloi në vitin 2008 ka arritur në fazën e saj më akute, e karakterizuar nga një lidhje e ndërsjellë midis borxhit sovran dhe krizës së sistemit bankar.

Për analogji, do të doja të përdorja titullin e filmit të paharrueshëm "Armiku tek Porta", për të përshkruar situatën e rënduar në rajonin tonë, e veçanërisht në Shqipëri, si rezultat i gjendjes së vështirë ekonomike të fqinjit tonë jugor, Greqisë, si dhe të situatës në Itali dhe në pjesën tjetër të Evropës. Rreth 80% e shkëmbimeve tona tregtare dhe financiare kryhen me këto vende.

Pas disa vitesh të krizës ekonomike dhe financiare, ekonomitë tona kanë treguar një aftësi të jashtëzakonshme në përballjen me të. Kjo nuk është një rastësi. Përkundrazi, është testamenti i punës së kujdesshme të kryer para dhe gjatë krizës. Koordinimi i veprimeve të politikës monetare dhe asaj fiskale në mbarë rajonin dhe në Shqipëri ka qenë i suksesshëm në zbutjen e ndikimeve negative të krizës. Në veçanti, bankat qendrore kanë ndërmarrë hapa të paprecedentë përmes instrumenteve të tyre monetarë, të likuiditetit dhe të politikës makroprudente.

Shumë është bërë dhe arritur në drejtim të ofrimit të lehtësirave për tregjet financiare, duke siguruar transferimin e borxhit sovran dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, stabiliteti makrofinanciar është i ekspozuar ndaj disa rreziqeve të caktuara të mundshme. Rajoni i Evropës Juglindore po lufton që ta ruajë progresin relativisht të shëndoshë ekonomik dhe financiar të arritur në 20 vitet e fundit të epokës post-komuniste.

Aktualisht, rajoni karakterizohet nga një aktivitet i dobët ekonomik, i shoqëruar nga papunësi e lartë, presione të ulëta inflacioniste dhe rritje të nivelit të kredive me probleme. Të gjitha ekonomitë po operojnë nën potencialin e tyre, kryesisht për shkak të rritjes anemike të kredisë, humbjes së besimit në ekonominë e brendshme dhe aktivitetit të dobët ekonomik në BE. Dhe të fundit, por jo më pak të rëndësishmet, humbja e konkurrueshmërisë dhe ngadalësimi i reformave strukturore po veprojnë si barriera për rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë.

Që prej fundit të vitit 2011, krahas këtyre presioneve, po përballemi me një problem të ri. Më konkretisht, i referohem uljes së shpejtë dhe të konsiderueshme të ekspozimit të grupeve të huaja bankare ndaj borxhit privat dhe atij publik, si pjesë e objektivave të tyre të tërheqjes së shpejtë nga ekspozimi i borxhit përkundrejt sektorit privat dhe atij publik, apo siç njihet ndryshe *deleveraging*. Ky proces nuk u arsyetua mbi gjendjen në Shqipëri, por u imponua në mënyrë të papritur nga jashtë, duke krijuar vështirësi të konsiderueshme për financimin e borxhit publik, si dhe për konsumin privat dhe veprimtaritë e investimit. Të gjitha këto implikime negative mund të cënojnë më tej stabilitetin financiar dhe atë fiskal.

Besoj se tërësia e masave të fundit për forcimin e stabilitetit financiar në vendet e Eurozonës ka marrë formën e një përqasjeje të një ekonomie të mbyllur. Këto masa nuk kanë konsideruar në mënyrë të mjaftueshme implikimet e mëdha në vendet evropiane në zhvillim.

Në përgjithësi, përmbushja e rekomandimeve të EBA-s lidhur me zbatimin e politikave, që kanë rezultuar në tërheqjen e shpejtë ndaj ekspozimit të borxhit përkundrejt sektorit privat dhe atij publik, në nivel grupi në Eurozonë, ka krijuar probleme të mëdha në nivel filialesh në ekonomitë me treg në zhvillim. Kështu, ajo ka ndikuar në perspektivat për rritjen ekonomike dhe në besimin si në nivel grupi, ashtu dhe në nivel të ekonomive lokale. Ajo çfarë dua të them është se barra financiare e këtyre rregullave nuk ndahet proporcionalisht midis vendeve të origjinës dhe atyre pritëse, dhe midis vendeve të Eurozonës dhe atyre evropiane në zhvillim.

Ky jo-proporcionalitet është më i madh në ato vende me ekonomi në tranzicion, ku ndërmjetësimi financiar është mbështetur pothuajse ekskluzivisht në burime të brendshme. Për shembull, në fund të vitit 2008, stoku i përgjithshëm i kredisë për ekonominë në Shqipëri mbulonte vetëm 62% të totalit të depozitave.

Stoku i kredisë në valutë u financua pothuajse tërësisht nga totali i depozitave në valutë, ndërkohë që linjat e kredisë nga bankat mëma për filialet dhe degët e tyre kanë qenë në nivele të papërfillshme. Në parim, ndërmjetësimi financiar është financuar gjithmonë në tregjet e brendshme. Ai nuk ka imponuar kufizime financiare në bilancin e bankës mëmë, por megjithatë, ne na u desh të mbanim një barrë që duket e padrejtë.

Në fakt, si rezultat i interpretimit të rregullores së EBA-s, një nga bankat e huaja që operon në Shqipëri e uli ekspozimin ndaj borxhit të qeverisë shqiptare me 3 pikë përqindje të PBB-së brenda rreth një periudhe tremujore. Këto veprime shkaktuan zhbalancime në nivelin e likuiditetit në tregun ndërbankar, të cilat nuk mund të zgjidheshin në një kohë të shpejtë për shkak të problemeve strukturore.

Këto zhbalancime u shoqëruan me rritje të normës së interesit për letrat me vlerë të borxhit të qeverisë, duke kufizuar mekanizmin e transmetimit të politikës monetare.

Ulja e ekspozimit ndaj letrave me vlerë të borxhit të qeverisë nuk përkon me një rritje të ngjashme të ekspozimit ndaj kredisë për sektorin privat, duke kontribuar në një rritje më të ulët të kredisë. E gjithë kjo vjen në një kohë kur mekanizmat e mundshëm absorbues (në drejtim të hapësirës fiskale) dhe besimi i publikut në ekonomi janë ulur, duke mos lënë hapësira shtesë për stimuj të shtuar ekonomikë.

Nga ana tjetër, masa të caktuara "kreative" për stimulimin e kredisë dhe të rritjes ekonomike përmes zbatimit të një politike monetare jotradicionale dhe kërkesave mbikëqyrëse më të lehtësuara janë potencialisht të rrezikshme. Në një mjedis tejet të pasigurt ekonomik, ato mund të stimulojnë përkeqësimin e mëtejshëm të bilancit të bankave, pa pasur ndikim të madh mbi aktivitetin ekonomik. Kjo është dhe sekuenca e problemeve aktuale ekonomike, me të cilat po përballet mbarë rajoni ynë.

Në përgjithësi, ndërsa shumë prej masave të ndërmarra nga autoritetet evropiane në tre vitet e fundit kanë qenë të nevojshme dhe të rëndësishme, ato kanë dhënë përshtypjen sikur janë ndërmarrë vonë, pa shumë entuziazëm dhe me hezitim ndaj një përqasjeje "më shumë Evropë", si dhe duke mos konsideruar siç duhet ndikimin mbi vendet fqinje.

Dhe më e rëndësishmja, këto masa nuk kanë frenuar ndikimin negativ afatmesëm të krizës financiare në aktivitetin ekonomik, duke nxitur kështu nevojën për një balancë më të mirë dhe në kohë midis masave "shtrënguese" dhe atyre të "pro-rritjes".

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në vizionin tonë, integrimi përfaqëson një udhëtim mes miqsh dhe partnerësh drejt një objektivi ose destinacioni të përbashkët.

Duke qenë se ekonomitë tona po afrohen gjithnjë e më tepër me njëra-tjetrën dhe për shkak se sistemet tona financiare duhen parë si një i tërë, ne besojmë se duhet të jemi të përgatitur dhe të gatshëm për të ndarë si përfitimet, ashtu dhe kostot e këtij procesi. Ne jemi tërësisht të vetëdijshëm për përfitimet dhe tashmë, i kemi shijuar frytet e tyre.

Në të njëjtën kohë, po bëhemi të vetëdijshëm për kostot e mundshme të këtij procesi, të cilat vijnë kryesisht nga goditjet asimetrike dhe veprimet e pakoordinuara politike. Për këto arsye, përfitoj nga kjo mundësi për t'u bërë një apel të gjithë vendimmarrësve përkatës të BE-së, që të konsiderojnë, me po të njëjtën vëmendje, ndikimin e vendimeve të tyre në ekonomitë që gjenden në procesin e konvergjencës. Ne gjendemi në të njëjtën varkë dhe besoj se duhet të vozisim në të njëjtin drejtim.

Duke hedhur vështrimin drejt vendeve evropiane me ekonomi në zhvillim, vërejmë se ekziston një nevojë e madhe për të lidhur politikat e mëparshme që lehtësuan flukset hyrëse të kapitalit në ekonomitë e rajonit me masa që do të siguronin vazhdimësinë e likuiditetit të nevojshëm, në momentin që këto flukse ndalojnë ose ndryshojnë drejtim. Vendet tona duhet të përfitojnë marrëveshje "*swap*" ose të ngjashme, me qëllim që të na mundësohet përfitimi i likuiditetit afatshkurtër në valutë.

Për shkak të ndërlidhjeve të sistemeve tona financiare, mendoj se kjo çështje meriton vëmendje më të madhe në të ardhmen.

Në mënyrë të veçantë, partnerët tanë, institucionet ndërkombëtare të zhvillimit dhe fondet financiare duhet të inkurajojnë dhe lehtësojnë axhendën komplekse të reformave dhe të rritjes ekonomike që mbështet procesin e konvergjencës. Ne duhet të krijojmë stimujt e duhur për vendimmarrësit dhe agjentët ekonomikë në vendet me ekonomi në zhvillim.

Konvergjenca, në vetvete, është një proces strukturor. Për këtë arsye, të gjitha institucionet e zhvillimit duhet të ruajnë dhe të rrisin mbështetjen për

rritje ekonomike dhe stabilitet në rajon. Ne duhet të nxjerrim mësimet e duhura nga kriza: dobësitë e identifikuara duhet t'i shndërrojmë në prioritete të zhvillimit dhe t'i integrojmë në axhendën tonë të rritjes për të ardhmen.

Pyetjet që lindin natyrshëm janë: Cili është modeli më i mirë ekonomik? Cilat burime do të financojnë përmirësimin e këtyre ekonomive? Si do të arrihet konvergjenca e këtyre ekonomive dhe si do të sigurohet punësimi?

Ekonomitë tona janë të vogla, marrë veç e veç. Megjithatë, ne duhet të shikojmë tablonë e madhe dhe të kuptojmë se rajoni ynë, i marrë si një i tërë, përfaqëson një treg të madh dhe vital.

Besoj se duke punuar së bashku si partnerë, ne mund të korrim suksese.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Me rastin e ceremonisë së mbylljes së Projektit të Binjakëzimit,
16 korrik 2012

Miq të nderuar,

Bankat qendrore, që në fillimet e tyre, kanë qenë të veshura me një "tis misteri". Kjo lidhet me ekskluzivitetin që ato kanë për emetimin e parasë, fiksimin e përqindjes së interesit për kredinë dhe kontrollin e likuiditetit në treg. Pikërisht, ky rol i rëndësishëm i tyre si dhe zhvillimet e fundit botërore i vendosën këto institucione në qendër të vëmendjes. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, bankat qendrore anembanë botës, si asnjëherë më parë, në koordinim perfekt me njëra tjetrën, përveç operacioneve tradicionale ndërmorën dhe veprime të jashtëzakonshme, të panjohura më parë.

Nëpërmjet tyre synonin të siguronin likuiditetin e domosdoshëm në treg me një qëllim final, i cili ka mbetur i pandryshuar që nga kohët e antikitetit, rikthimin e besimit të publikut tek institucionet financiare. Perandori Tiberius, në vitin 33 para Krishtit hodhi në qarkullim 1 milion monedha para publike me qëllimin e vetëm për të stabilizuar situatën financiare në treg.

Bashkëpunimi dhe koordinimi mes bankave qendrore sot është bërë pjesë e pandarë e menaxhimit të institucionit. Zhvillimet teknologjike dhe procesi i globalizimit e kanë bërë të domosdoshme nevojën për bashkërendim ndërmjet institucioneve vendimmarrëse anembanë botës. Imagjinoni zhvillimet e pasluftës së Dytë Botërore, kur bankat qendrore pranuan në masë të gjerë kalimin e tyre nga pronësi private në pronësi publike dhe kur ato kuptuan se ishte jo vetëm e nevojshme por e domosdoshme të bashkëpunonin, pavarësisht pengesave fizike. Imagjinoni për shembull presidentin e Rezervës Federale, të cilit i duhej të humbiste tre muaj kohë për të udhëtuar në Evropë dhe dy javë që të merrte një letër nga homologët përtej oqeanit.

Aktualisht, bankat qendrore kanë shtuar përpjekjet për një bashkëpunim më të mirë dhe më frytdhënës. Kjo është një e vërtetë e pamohueshme. Ky ka qenë dhe një tipar që ka karakterizuar punën tonë këto vitet e fundit. Që në daljen time të parë publike si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, kam deklaruar se ambicia ime ishte transformimi institucional dhe ligjor i Bankës së Shqipërisë në përputhje me modelin e anëtarëve të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

E them me bindje të plotë se përfundimi me sukses i Projektit të Binjakëzimit me Banca d'Italia dhe Banque de France, përbën një hap tjetër vendimtar në përpjekjet e përbashkëta për të forcuar bashkëpunimin dhe standardet e punës drejt niveleve të reja evropiane. Sot, ne shohim të kthehet në

realitet, një ide të shkëlqyer e cila në disa muaj u shndërrua në një projekt të kurorëzuar me sukses.

Objektivi i projektit ishte përmirësimi i praktikave të punës në fushat e mbikëqyrjes bankare, statistikave, sistemeve të pagesave, tregut ndërbankar, bashkërendimit të procesit të integrimit në BE dhe kulturës financiare.

Më konkretisht, në fushën e mbikëqyrjes bankare, bashkëpunimi u fokusua në zbatimin e reformave madhore në fusha si mbikëqyrja e konsoliduar, miratimi i rregulloreve të reja dhe trajnimi i personelit. Ky bashkëpunim ka forcuar më tej lidhjet tona me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera si dhe me organizma ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, një prej përparësive të projektit ishte edhe zhvillimi e forcimi i kapaciteteve të personelit tonë në këtë fushë. Rritja e aftësive të tyre analitike do të mundësonte sugjerimin e masave përkatëse që duhet të marrë institucioni ynë për parandalimin ose trajtimin e mangësive apo kërcënimeve ndaj stabilitetit të sistemit financiar.

Përsa i përket fushës së statistikave, me qëllim përmbushjen e plotë të standardeve të BQE-së lidhur me hartimin dhe shpërndarjen e të dhënave monetare dhe financiare, ky bashkëpunim mundësoi një rishikim të plotë të kuadrit ekzistues rregullator. Rishikimi synoi të identifikonte mospërputhjet me standardet e BE-së dhe, rrjedhimisht, hartimin e një plani pune solid për një rishikim të përgjithshëm të metodologjisë dhe infrastrukturës sonë për hartimin e bilancit të pagesave, në përmbushje të standardeve të BE-së.

Ndër aspektet e tjera parësore, në të cilat u përqendrua ky projekt, ishin edhe sistemet e pagesave. Në këtë fushë, u sigurua përmirësimi i mëtejshëm i praktikave, me qëllim përafrimin me ato të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ) për sistemet e pagesave. Gjithashtu, u analizuan aktet ligjore të fushës si dhe përputhshmëria e tyre me kornizën rregullative të BE-së.

Përsa i takon modulit të tregut ndërbankar të parasë, bashkëpunimi u përqendrua në shqyrtimin e përvojës së bankave të tjera qendrore mbi trajtimin e pengesave dhe vështirësive të tregut, në lidhje me kuadrin rregullator. Gjithashtu u trajtuan edhe aspekte të tjera që mund të çmohen me vlerë për adaptim, përfshirë identifikimin e veprimeve të duhura për t'u ndërmarrë nga institucioni ynë në këtë fushë.

Bashkërendimi i procesit të integrimit në BE është një fushë tjetër me rëndësi të madhe, e cila u trajtua gjerësisht nga ky projekt. Bashkëpunimi në këtë fushë rriti nivelin e kualifikimit të personelit tonë me qëllim trajtimin jo vetëm të ndryshimeve që rrjedhin nga zbatimi i MSA-së dhe përafrimi me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ), por edhe të sfidave që mund të hasim kur vendi të marrë statusin e vendit kandidat, e në vijim të fillojë negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, moduli i kulturës financiare ka një rëndësi kyçe për Bankën e Shqipërisë. Me mbështetjen dhe bashkëpunimin e ekspertëve të projektit, u hartua një plan veprimi për promovimin e kulturës

financiare dhe rritjen e të kuptuarit të parimeve të ekonomisë së tregut nga grupe të ndryshme të shoqërisë, si dhe u ndërtua një sistem monitorimi i kulturës financiare të grupeve të ndryshme shkollore.

Në vijim të sa më lart, për shkak të kompleksitetit të punës sonë dhe zhvillimeve të reja në fushën bankare dhe financiare, është e qartë se projekti forcoi institucionin tonë dhe na ndihmoi të përballemi me situata të reja. Ndër të tjera, vlen të theksohet se bashkëpunimi dhe komunikimi mes institucioneve tona, nuk është intensifikuar vetëm në sferën profesionale por edhe ne atë personale. Jetojmë në një shoqëri globale, në të cilën zhvillimet në botën financiare ecin me hapa të shpejtë. Për këtë arsye, bankat qendrore duhet të zotërojnë mekanizma të fortë dhe të besueshëm të koordinimit dhe komunikimit, të cilët mund të përgatisin institucionet tona të përballen me këto situata.

Një proverb thotë: "Një udhëtim i gjatë, gjithmonë fillon vetëm me një hap". Kjo filozofi u konkretizua përmes këtij projekti binjakëzimi, i cili krahas ndihmës në zhvillimin e fushave të lartpërmendura përbënte edhe një ndër hapat e parë në rrugëtimin e institucionit tonë drejt standardeve të Bashkimit Evropian, si një nga prioritetet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Dua të shpreh falënderimet e mia të sinqerta për bashkëpunimin e shkëlqyer që kemi patur gjatë gjithë ecurisë së projektit me Banca d'Italia dhe Banque de France. Përshëndes përpjekjet e këtyre dy institucioneve të nderuara dhe shpresoj që realizimi i suksesshëm i këtij projekti do të shërbejë si shembull për të gjithë ne, që të përfshihemi më tepër në iniciativa të këtij lloji në të ardhmen.

Gjithashtu shpreh falënderimet e mia për Delegacionin e Bashkimit Evropian, për asistencën dhe kujdesin e vazhdueshëm që ka treguar gjatë gjithë ecurisë së projektit, dhe shpreh bindjen time të thellë se këto janë vetëm hapat e parë të një bashkëpunimi më të ngushtë. Do doja ta mbyll fjalën time duke sjellë në vëmendjen tuaj një thënie të zotit Shimon Peres, i cili duke dëgjuar kështilltarin e tij, Agasi që po i fliste mbi domosdoshmërinë e burimeve alternative në mungesë të burimeve të naftës, e ndërpret atë duke i thënë: *Nice speech, but what are we going to do* (Ligjëratë e bukur, por ç'do të bëjmë konkretisht?!)

Në këtë prizëm edhe ne duhet të mendojmë se çfarë do të bëjmë në të ardhmen. E rëndësishme mendoj se është mbulesa politike e këtij procesi përafrimi, me të cilin kuptoj pranimin e mundshëm nga ana e Brukselit në muajin shtator të kërkesës së Shqipërisë për anëtarësim. Ky do të ishte një hap i rëndësishëm, që do të krijonte hapësira të reja për konvergimin e shpejtë të vendit nga njëra anë, por edhe për zhvillimin e shpejtë dhe të pakthyeshëm të Bankës së Shqipërisë drejt modeleve të simotrave të veta evropiane.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit
Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
25 korrik 2012

Sot, në datën 25 korrik 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit. Pas kësaj uljeje, norma e marrëveshjeve të riblerjes me afat njëjavor zbret në një minimum të ri historik, prej 4%. Në opinionin e Këshillit Mbikëqyrës, lehtësimi i mëtejshëm i kushteve monetare në ekonomi do të ndihmojë në respektimin e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme.

Njëkohësisht, ky lehtësim do të nxitë më tej aktivitetin ekonomik në vend, duke rritur stimulin monetar në mbështetje të kërkesës së brendshme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e monetare, si dhe të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

* * *

Ndonëse në një kontekst global gjithnjë e më sfidues, ekonomia shqiptare ka vijuar të ruajë parametrat e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të saj gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Inflacioni i çmimeve të konsumit, treguesit e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik, bilanci i pagesave dhe gjendja financiare e sistemit bankar rezultuan të qëndrueshme apo në përmirësim.

Në veçanti, sektori financiar i vendit mbetet i mirëkapitalizuar, likuid dhe i aftë të ushtrojë funksionin e tij të ndërmjetësimit. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe, ekonomia shqiptare është përballur me disa goditje të ofertës, me lëvizje strukturore në tregjet e brendshme financiare, si dhe me një kërkesë të ngadaltë të brendshme dhe të huaj. Këto zhvillime ndikuan në rënien e PBB-së në tremujorin e parë të vitit dhe njëkohësisht vështirësuan veprimin e politikave stabilizuese mbi kërkesën agregate.

Me uljen e pritur të tensioneve në pjesën e mbetur të vitit, ekonomia shqiptare pritet të regjistrojë norma pozitive rritjeje.

Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 1.9% në tremujorin e dytë të vitit, duke u rritur me 0.8 pikë përqindje kundrejt tremujorit të parë.

Rritja graduale e çmimeve të konsumit ka reflektuar kryesisht rritjen e çmimeve të ushqimeve të papërpunuara, ndërkohë që çmimet e ushqimeve të përpunuara dhe ato të mallrave të konsumit joushqimor kanë ulur kontributin

e tyre në inflacion gjatë tremujorit të dytë. Kategoritë e tjera të shportës së çmimeve të konsumit kanë patur një ecuri të qetë dhe janë karakterizuar nga norma të ulëta inflacioni.

Nga një këndvështrim makroekonomik, ecuria e çmimeve të konsumit vijon të reflektojë presione të dobëta inflacioniste, si nga kahu i kërkesës ashtu edhe nga ai i ofertës. Nga kahu i kërkesës, prania e kapaciteteve të lira në shfrytëzimin e faktorëve të prodhimit është reflektuar në kontrollin e kostove në ekonomi dhe në presione rënëse mbi inflacion.

Nga kahu i ofertës, ngadalësimi i presioneve të importuara inflacioniste, rënia e çmimit të naftës dhe të lëndëve bazë, mosrritja e çmimeve të administruara, pritjet e ulëta inflacioniste dhe efektet minimale të veprimit të dytë nuk kanë gjeneruar presione inflacioniste. Inflacioni i çmimeve të konsumit mbetet në nivele të ulëta dhe parashikohet të jetë i tillë edhe në periudhën e ardhshme. Këto vlerësime kanë kushtëzuar ruajtjen e natyrës stimuluese të politikës monetare edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit. Norma bazë ka qëndruar në nivelin më të ulët historik, duke ofruar kushte monetare lehtësuese, në funksion të respektimit të objektivit tonë të inflacionit dhe të mbështetjes së zhvillimit të aktivitetit ekonomik në vend. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka vijuar të injektojë të gjithë likuiditetin e kërkuar nga sistemi bankar, kundrejt një baze të zgjeruar kolaterali dhe me afate të përshtatshme maturimi.

Sipas të dhënave më të fundit të INSTAT-it, ekonomia shqiptare ka shënuar rënie vjetore prej 0.2% në tremujorin e parë të vitit. Tkurrja e aktivitetit ekonomik në këtë tremujor ka qenë më e theksuar në degën e industrisë, e cila ka shënuar rënie vjetore prej 19.3%, kryesisht si pasojë e uljes së ndjeshme të prodhimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, edhe dega e ndërtimit ka regjistruar rënie të aktivitetit në terma realë, me 17.6%, duke dhënë një kontribut negativ në ecurinë e prodhimit të brendshëm bruto. Nga ana tjetër, sektori i shërbimeve ka ndikuar pozitivisht në ecurinë e aktivitetit ekonomik, duke shënuar një rritje vjetore prej 6.0%. Gjithashtu, aktiviteti në sektorin e bujqësisë ka shënuar një rritje vjetore prej 4.5% gjatë kësaj periudhe, duke dhënë një kontribut pozitiv në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto.

Vlerësimet për ecurinë e kërkesës agregate në tremujorin e parë të vitit sugjerojnë vazhdimin e ecurisë së plogësht të kërkesës së brendshme. Politika fiskale konsoliduese ka përcaktuar mungesën e stimulit fiskal në këtë periudhë dhe një rënie të kërkesës së sektorit publik për mallra e shërbime. Dinamika e konsumit privat mbetet e ngadaltë, duke reflektuar sjelljen e kujdesshme konsumatore dhe rritjen e prirjes për kursim. Investimet private kanë qenë gjithashtu të ulëta. Në prani të potencialeve të lira të prodhimit, bizneset shqiptare kanë parë pak hapësira për rritjen e investimeve të tyre në makineri, pajisje dhe hapësira prodhuese, ndërkohë që kërkesa për ndërtesa rezidenciale mbetet e dobët.

Në të njëjtën kohë, kërkesa e huaj vlerësohet të ketë patur një ecuri të dobët në këtë tremujor, si pasojë e problemeve në eurozonë dhe në partnerët tanë kryesorë në tregtinë e huaj. Ecuria e dobët e kërkesës së huaj, si dhe

problemet në prodhimin e energjisë elektrike, kanë përcaktuar rritjen e ngadaltë të eksporteve shqiptare.

Informacioni ekonomik i zotëruar për tremujorin e dytë të vitit është i pjesshëm. Të dhënat e tërthorta të disponuara sinjalizojnë një gjallërim të ngadaltë të ekonomisë në këtë periudhë. Analiza e tyre mbështet vlerësimin për vijimësi të ecurisë së dobët të kërkesës agregate, veçanërisht të asaj të brendshme. Nga ana e prodhimit, pritet që dinamika e shfaqur nga sektorët e ekonomisë në tremujorin e parë të vitit të mbartet edhe në tremujorin e dytë të tij.

Zhvillimet fiskale në tremujorin e dytë të vitit kanë ndjekur linjat e vërejtura në tremujorin e parë të tij, të karakterizuara nga sjellje konsoliduese e politikës fiskale dhe nga orientimi i saj drejt ruajtjes së objektivave për deficitin buxhetor e borxhin publik. Kjo sjellje është shprehur në tkurrjen e shpenzimeve buxhetore me 2.5% në gjashtë muajt e parë të vitit. Ndërkohë, të ardhurat fiskale janë rritur me 3.7% gjatë kësaj periudhe, duke vijuar të shfaqin dinamikë të ngadaltë të komponentit tatimor të tyre. Ecuria e shpenzimeve dhe e të ardhurave publike në gjysmën e parë të vitit është materializuar në ngushtimin e ndjeshëm të deficitit buxhetor në terma vjetorë, në masën 37.7%. Në vlerë monetare, ky deficit rezultoi 16.8 miliardë lekë dhe vlerësohet në 2.6% të PBB-së.

Të dhënat mbi zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë tregojnë për reduktim të shkëmbimeve tregtare në pesë muajt e parë të vitit. Eksportet në vlerë kanë shënuar një rritje të ulët vjetore, prej 1.3% gjatë kësaj periudhe, në reflektim të moderimit të kërkesës së huaj dhe ecurisë së çmimeve në tregjet botërore. Po për këtë periudhë, importet janë tkurrur me 2.0% në terma vjetorë. Këto zhvillime kanë rezultuar në ngushtimin vjetor me 4.2% të deficitit tregtar në pesë muajt e parë të vitit. Ecuria e tregtisë së jashtme në këta muaj është ndikuar në një masë të madhe nga shkëmbimet tregtare të energjisë elektrike. Duke përjashtuar këtë ndikim, rritja e eksporteve është më e madhe dhe tkurrja e importeve më e thellë, duke rezultuar në ngushtim të deficitit tregtar në masën 18.1%.

Ecuria e treguesve monetarë ka qenë në linjë me zhvillimet në ekonominë reale dhe analizat tona tregojnë se presionet monetare mbi inflacion janë të kontrolluara. Rritja vjetore e agregatit M3 rezultoi 8.7% në muajin maj, duke ruajtur nivelet mesatare të muajve të mëparshëm të këtij viti. Por, në krahasim me vitin e kaluar, ritmet e rritjes së ofertës së parasë janë ngadalësuar, në reflektim të kërkesës më të ulët të agjentëve ekonomikë për para. Sjellja konsoliduese fiskale është shoqëruar me rënie të huamarrjes së sektorit publik, ndërkohë që edhe agjentët privatë të ekonomisë kanë shfaqur një kërkesë të ulët për financim. Kredia për sektorin u rrit me 7.5% në muajin maj, duke ndjekur trendin e ngadalësimit të nisur që në fund të vitit të kaluar. Ecuria e saj, përveç kërkesës së ulët të bizneseve dhe individëve, reflekton edhe sjelljen e kujdesshme përzgjedhëse të bankave në kredidhënie.

Duke u ndalur te problemet e kreditimit, Banka e Shqipërisë vëren se bilancet e sistemit bankar janë të shëndosha, me likuiditet dhe kapital të

mjaftueshëm për të përballuar kërkesën e ekonomisë për mjete monetare. Kjo gjendje pozitive e bilanceve të tij, ka mundësuar rritjen e kreditimit gjatë viteve të fundit, në një kohë kur shumë vende të rajonit përjetuan tkurrje të kredisë. Sistemi bankar ka rishikuar drejt shtrëngimit, standardet e kredidhënies gjatë viteve të fundit, por kjo sjellje në drejtim të rritjes së disiplinës financiare të ekonomisë është e mirëpritur dhe do t'i shërbejë pozitivisht rritjes afatgjatë të vendit. Nga ana tjetër, ecuria e kredisë është duke vuajtur gjithnjë e më shumë nga mungesa e kërkesës, e cila është diktuar nga hezitimi i konsumatorit dhe biznesit në kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve.

Banka e Shqipërisë gjykon se, pavarësisht situatës ciklike të ekonomisë shqiptare, perspektivat afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të saj mbeten pozitive. Kjo gjë, ndër të tjera, dëshmohet edhe nga interesimi i investitorëve të huaj për të rritur ekspozimin e tyre drejt ekonomisë shqiptare. Në veçanti, sektorët e ekonomisë të cilët lidhen me eksportin, degët e shërbimeve të cilat operojnë në industrinë e turizmit, dhe sektori i bujqësisë i cili i shërben tregut vendas dhe atij rajonal, ofrojnë potenciale të pashfrytëzuara zhvillimi.

Banka e Shqipërisë gjykon se, brenda parametrave të logjikës së shëndoshë të biznesit, sipërmarrësit dhe konsumatori shqiptar kanë hapësira për një përqasje më aktive drejt rritjes së investimeve dhe të konsumit të tyre.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga një luhatshmëri e ulët e normave të interesit dhe nivel i mjaftueshëm i likuiditetit në tremujorin e dytë të vitit. Reduktimi i normave të interesit është përcjellë edhe në tregun e depozitave në lekë, shoqëruar me ritme normale rritjeje të nivelit të depozitave. Në të kundërt, *yield*-et në tregun primar janë rritur, veçanërisht për afatet e gjata. Sikurse e kemi përmendur, kjo ecuri ka reflektuar ripozicionimin e disa agjentëve në këtë treg si dhe kërkesën për financim në këtë periudhë, pa nënkuptuar zhvendosje të pritjeve inflacioniste. Fillimi i muajit korrik ka evidentuar përmirësimin e raporteve si dhe reduktimin e kostos huamarrëse në tregun primar. Tremujori i dytë ka përcjellë edhe sinjale për lehtësimin e interesave të kredisë në lekë nga bankat. Megjithatë, ritmet e kredidhënies mbeten të ulëta dhe të destinuara kryesisht për përdorim afatshkurtër, duke bërë që normat e interesit të jenë të luhatshme.

Një zhvillim pozitiv, i cili vlen të përmendet në analizën e tregjeve financiare gjatë gjashtëmujorit të parë, është futja në treg e ndërmjetësve të rinj financiarë, të specializuar në kanalizimin e kursimeve të publikut në letra me vlerë të qeverisë. Ky zhvillim, i shoqëruar edhe me rritjen e interesit të publikut kundrejt letrave me vlerë të qeverisë, rrit thellësinë e sistemit tonë financiar, përmirëson likuiditetin dhe rrit aftësinë e tij për të administruar rrezikun, kufizon luhatjet e normave të interesit, rrit qëndrueshmërinë e borxhit publik shqiptar, dhe ushtron presion në drejtim të uljes së kostos së financimit të sektorit publik.

Ecuria e faktuar e aktivitetit ekonomik në vend dhe informacioni i filtruar nga tregues të tërthortë mbi të, kanë zhvendosur në kahun rënës projeksionet tona bazë për ecurinë ekonomike në pjesën e mbetur të vitit. Kjo zhvendosje

reflekton materializimin e një pjese të rreziqeve rreth projeksioneve bazë të mëparshme, të pritura dhe të faktorizuara në skenarët tanë. Ekonomia vendase pritet të ketë një ecuri të ngadaltë në pjesën e mbetur të vitit, e kushtëzuar nga dobësia e kërkesës së brendshme dhe të huaj.

Në kushtet e sjelljes konsoliduese fiskale dhe të ngadalësimit të kërkesës së huaj, ecuria e kërkesës së brendshme private mbetet përcaktuese e rritjes së aktivitetit ekonomik. Por, dy komponentët e kësaj të fundit, konsumi dhe investimet private nuk kanë dhënë ende sinjale gjallërimi.

Zhvillimet e pritshme brenda dhe jashtë vendit rezultojnë në një balancë të kontrolluar të presioneve inflacioniste, duke përcaktuar një rritje të ngadaltë të çmimeve të konsumit në të ardhmen. Rritja e kërkesës nën potencialin e ekonomisë edhe në periudhën e ardhshme do të vijojë të ushtrojë presione në kahun rënës mbi inflacion. Në të njëjtën kohë, edhe presionet e prodhuara nga faktorët e kërkesës paraqiten të përmbajtur. Bazuar në ecurinë e deritanishme të faktorëve përcaktues të inflacionit dhe projeksionet për ecurinë e tyre në të ardhmen, me një probabilitet ndodhjeje 90%, inflacioni pritet të luhatet në intervalin 1.0% - 3.3% pas 12 muajsh.

* * *

Duke vënë në balancë informacionin e përmbledhur më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se presionet mbi çmimet e konsumit në vend mbeten të ulëta përgjatë horizontit kohor të politikës monetare, por ato janë zhvendosur në kahun rënës gjatë muajve të fundit. Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike nën potencial do të vazhdojë të gjenerojë presione të ulëta inflacioniste, ndërkohë që edhe goditjet e kahut të ofertës pritet të jenë të moderuara.

Zhvillimet e pritura ekonomike dhe në inflacion nënkuptojnë ruajtjen e natyrës stimuluese të politikës monetare edhe gjatë periudhës së ardhshme. Banka e Shqipërisë mbetet e vëmendshme ndaj zhvillimeve të ardhshme dhe informacionit të ri, e gatshme për të reaguar në masën dhe kohën e duhur në funksion të përmbushjes së misionit të saj ligjor.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të ulë normën bazë të interesit, me 0.25 pikë përqindje, duke e çuar atë në nivelin 4%. Ky vendim synon të krijojë kushte të përshtatshme monetare për përmbushjen e objektivit të inflacionit në afat të mesëm. Gjithashtu, politika monetare ofron mbështetjen e duhur për stimulimin e kërkesës agregate.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit
Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
28 gusht 2012

Sot, në datën 28 gusht 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në nivelin 4.00%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme, duke ofruar njëkohësisht stimulin e nevojshëm monetar në mbështetje të kërkesës së brendshme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Inflacioni vjetor rezultoi 2.7% në muajin korrik, duke u rritur me 0.5 pikë përqindje kundrejt muajit paraardhës. Rritja e normës së inflacionit erdhi kryesisht si pasojë e rritjes më të lartë të çmimeve të mallrave ushqimorë të papërpunuar në këtë muaj. Gjithashtu, edhe çmimet e mallrave të konsumit jo-ushqimor kanë shtuar kontributin e tyre në inflacionin vjetor, si rrjedhojë e rritjes së çmimit të naftës. Kontributet e mallrave të tjera të shportës në inflacion mbeten të qëndrueshme dhe me luhatshmëri të vogël.

Pavarësisht rritjes, inflacioni i çmimeve të konsumit mbetet në gjysmën e poshtme të intervalit të tolerancës së Bankës së Shqipërisë. Në aspektin makroekonomik, rritja e tij ka ardhur si pasojë e veprimit të faktorëve të përkohshëm, ndërkohë që ecuria e dobët e kërkesës agregate vijon të shoqërohet me presione të ulëta mbi çmimet e konsumit. Gjithashtu, rritja e kostove të prodhimit mbetet e dobët, inflacioni i importuar shfaqet i ulët, ndërsa pritjet inflacioniste të agjentëve ekonomikë vijojnë të jenë të ankoruara.

Të dhënat mbi ecurinë e ekonomisë në tremujorin e dytë të vitit tregojnë për rritje të ngadaltë të aktivitetit ekonomik në këtë periudhë. Megjithëse disa tregues indirektë flasin për një përmirësim kundrejt tremujorit të parë të vitit, konsumatori vijon të karakterizohet nga një sjellje e orientuar drejt kursimit. Kjo sjellje pasqyrohet në shtyrjen e shpenzimeve të rëndësishme, në rritjen e depozitave dhe të investimeve në letrat me vlerë, si dhe në kërkesën e ulët konsumatore për kredi bankare. Investimet private vazhdojnë të mbeten të dobëta, në reflektim të ecurisë së dobët të kërkesës finale në ekonomi. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve vijon të jetë e ulët ndërsa importi i makinerive

dhe pajisjeve regjistroi një rënie vjetore me 9.5% në tremujorin e dytë, pas zgjerimit me një normë të ulët rreth 1.5% në tremujorin e parë të vitit. Lidhur me financimin e investimeve private, sistemi bankar vijoi të akordojë kredi për qëllime investimi në ritme të krahasueshme me tremujorin e parë të vitit.

Politika fiskale ka shfaqur një natyrë konsoliduese gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2012, duke u materializuar në ngushtimin e deficitit buxhetor gjatë kësaj periudhe. Në prani edhe të rritjes së ngadaltë të të ardhurave buxhetore, kjo sjellje është reflektuar në tkurrjen me 1.2% të shpenzimeve buxhetore. Nga ana tjetër, të ardhurat buxhetore shënuan një rritje vjetore prej 4.0%, të ndikuar nga rritja e dobët e të ardhurave tatimore. Ecuria e të ardhurave, shpenzimeve, dhe e huamarrjes publike është materializuar në një deficit buxhetor rreth 31.6% më të ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Banka e Shqipërisë vëren se ruajtja e disiplinës fiskale i ka shërbyer pozitivisht shëndetit financiar të ekonomisë shqiptare dhe kontrollit të primeve të rrezikut në ekonomi gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Vazhdimi i përpjekjeve për ruajtjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të borxhit publik do të ndihmojë në rritjen e kredibilitetit të politikës fiskale dhe në reduktimin e kostove të financimit të ekonomisë shqiptare.

Kërkesa e huaj është shfaqur e përmirësuar në tremujorin e dytë të vitit. Pas tkurrjes të shënuar në tremujorin e parë, eksportet e mallrave kanë regjistruar një rritje nominale vjetore prej 19.2%. Nga ana tjetër, importet e mallrave në vlerë janë tkurrur me 4.4% në terma vjetorë, duke u reflektuar në ngushtimin me 16.5% të deficitit tregtar në këtë periudhë. Orientimi në rritje i ekonomisë shqiptare drejt eksportit dhe rritja e konkurrueshmërisë së produkteve tona duhet të jetë një prioritet i sektorit publik dhe privat. Megjithëse tregjet ndërkombëtare janë të pafavorshme, si pasojë e krizës së zgjatur të partnerëve tanë tregtarë, rritja e eksporteve tona duhet parë si një strategji afatgjatë kombëtare në mbështetje të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe konvergjencës me standardet e Bashkimit Evropian.

Zhvillimet monetare kanë qenë në linjë me ecurinë e ekonomisë reale

Rritja vjetore e ofertës monetare u ngadalësua në 8.3% në muajin qershor, duke reflektuar reduktimin e financimit të sektorit publik nga sistemi bankar dhe kërkesën e ulët për mjete monetare të sektorit privat. Sektori privat i ekonomisë, i ndikuar nga pasiguritë e shtuara për zhvillimet makroekonomike brenda dhe jashtë vendit, ka shfaqur një kërkesë të ulët për kredi bankare. Në të njëjtën kohë dhe për të njëjtat arsye, bankat vazhdojnë të tregojnë kujdes të shtuar në procesin kredidhënës. Për rrjedhojë, ritmi i rritjes vjetore të kredisë për sektorin privat u ngadalësua në 6.8% në muajin qershor. Nxitja e kreditimit të shëndoshë ka qenë dhe mbetet një prioritet konstant i politikave të Bankës së Shqipërisë. Në mbështetje të tij, ne kemi ulur në nivelet minimale historike normën bazë të interesit, kemi rishikuar kuadrin mbikëqyrës dhe rregullator, si dhe kemi furnizuar sistemin bankar me të gjithë likuiditetin e kërkuar. Për rrjedhojë, sistemi bankar shqiptar është ndër të paktat sisteme bankare në rajon që ka mbajtur një normë pozitive ekspansioni të kredive gjatë viteve të fundit.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga kushte të mira likuiditeti dhe luhatshmëri e ulët e normave të interesit. Normat e interesit të monedhës vendase kanë vijuar prirjen rënëse edhe në muajin korrik, në ndjekje të ciklit lehtësues të politikës monetare dhe të përmirësimit të raporteve të kërkesës e ofertës në tregun e brendshëm të borxhit publik. Në veçanti, në tregun primar të letrave me vlerë të qeverisë është vënë re frenimi i rritjes së *yield*-eve dhe ka sinjale për reduktimin e tyre në të ardhmen. Në tërësi, zhvillimet në tregjet financiare tregojnë për prime të ulëta të rrezikut të likuiditetit dhe të inflacionit në ekonomi.

Projeksionet bazë për ecurinë e pritur të ekonomisë në të ardhmen mbështesin vlerësimet e mëparshme për një rritje të ngadaltë të ekonomisë shqiptare gjatë periudhës së ardhshme. Kërkesa e brendshme, e cila është shfaqur e dobët në pjesën e parë të këtij viti, pritet të vijojë të kushtëzohet nga hezitimi i agjentëve ekonomikë në ndërmarrjen e konsumit dhe investimeve private.

Paralelisht me të, respektimi i objektivave të qëndrueshmërisë së borxhit publik përcakton një sjellje konsoliduese të politikës fiskale dhe një kontribut të ulët të saj në rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, kërkesa e huaj pritet të japë një kontribut pozitiv, por të dobët, në rritjen e kërkesës agregate. Në këto rrethana, rritja ekonomike parashikohet të mbetet nën potencialin e saj për periudhën e ardhshme dhe presionet inflacioniste të gjeneruara prej saj pritet të jenë të ulëta. Duke faktorizuar edhe variablat e tjerë që ndikojnë në inflacion, Banka e Shqipërisë vlerëson se presionet inflacioniste për horizontin afatmesëm mbeten të kontrolluara, duke përcaktuar ruajtjen e natyrës stimuluese të politikës monetare gjatë kësaj periudhe.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në 4.00%. Në periudhën në vazhdim, Banka e Shqipërisë mbetet e vëmendshme ndaj zhvillimeve ekonomike dhe financiare, brenda dhe jashtë vendit, dhe e gatshme për të ndërhyrë në kohën dhe masën e duhur në përmbushje të mandatit të saj.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit
Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
26 shtator 2012

Sot, në datën 26 shtator 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 4.0%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme, ndërkohë që ofrojnë edhe stimulin e nevojshëm monetar në mbështetje të kërkesës së brendshme dhe të rritjes ekonomike.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Inflacioni vjetor në muajin gusht shënoi 2.8%, duke u rritur me 0.1 pikë përqindje ndaj nivelit të muajit korrik.

Ecuria e inflacionit vijon të përcaktohet kryesisht nga rritja e çmimit të mallrave ushqimorë dhe të naftës. Çmimet e mallrave të tjerë të shportës janë shfaqur relativisht të qëndrueshëm dhe kanë dhënë një kontribut të ulët në inflacionin total.

Sipas vlerësimeve tona, ecuria e inflacionit pasqyron më së shumti veprimin e përkohshëm të faktorëve të ofertës, të lidhur kryesisht me zhvillimet në tregjet botërore si edhe lëvizje të mundshme strukturore në tregun e brendshëm. Përkundrejt tyre, presionet inflacioniste të origjinuara në ekonominë vendase shfaqen të përmbajtura. Kërkesa e brendshme e dobët dhe rritja ekonomike nën potencial janë reflektuar në rritje të ngadaltë të kostove të prodhimit, në pritje të ankoruara për inflacionin dhe në zgjerim të kontrolluar monetar. Banka e Shqipërisë vlerëson se, në vija të përgjithshme, këto zhvillime do të vazhdojnë të përcaktojnë ecurinë e inflacionit edhe në periudhën e ardhshme.

Në balancë, të dhënat e tërthorta mbi ecurinë e ekonomisë në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit, tregojnë për një rritje pozitive por të ngadaltë të aktivitetit ekonomik. Ekonomia shqiptare ka përfituar nga ecuria më e mirë e kërkesës së huaj dhe e eksporteve në këtë periudhë, ndërkohë që kërkesa e brendshme mbetet ende e dobët.

Përveç stimulit të munguar të sektorit publik, të dhënat indirekte tregojnë për dinamikë të dobët të konsumit dhe të investimeve private. Në veçanti, rritja e kujdesit të konsumatorëve është reflektuar në uljen e konsumit dhe në rritjen e kursimit të familjeve shqiptare.

Sikurse e kemi thënë edhe më parë, kjo sjellje pasqyron në një masë të madhe korrektimin e nivelit të lartë të konsumit, të vërejtur në ekonomi deri në fund të vitit 2008. Por, në kontekstin e zhvillimeve aktuale në ekonominë dhe në tregjet financiare botërore, hezitimi i konsumatorit në blerjen e mallrave të qëndrueshëm, reflekton edhe pasigurinë e tij në lidhje me zhvillimet e pritura në të ardhmen. Banka e Shqipërisë gjykon se frenimi i konsumit si reagim ndaj pasigurisë mbi ecurinë ekonomike në të ardhmen, mund të shndërrohet në një spirale ndikimesh të ndërsjella midis treguesve makroekonomikë. Tkurrja e konsumit shoqërohet me rënie të kërkesës së brendshme, duke çuar në ngadalësim të rritjes ekonomike dhe në rënie të të ardhurave të familjeve në një kohë të dytë. Në vazhdimësi analizat dhe projeksionet tona kanë sugjeruar se situata makroekonomike dhe vetë ekonomia shqiptare kanë baza të qëndrueshme për zhvillimin afatgjatë. Ky realitet duhet të përkthehet në një sjellje më realiste, drejt një niveli më të lartë konsumi në ekonomi, brenda kufijve të bilanceve të qëndrueshëm familjarë.

Në të njëjtin kah, edhe investimet private vlerësohen të jenë relativisht të ulëta, të kushtëzuara nga kapacitetet e lira të prodhimit, nga pritjet për kërkesën finale për mallra dhe shërbime në të ardhmen, si dhe nga kujdesi i shtuar i bankave në kredidhënie. Në veçanti, kërkesa e dobët e sektorit privat është përcjellë edhe në një kërkesë të ulët të tij për kredi në muajt e fundit. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve kredia për sektorin privat ka vijuar të ngadalësojë ritmin e rritjes vjetore, duke shënuar një rritje vjetore prej 5.5% në muajin korrik. Banka e Shqipërisë ka krijuar në vazhdimësi kushtet e duhura për nxitjen e kredidhënies. Kjo politikë është realizuar nëpërmjet lehtësimit të politikës monetare, injektimit të vazhdueshëm të likuiditetit në sistemin bankar, si dhe krijimit të kuadrit të duhur mbikëqyrës e rregullator. Ajo është reflektuar në një rritje krahasimisht të shpejtë të kredisë në lekë kundrejt kredisë në valutë. Gjithsesi, ne mendojmë se ka vend për një bashkëpunim më të ngushtë të biznesit me sistemin bankar. Sistemi bankar duhet të jetë më fleksibël dhe i vëmendshëm ndaj perspektivave makroekonomike dhe sektoriale të zhvillimit, ndërkohë që biznesi ka hapësira për investime në ato degë të ekonomisë të cilat ofrojnë potenciale ende të pashfrytëzuara.

Përbërësi i tretë i kërkesës agregate, shpenzimet publike, kanë patur gjithashtu një kontribut të ulët në rritjen ekonomike.

Politika fiskale ka patur karakter konsolidues në tetë muajt e parë të këtij viti. Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet buxhetore janë tkurrur me 0.4% në terma vjetorë, si pasojë e rritjes së ulët të shpenzimeve korrente dhe e tkurrjes së shpenzimeve kapitale. Të ardhurat fiskale u rritën me 3.7% gjatë tetë muajve të parë të vitit, duke regjistruar ritme historikisht të ulëta rritjeje. Politika e kujdesshme për realizimin e shpenzimeve është materializuar në tkurrjen e deficitit buxhetor. Për periudhën janar-gusht të këtij viti, ky deficit

rezultoi rreth 29% më i ulët se një vit më parë, duke ndihmuar në ruajtjen e qëndrueshmërisë afatgjatë fiskale. Ne gjykojmë se ndjekja e kësaj politike në vazhdimësi, e orientuar drejt qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të treguesve të borxhit publik, është e domosdoshme dhe produktive në kushtet aktuale të tregjeve financiare.

Kërkesa e huaj ka mbështetur rritjen e aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit. Deficiti i eksporteve neto është ngushtuar me 23.9% në këtë periudhë, duke reflektuar rritjen e eksporteve dhe reduktimin e importeve në krahasim me një vit më parë. Të dhënat e tregtisë së jashtme tregojnë se ky impuls pozitiv ka vijuar edhe në muajin korrik. Eksportet janë rritur me 11.6% në terma vjetorë në këtë muaj, ndërkohë që importet kanë regjistruar një rritje vjetore të ulët prej 1.1%. Këto zhvillime kanë bërë që deficiti tregtar në muajin korrik të ulet me 5.2% në terma vjetorë.

Zhvillimet monetare tregojnë për presione të moderuara inflacioniste me natyrë monetare në ekonomi. Oferta e parasë ka ruajtur ritmet e zgjerimit të muajve të mëparshëm, duke regjistruar një rritje vjetore prej 8.4% në muajin korrik. Ecuria e saj reflekton kërkesën e ulët të sektorit të brendshëm të ekonomisë për mjete monetare. Ecuria e tregjeve financiare ka reflektuar kushtet e përmirësuara të likuiditetit si dhe primet më të ulëta të rrezikut dhe të inflacionit në ekonomi. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë shënuar rënie, duke përcjellë uljen më të fundit të normës bazë në muajin korrik. Gjithashtu, edhe në tregun primar të letrave me vlerë të qeverisë ka vijuar ulja e mëtejshme e *yield*-eve. Lehtësimi i mëtejshëm i kushteve monetare pritet të përcillet edhe në normat e interesit në segmentet e tjera të tregut financiar, në përputhje me periudhën e veprimit të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Në kontekstin e përmirësuar të tregjeve të brendshme financiare dhe në prani të një sistemi bankar të shëndetshëm, Banka e Shqipërisë është në pritje të një përcjelljeje më të plotë në ekonomi të vendimeve të saj të mëparshme për lehtësimin e politikës monetare.

Projeksionet për zhvillimet e pritura ekonomike në të ardhmen i përmbahen skenarit bazë të vlerësuar në muajt e mëparshëm.

Aktiviteti ekonomik në vend pritet të mbetet i ulët, i kushtëzuar nga ecuria e dobët e konsumit dhe e investimeve private dhe nga hapësirat e pakta për stimul fiskal. Për rrjedhojë, presionet inflacioniste mbeten të ulëta dhe nën kontroll, duke u reflektuar në një ecuri të pritur të inflacionit afër objektivit të Bankës së Shqipërisë.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në 4.0%.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën e përbashkët për shtyp të misionit të FMN-së
me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë,
2 tetor 2012

Të nderuar gazetarë,

Sikurse jeni në dijeni, gjatë dy javëve të fundit janë zhvilluar bisedime intensive midis përfaqësuesve të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe autoriteteve shqiptare. Banka e Shqipërisë, si një aktor kyç në hartimin dhe zbatimin e politikave makroekonomike të vendit, mori pjesë aktivisht në këto diskutime, duke ndarë vizionin e saj mbi zhvillimet aktuale e të pritura të ekonomisë shqiptare, problematikat e zhvillimit dhe masat optimale për trajtimin e tyre.

Ekonomia shqiptare është duke u përballur gjithnjë e më shumë me sfidën e rritjes ekonomike. Ndonëse ekonomia shqiptare gjendet në kushtet e një stabiliteti të konsoliduar makroekonomik dhe në prani të themeleve të shëndosha financiare, kërkesa agregate ka qenë e zbehtë, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012. Kërkesa e brendshme dhe ajo e huaj vuajnë nga pasiguria e lartë, nga kushte relativisht të shtrënguara të financimit dhe nga hapësirat e pakta për politika stimuluese diskrecionare. Në kontekstin ndërkombëtar, ekonomia shqiptare është përballur me një ambient të vështirë të ekonomisë botërore, të karakterizuar nga probleme të rritjes ekonomike, nga prime të larta të rrezikut në tregjet financiare dhe nga ulja e oreksit të këtyre tregjeve për të investuar në vendet në zhvillim. Në kontekstin e brendshëm, ekonomia vijon të përballet me një nivel relativisht të ulët konsumi dhe investimesh private, si dhe me një stimul të munguar të sektorit publik, si pasojë e orientimit në rritje të politikës fiskale drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë afatgjatë të borxhit publik.

Në prani edhe të goditjeve të përkohshme të ofertës, këto faktorë u përkthyen në një rritje ekonomike negative në tremujorin e parë të vitit. Sipas vlerësimeve tona, pjesa e mbetur e vitit ka shënuar një përmirësim të kërkesës agregate dhe të aktivitetit ekonomik, duke sjellë një rritje ekonomike pozitive për vitin 2012. Megjithatë, kjo rritje mbetet krahasimisht e ulët dhe e pamjaftueshme për të siguruar shfrytëzim të plotë të kapaciteteve prodhuese në ekonomi. Ajo ka kushtëzuar presione të ulëta inflacioniste gjatë vitit 2012 dhe është reflektuar në përmirësimin e pozicionit të jashtëm të ekonomisë shqiptare.

Nga ana tjetër, sistemi bankar dhe financiar i vendit mbetet i shëndetshëm. Bankat që operojnë në Shqipëri karakterizohen nga nivele të kënaqshme likuiditeti dhe kapitali, duke qenë të afta të zhvillojnë funksionin e ndërmjetësit financiar. Treguesit e transaksioneve dhe të rrezikut të perceptuar në tregjet

financiare janë gjithashtu në përmirësim. Pas luhatjeve të gjashtëmujorit të parë të vitit, normat e interesit në këto tregje kanë filluar të kenë tendenca rënëse.

Në rrethanat që përmenda më sipër, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka marrë trajta gjithnjë e më stimuluese. Sikurse jeni në dijeni, gjatë vitit të fundit ne kemi lehtësuar në vazhdimësi kushtet monetare nëpërmjet pesë uljeve të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit dhe si rrjedhojë, kostoja e parasë në ekonomi ka zbritur në nivelin më të ulët historik. Gjithashtu, nëpërmjet operacioneve tona monetare, kemi furnizuar sistemin bankar me likuiditetin e nevojshëm për zhvillimin normal të aktivitetit të tij. Së fundi, nëpërmjet rishikimit të normave rregullative dhe zbatimit të një mbikëqyrjeje të kujdesshme të sistemit bankar, ne kemi synuar dhe kemi arritur të krijojmë një ambient të qëndrueshëm financiar për zhvillimin afatgjatë të vendit. Rritja e besimit të publikut në sistemin bankar është shoqëruar me rritje të shpejtë të depozitave bankare, duke reduktuar ndjeshëm varësinë e tij ndaj financimit të huaj afatshkurtër. Të gjitha këto nisma, natyrisht të koordinuara me politika të tjera, kanë rezultuar efektive. Inflacioni mbetet i ulët dhe nën kontroll, pritjet inflacioniste janë të ankoruara, ambienti makroekonomik shfaqet i qëndrueshëm dhe stabiliteti financiar është konsoliduar më tej.

Duke u kthyer nga e ardhmja, Banka e Shqipërisë mendon se ekonomia shqiptare do të vazhdojë të përballet me problemet e lartpërmendura edhe gjatë vitit 2013 e në vazhdim. Ndonëse në përmirësim, aktiviteti ekonomik pritet të mbetet poshtë potencialit, duke u shoqëruar me presione të ulëta inflacioniste dhe duke krijuar premisa për ruajtjen e kushteve monetare stimuluese edhe në të ardhmen. Gjithashtu, projeksionet tona, sugjerojnë se balancat e jashtme të ekonomisë pritet të vijnë në përmirësim. Nga ana tjetër, ritmet e ngadalta të rritjes ekonomike mund të krijojnë presione mbi treguesit e qëndrueshmërisë së borxhit, nëse ato nuk njihen dhe faktorizohen si duhet prej vendimmarrjes fiskale.

Në opinionin e Bankës së Shqipërisë, rikuperimi i ritmeve të rritjes do të kërkojë kombinimin e stimulimit ciklik të ekonomisë me marrjen e masave strukturore që zgjerojnë potencialin e rritjes.

Në aspektin ciklik, Banka e Shqipërisë gjykon se politikat makroekonomike kanë natyrën e duhur stimuluese. Në mungesë të hapësirave, politika fiskale duhet të vijojë të jetë e orientuar drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të treguesve të borxhit, ndërkohë që stimuli monetar pritet të transmetohet më i plotë në periudhën e ardhshme. Ne vijojmë të theksojmë mesazhin tonë se biznesi dhe konsumatori duhet të kenë një qëndrim më realist mbi perspektivat e shëndosha të zhvillimit të vendit dhe të rishikojnë drejt rritjes planet e tyre të konsumit dhe të investimeve.

Në aspektin strukturor, ne mirëpresim të gjitha reformat dhe nismat të cilat ndihmojnë potencialin e rritjes së vendit, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës, përmirësimit të kuadrit ligjor, rritjes së produktivitetit dhe të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, tërheqjes së investimeve të huaja, si dhe ruajtjes e përmirësimit të stabilitetit makroekonomik të vendit.

Banka e Shqipërisë është thellësisht e angazhuar në drejtimin e fundit. Kredoja e punës sonë do të vijojë të mbetet ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe krijimi i parakushteve për rritjen e stabilitetit financiar të vendit. Në këtë mënyrë, jemi të bindur se i bëjmë shërbimin më të çmuar rritjes dhe mirëqenies afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën me temë "Konkurrenca kundrejt marrjes
përsipër së rrezikut nga sektori bankar në vendet
e Evropës Qendrore dhe Lindore", Prishtinë
8 tetor 2012

Të nderuar guvernatorë,
Të nderuar pjesëmarrës,

Takimet e rregullta rajonale janë një mundësi e mirë për të diskutuar mbi zhvillimet ekonomike dhe financiare në vendet tona. Ato shërbejnë për të evidentuar ngjashmëritë dhe ndryshimet mes njëri-tjetrit, si dhe politikat ekonomike e financiare e nevojshme për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshemi.

Vendndodhja gjeografike dhe marrëdhëniet ekonomike me të njëjtët partnerë, përbëjnë faktorë që kanë mundësuar zhvillime të ngjashme ekonomike dhe financiare në vendet tona. Ato kanë përcaktuar natyrën dhe madhësinë e kontaminimit (ndikimit) prej krizës ekonomike globale dhe asaj në Eurozonë në veçanti.

Vlerësimi i ndikimit mbi vendet tona, ka qenë shpesh çështja kryesore e diskutimit në këto takime. Vështirësitë makrofinanciare dhe paqartësitë që shoqërojnë Eurozonën e bëjnë krizën aktuale evropiane të jetë në fokusin kryesor edhe të këtij takimi.

Veprimet aktuale dhe angazhimet e Bankës Qendrore Evropiane kanë plotësuar gamën e instrumenteve që autoritetet evropiane mund të përdorin për të mbështetur tregjet dhe institucionet financiare. Megjithatë, investitorët janë në pritje të vendimeve shtesë më të harmonizuara dhe më të fuqishme politike. Situata ekonomike, veçanërisht në Greqi dhe në Spanjë, mbetet e vështirë, ndërkohë që Portugalia dhe Italia kanë ndërmarrë programe të tjera të konsolidimit fiskal. Papunësia në Bashkimin Evropian dhe në Eurozonë ka arritur nivele rekord, veçanërisht tek të rinjtë.

Rritja ekonomike është e dobët, e përqendruar kryesisht në vendet që janë në qendër të Eurozonës.

Vendet tona janë ndikuar nga kjo situatë për arsye objektive. Marrëdhëniet tregtare, lëvizjet e kapitalit dhe të fuqisë punëtore, si dhe ato të sistemit financiar, janë kanalet përmes të cilave këto probleme janë përçuar në ekonomitë tona. Forma, madhësia dhe shtrirja e këtij ndikimi, kanë evoluar përgjatë 4 viteve të fundit.

Aktualisht ndikimi shfaqet në rënien e kërkesës së brendshme, në uljen e ritmit të rritjes ekonomike, në rënien e të ardhurave të disponueshme, në humbjen e besimit dhe në rënien e optimizmit të shprehur në rritjen e kursimeve.

Rrjedhimisht këto zhvillime e kanë zhvendosur fokusin e politikave ekonomike drejt aktivitetit ekonomik dhe ringjalljes së optimizmit me qëllim favorizimin e investimeve dhe konsumit. Ndërkohë, nga ana tjetër, kërkohet me çdo kusht ruajtja e stabilitetit financiar të ekonomisë, duke krijuar në këtë mënyrë një binom prioritetesh që kushtëzojnë njëri-tjetrin dhe kërkojnë një zgjidhje të njëhershme.

Ekonomia shqiptare është duke u përballur gjithnjë e më shumë me sfidën e rritjes ekonomike. Ndonëse ajo zhvillohet në kushtet e një stabiliteti të konsoliduar makroekonomik dhe në prani të themeleve të shëndosha financiare, kërkesa agregate ka qenë e zbehtë gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012. Kërkesa e brendshme dhe ajo e huaj vuajnë nga pasiguria e lartë, nga kushtet relativisht të shtrënguara të financimit dhe nga hapësirat e pakta për politika stimuluese diskrecionare.

Në kontekstin e brendshëm, ekonomia vijon të përballet me një nivel relativisht të ulët konsumi dhe investimesh private, si dhe me një stimul të munguar të sektorit publik, si pasojë e orientimit në rritje të politikës fiskale drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë afatgjatë të borxhit publik.

Nga ana tjetër, sistemi bankar dhe financiar i vendit mbetet i shëndetshëm, likuid dhe treguesit e kapitalit paraqiten në nivel relativisht të kënaqshëm. Aktiviteti i sektorit bankar, vijon të mbështetet në mënyrë të fuqishme prej rritjes së depozitave të publikut.

Bankat kanë fuqizuar pozicionin e tyre të kapitalit, për të forcuar qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve të veprimtarisë bankare. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të muajit qershor 2012, shënoi vlerën 15.6%. Megjithatë, zhvillimet e kredisë mbeten një problem që ndikohet nga ecuria e aktivitetit ekonomik dhe pritjet për të ardhmen.

Ngadalësimi i rritjes ekonomike dhe rënia e kërkesës për investime dhe konsum nga bizneset dhe familjet janë përcaktuesit e ritmit të kreditimit të sektorit privat dhe cilësisë së kredisë. Nga ana e tyre, bankat kanë rritur dukshëm kujdesin në procesin e kreditimit.

*Stress*-testet periodike ose ndryshe provat e rezistencës tregojnë se sektori bankar është i qëndrueshëm dhe mund të përballojë edhe zhvillime më të pafavorshme për sa i takon ecurisë së ekonomisë. Sidoqoftë, jemi të ndërgjegjshëm që sfidat me të cilat ballafaqohet veprimtaria bankare janë të vështira.

Përveç rigjallërimit të aktivitetit ekonomik dhe besimit në të ardhmen, për përmirësimin e cilësisë së kredisë nevojitet plotësimi i kuadrit ligjor, i cili mundëson dhe lehtëson ekzekutimin e kolateralit. Shitja e aktiveve të këqija në treg me vlerën e tyre reale është pikënisja e procesit të korrektimit financiar e pasuror në bilancet e sektorit privat dhe sistemit financiar.

Pastrimi i bilanceve do të çojë në nxitjen e aktivitetit ekonomik përmes investimeve e konsumit, duke siguruar përmirësimin e qëndrueshëm të cilësisë së kredisë.

Aktualisht, ndikimi i ndërsjellë i aktivitetit ekonomik me kredinë dhe cilësinë e saj përbën edhe problemin kryesor me të cilin përballet politika monetare. Eficienca e ndërhyrjeve të njëpasnjëshme për uljen e normës së interesit është zbehur nga pritjet negative.

Rrjedhimisht efektet në kërkesën e brendshme të bizneseve e familjeve për investime dhe konsum nuk janë në nivelin e dëshirueshëm. Pavarësisht këtyre problemeve, rritja ekonomike mbetet në territor pozitiv megjithëse nën potencial. Sipas vlerësimeve tona, rritja do të jetë pozitive edhe në të ardhmen. Ndërkohë, pritjet e operatorëve ekonomikë dhe financiarë për ecurinë e inflacionit mbeten të ankoruara pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Situata e mirë e likuiditetit dhe kapitalizimit në sektorin bankar, si dhe stabiliteti i treguesve makroekonomikë, kanë mundësuar harmonizimin e politikave ekonomike për ruajtjen e statuskuosë.

Nëse situata vijon të mbetet e njëjtë, në horizontin e parashikueshëm të kohës, atëherë politika monetare mund të mbetet akomoduese për të njëjtën periudhë. Rigjallërimi i kërkesës së brendshme dhe rritja ekonomike lidhen më tej me pritjet të cilat ndikohen edhe prej situatës së partnerëve tanë.

Politika fiskale ka synuar konsolidimin fiskal dhe ka vijuar përpjekjet për dhënien e stimujve të nevojshëm fiskalë në mënyrë të kujdesshme.
Aktualisht, nëse procesi i privatizimit përfundon në mënyrë të suksesshme, atëherë mundësitë fiskale për nxitjen e rritjes ekonomike dhe përmbysja e pritshmërive negative janë të konsiderueshme.

Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi duhet të mbështesë jo vetëm objektivat afatshkurtër të rritjes ekonomike, por gjithashtu të ndikojë edhe pritshmëritë e operatorëve ekonomikë për një rritje të qëndrueshme të ekonomisë në të ardhmen. Kjo e fundit, mund të realizohet nëpërmjet përdorimit të të ardhurave shtesë për uljen e nivelit të borxhit dhe mbështetjen e reformave për ndryshimet strukturore në ekonomi.

Të nderuar pjesëmarrës,

Aktualisht, konstatoj se ndërtimi i strategjive të zhvillimit afatgjatë me karakter të theksuar kombëtar përbën një problem të rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme të rajonit tonë në afatin e gjatë. Mungesa e këndvështrimit rajonal në këto strategji nuk e favorizon suksesin individual të ekonomive të vogla në ekonominë globale.

Është e nevojshme që procesi i lidhjes dhe integrimit të infrastrukturës të transportit të vazhdojë me integrimin e strategjive të zhvillimit, tregjeve të kapitalit, të punës dhe lëndëve të para dhe infrastrukturës energjetike. Ekonomitë tona janë të cënueshme dhe të ndikuara nga zhvillimet globale

sepse janë ekonomi të vogla në një rajon ekonomik të fragmentuar dhe të varur nga prurjet valutore në formën e investimeve të huaja, eksporteve dhe dërgesave nga emigrantët.

Rritja e madhësisë së tregut, lehtësia e lëvizjes së faktorëve të prodhimit (kapitali, fuqia punëtore, lëndët e para), integrimi i sistemeve financiare dhe atyre të pagesave, integrimi e bashkërendimi i kurrikulave shkencore e arsimore dhe trajtimi i sfidave nga një këndvështrim rajonal do ta bëjë rajonin një hapësirë ekonomike tërheqëse dhe të integruar. Ky integrim do të evidentojë avantazhet krahasuese rajonale, duke rritur njëkohësisht konkurrueshmërinë e secilës prej ekonomive në veçanti.

Për rrjedhojë, integrimi do ta konvertojë tendencën e rajonit për t'u ndikuar negativisht nga zhvillimet globale në një mundësi, në një ndikim pozitiv, për të arritur rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike në afatin e gjatë.

Faleminderit!

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbajtur në çeljen e ekspozitës së Bankës së Shqipërisë me temë
"100 vjet Pavarësi: Pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare",
Muzeu Historik Kombëtar,
25 tetor 2012

Njëzet vjet më parë, në shkurt të vitit 1992, qeveritë e 12 vendeve të Bashkimit Evropian firmosën në qytetin holandez të Maastiricht-it, traktatin me anë të të cilit angazhoheshin të adoptonin një monedhë të përbashkët.

Natën e Vitit të Ri të vitit 2002, dhjetë vjet më parë, dritat e kateve më të larta të bankave qendrore evropiane qëndruan gjithmonë të ndezura. Guvernatorët dhe bashkëpunëtorët e tyre më të ngushtë fjetën pak. Përgatitjet për prezantimin e Euros qenë të përpikta por ky ishte një eksperiment i pa provuar më parë. Nuk ekzistonin veprime të ngjashme ku mund të bazoheshin dhe variablat në lojë qenë të shumta.

Ndërsa 20 vjet më parë, ne shqiptarët rijetuam eksperiencën e ndryshimeve shumë të rëndësishme historike, plot shqetësime dhe entuziazëm jo më pak të fuqishëm se ai i përjetuar nga paraardhësve tanë që themeluan Shtetin Shqiptar 100 vjet më parë. Pikërisht në këtë vit të shënuar për sistemin monetar evropian, ndodhën në vendin tonë, ndër të tjera, edhe ndryshime thelbësore ekonomike. Transformim ky që do t'i jepte jetë sistemit bankar dynivelësh dhe do të hapte rrugën për krijimin e një banke qendrore me tipare dhe funksione bashkëkohore.

20 vitet e fundit treguan vlerën e pashembullt të një banke qendrore të pavarur, si një nga gurët e themelit të Shtetit Shqiptar dhe përpjekjet e saj në vite për ruajtjen e vlerës së monedhës kombëtare, LEKUT.

Këta 20 vjet për ekonominë shqiptare sigurisht që nuk kanë qenë të njëjtë me ata të fqinjëve tanë evropianë por zhvillimet tregojnë pa diskutim se ajo është tashmë e orientuar drejt një ekonomie tregu të zhvilluar dhe integrimit përfundimtar në Bashkimin Evropian. Kjo periudhë ka treguar sesa të rëndësishme janë reformat strukturore që ndërmori ekonomia shqiptare, duke e bërë atë më konkurruese dhe më të mbrojtur nga kriza.

Me anë të kësaj ekspozite të organizuar me rastin e kremtimit të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë është krenare të rikujtojë një prej aspekteve më kryesore të procesit shtetformues të vendit, të cilit zakonisht nuk i kushtohet e njëjta vëmendje si ngjarjeve politike, atyre ushtarake dhe vetë zhvillimeve të ekonomisë reale. Ky aspekt është historia e monedhës sonë kombëtare.

Por, njëkohësit duam të sjellim në vëmendje se, ashtu siç del në pah edhe nga ajo pjesë e ekspozitës kushtuar qarkullimit monetar gjatë periudhës së

lashtësisë, në trevat historike shqiptare që në shek. IV para e.s, kur u pre monedha e parë vendase në tregun e shkëmbit, kanë qarkulluar monedhat më kryesore të Evropës. Një mesazh tjetër jo më pak i rëndësishëm që kërkon të transmetojë kjo ekspozitë, është se historia e Shqipërisë është e lidhur ngushtë me atë të pjesës tjetër të kontinentit të vjetër, të cilit i përket në mënyrë të pakthyeshme, e se pavarësisht devijimeve historike, e ardhmja e saj është paracaktuar të jetë evropiane.

Megjithëse monedha jonë kombëtare nuk mundi të instituohej si valuta e Shtetit Shqiptar menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë, ngjarjet dhe peripecitë e historisë së saj, kontribuojnë më së miri në rrëfimin e historisë së vendit tonë, mes vështirësive dhe shpresave të kohës. Si një prej simboleve më të rëndësishme të një shteti sovran, emetimi i monedhës kombëtare shqiptare dhe rrjedhimisht krijimi i një banke qendrore kombëtare ishte një ndër projektet dhe aspiratat kryesore të baballarëve dhe ideologëve të Shqipërisë.

Falë saj aspirohej që Shqipëria të gëzonte jo vetëm një pavarësi politike por edhe një pavarësi ekonomike - ajo do t'i shërbente jo vetëm zhvillimit të ekonomisë së vendit por edhe konsolidimit të pavarësisë së tij. Në fjalimin e tij, të mbajtur disa ditë pas firmosjes së marrëveshjes mbi krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, Ismail Qemali u shpreh: "Ashtu si çdo njeri, i cili sado i pasur të jetë ka nevojë për kredi, madje sipas kredive që ka kuptohet se sa është nderi i tij. Kështu dhe shtetet kanë nevojë për kredi dhe lavdërohen me kredinë që kanë në gjirin e bursave të përgjithshme."

Kjo shprehje e Ismail Qemalit është sa e vjetër aq dhe e kohës, sepse ajo që u vërtetua sot është se Sovraniteti i vendeve varet nga çmimi i obligacioneve qeveritare në treg.

Të dashur pjesëmarrës,

Historia e monedhës është e lashtë sa vetë bota. Kujt do t'i shkonte në mendje se sëpatat do të ishin mjeti kryesor i shkëmbimit në rajonin tonë që zëvendësonte paranë në kohët e lashta.

Po ashtu, mendoj se edhe evropianët e sotëm, gjermanët, holandezët, francezët, italianët, do të habiteshin në qoftë se dikush do t'ju thoshte pas luftës së dytë botërore që në vitin 2010 monedha e tyre marka gjermane, guldeni holandez, frangu francez, lireta italiane e kështu me radhë, nuk do të kishin më vlerë dhe do të zëvendësoheshin nga një monedhë e përbashkët e quajtur Euro. Për habinë më të madhe kjo do të ishte monedha e parë pa shtet dhe në vend të figurave të mbretërve, prijësve ose dijetarëve në të, do të zinin vend ura, harta, harqe, godina, yje, e kështu me radhë. Dhe më e habitshme do të ishte që kjo monedhë, nga një përgjegjësi e përveçme e një shteti, do të kthehej në një përgjegjësi të përbashkët.

Por aq i habitshëm është dhe parashikimi që Viktor Hygo ka bërë në vitin 1855 kur thoshte: "Një monedhë kontinentale e bazuar te besimi dhe te metalet e çmuara, që përbën bazën e kapitalit të të gjithë Evropës, dhe

e mbështetur nga aktiviteti i një popullsie 200 milionëshe: kjo monedhë e vetme do të zëvendësojë dhe nxjerrë nga qarkullimi të gjithë llojet e tjera absurde të parasë që qarkullojnë sot, së bashku me imazhet princërore dhe mizërinë e tyre."

Por kjo monedhë ka akoma rrugë të gjatë për të bërë në kudhrën e farkëtarit. Kështu që rruga jonë me lekun është akoma e gjatë.

Tiparet, cilësia dhe karakteristikat teknike të parasë janë pjesë e kredibilitetit të saj. Por sigurisht, ajo që karakterizon vlerën e vërtetë të parasë është fuqia e saj blerëse. Në këto 20 vjet, Banka e Shqipërisë ka arritur të sigurojë një monedhë të shëndetshme, të besueshme dhe të dashur për të gjithë shqiptarët.

Së fundi, dëshiroj të theksoj se ky vit ka qenë një vit i shënuar për numizmatikën me nxjerrjen e një serie dedikuar 100-vjetorit të pavarësisë, seri të cilën po e prezantojmë në ekspozitën që po inaugurojmë sot.

Uroj që me anë të kësaj ekspozite të kemi krijuar një ide mbi udhëtimin e monedhës sonë kombëtare dhe rrjedhimisht, edhe sistemit monetar aktual. Shpresoj që të gjithë vizitorët të kenë dëshirë të vizitojnë përsëri ekspozita të tilla, pasi koha kur Banka e Shqipërisë do të çelë muzeun e saj është afër. Për të realizuar këtë projekt i jemi drejtuar historianëve, ekonomistëve, bibliotekarëve, arkivistëve, artistëve, ekspertëve të komunikimit dhe arkitektëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Rezultati përfundimtar do të rrjedhë nga bashkëpunimi i hollësishëm mes botës akademike, institucioneve, industrisë kulturore dhe Bankës së Shqipërisë. Mendoj se bashkëpunimi për ruajtjen dhe ekspozimin e vlerave kombëtare është mesazhi i duhur në prag të këtij 100-vjetori.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën e 10-të Ndërkombëtare me temë
"Politika monetare nga e shkuara në të ardhmen",
26 tetor 2012

I nderuar zoti Kryeministër,
Të nderuar Ambasadorë,
I nderuar zoti Ministër i Financave,
Zotërinj Guvernatorë,
Të dashur miq,

Ndihem shumë i nderuar të hap punimet e Konferencës së dhjetë të Bankës së Shqipërisë. Konferenca e këtij viti është një ngjarje me rëndësi të veçantë pasi organizohet në kuadrin e aktiviteteve me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shtetit Shqiptar dhe njëkohësisht përvjetorin e 20-të Bankës së Shqipërisë. Duke ruajtur karakterin e vet shkencor, kjo konferencë i bën homazh përpjekjeve të bëra ndër vite në fushën e parasë dhe të financave.

Banka e Shqipërisë e vlerëson njohjen e të kaluarës si një nga elementët thelbësorë të analizës dhe vendimmarrjes, si një parakusht për çdo studim me karakter teorik apo empirik. Aktualisht, kjo është një domosdoshmëri, një sfidë me të cilën përballet bota e ekonomiksit.

Një studiues i suksesshëm për të skanuar, diagnostikuar dhe trajtuar gjendjen e ekonomisë do të duhej të ishte i aftë të lexonte mendimin njerëzor. Fatkeqësisht, një doktor i tillë nuk ekziston.

Prandaj, në kohët tona, shkenca ekonomike po kthen vëmendjen nga karakteristika individuale si: historia, etnografia dhe tipare të tjera kombëtare, duke i vlerësuar ato si përcaktuesit themelorë të procesit stokastik që udhëheq sjelljen e agjentëve në ekonomi.

Historia luan gjithashtu një rol mjaft të rëndësishëm në formimin e zhvillimin e institucioneve. Shpallja e pavarësisë krijon një epokë të re për institucionet e shtetit shqiptar. Pavarësia do t'i hapte rrugë idesë së krijimit të një banke qendrore, një sistemi monetar shqiptar të unifikuar, e rrjedhimisht administrimit të jetës ekonomike përmes politikës monetare. Pavarësisht nga jeta e shkurtër, Banka e Kombëtare e krijuar në vitin 1913 është një gurë themeli në historinë e Shtetit Shqiptar. Ja si e përshkruan kryeministri i kohës, Ismail Bej Vlora këtë akt: "E them me lavdërim se puna e Bankës për Shqipërinë është një i dyti fitim, pas lirisë, edhe nga pikëpamja ekonomike dhe politike".

Ngjarjet që pasuan shpalljen e pavarësisë, në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar, kanë luajtur një rol vendimtar në natyrën dhe karakterin e këtyre institucioneve, duke përcaktuar njëkohësisht edhe natyrën e politikës monetare.

Partneritetet ekonomike e politike, dhe karizma e shtetarëve shqiptarë për të ndërtuar një shoqëri moderne krijuan bankën e parë kombëtare funksionale në vitin 1925, duke i dhënë asaj edhe një fizionomi karakteristike me godinën e veçantë të vendosur në qendër të Tiranës.

Zhvillimet historike të fillimit të viteve '90 u bënë përsëri përcaktuese për sistemin financiar e bankën qendrore. Depërtimi i koncepteve të ekonomiksit modern çoi në themelimin e Bankës së Shqipërisë si një bankë që gëzonte të gjitha atributet e një banke qendrore.

Evolimi institucional i saj, solli zhvillimin dhe modernizimin e politikave monetare e financiare. Ajo u bë gjithashtu një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e sistemit financiar dhe ekonomik të vendit.

Sfidat e 20 viteve të fundit e kanë shndërruar Bankën Qendrore në një institucion modern e të përgjegjshëm, me kredibilitet që gëzon besueshmërinë e publikut, në një qendër të profesionalizmit, në një institucion që aplikon metodat më moderne të menaxhimit monetar, në qendrën e sistemit financiar.

Duke e njohur rolin vendimtar që teoritë moderne të rritjes ekonomike përcaktojnë për institucionet në prosperitetin e një kombi, e duke përfituar prej mbështetjes së klasës politike dhe besimit të shoqërisë shqiptare në këto 20 vite, ajo është përpjekur ta shndërrojë veten në një institucion modern, një entitet shtetëror dinjitoz në të gjitha dimensionet institucionale, morale, profesionale, etike e intelektuale.

Banka e Shqipërisë e vlerëson këtë si detyrë dhe një kontribut mjaft të rëndësishëm të formimit të shtetit dhe prosperitetit të tij në të ardhmen.

Përpjekjet e saj për modernizimin infrastrukturor e konceptual të institucionit, përfshirë projektet ndërtimore të tre viteve të fundit, janë domosdoshmëri për të garantuar standarde bashkëkohore të administrimit të veprimtarisë së institucionit, duke nënkuptuar shprehimisht përafrimin e shpejtë me të gjitha institucionet simotra evropiane. Me përfundimin e këtyre projekteve, Banka e Shqipërisë do të jetë më e hapur për publikun, i cili do të përfitojë prej politikave të edukimit financiar, aktivitetit shkencor, shërbimit biblotekar, aktivitetit legjislativ, aktiviteteve me karakter historik, muzeal e numizmatik. Këto risi do të ofrohen si të mira publike për të kontribuar me modesti në formimin e një shteti modern e të denjë për kombin shqiptar.

Aktualisht, përmbushja e këtyre detyrimeve është vështirësuar prej efekteve negative të krizës ekonomike botërore. Një nga aspektet më evidente të kësaj krize është fakti se tregjet e punës, tregjet e kapitalit dhe aktiviteti ekonomik, mbeten nën efektin e tkurrjes së konsumit e investimeve në sektorin privat.

Reagimi anemik i tregjeve i ka vendosur bankat qendrore përballë një zgjidhjeje pa zgjedhje, të ndërhyjnë në ekonomi me të gjitha mënyrat për të adresuar emergjencat aktuale në kushtet kur faktorët e tjerë janë të detyruar të tkurren në favor të stabilitetit afatgjatë të bilanceve publike e private. Në

këtë situatë, bankat qendrore janë detyruar të ndërmarrin një grup masash ekstreme cilësisht të ndryshme dhe të patestuara më parë, të cilat tejkalojnë të gjithë kufijtë e imagjinuar të politikës monetare.

Aktualisht, politikanët janë detyruar të shmangin krizat e borxhit përmes një politike fiskale ekstreme që synon njëkohësisht ribalancimin afatshkurtër dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të politikës fiskale. Fokusi dhe theksi i politikës ekonomike mbetet ribalancimi afatgjatë përmes shkurtimit të shpenzimeve. Një pjesë e rëndësishme e këtyre masave është shumë e fokusuar nga problematika afatshkurtër duke rrezikuar të lërë mënjanë efektet e padëshiruara në afatin e gjatë. Nën presionin e kostove sociale, filozofia e politikave sot është kapërcimi i situatës duke ruajtur paqen sociale dhe stabilitetin makroekonomik në kurriz të sovranitetit.

Ky kompromis emergjent e ka larguar fokusin nga reformat strukturore që në fakt garantojnë ribalancimin përmes rritjes së të ardhurave. Këndvështrimi i politikave ekonomike shpesh nuk shtrihet përtej disa tremujorëve pasardhës, ndërkohë që duhet të ketë një vizion shumë afatgjatë. Ankorimi i të ardhmes fillon nga e sotmja.

Politikat stabilizuese aktualisht bazohen në eksperiencat e shkuara, duke besuar se kriza aktuale ngjan me krizat e mëparshme. Ky arsyetim i ka shtyrë autoritetet të këmbëngulin në riciklimin e masave stabilizuese. Por koha na tregon se ekonomia globale ka pësuar ndryshime rrënjësore. Kriza aktuale ndodh në kushtet kur harta ekonomike globale po ridizenjohet në terma të madhësisë ekonomike, shpërndarjes gjeografike të kursimeve, borxhit dhe bilanceve tregtare e atyre korrente. Ekonomitë e zhvilluara dhe ato në zhvillim kanë këmbyer pozicionet në të gjitha këto dimensione.

Rrjedhimisht, recetat e vjetra nuk ofrojnë zgjidhje sepse aksiomatika mbi të cilën janë ngritur, ka ndryshuar. Zgjidhja e sfidave aktuale dhe atyre të së ardhmes kërkon një filozofi të re mendimi të bazuar në realitetin e ri global.

Ky realitet globalizimi, nuk është më një zgjedhje, por një fakt që duhet mbajtur parasysh në formulimin e strategjive afatgjata të zhvillimit.

Duke u zhvendosur në një kontekst rajonal, mendoj se kjo filozofi që përshkrova më sipër duhet të mbështetet dhe përhapet pa asnjë hezitim. Për ta bërë atë më produktive, është e domosdoshme që të të hapemi më shumë ndaj njëri-tjetrit, duke i dhënë bashkëpunimit rajonal një dimension të ri.

Prosperiteti individual i ekonomive të rajonit kërkon nga të gjithë ne që të lëmë mënjanë filozofinë e konkurrencës të nxitur dhe të trashëguar nga përpjekjet shtetformuese dhe modelet sklerotike të zhvillimit që dominuan shekullin e kaluar. Ne duhet t'i hapim rrugën bashkëpunimit dhe bashkërendimit ekonomik dhe financiar.

Ne duhet të rrëzojmë barrierat ballkanike për të ngritur një infrastrukturë funksionale gjithëpërfshirëse, një sistem rajonal pagesash, një sistem rajonal

energjitik, një treg rajonal produktesh financiare dhe së fundi, por ndoshta më e rëndësishmja, një treg rajonal faktorësh prodhimi. Siç thotë Martin Luther King "kemi ardhur të gjithë me varka të ndryshme, por tani jemi të gjithë në të njëjtën anije".

Duke qëndruar edhe pak në temën rajonale do të doja të trajtoja shkurtimisht dhe një problem tjetër.

Eksperienca e vitit të fundit tregon se kërkesat rregullative për kapital të imponuara nga organizma të ndryshëm mbikëqyrës të Eurozonës, u shoqëruan me reduktimin e pjesëmarrjes së grupeve bankare, jo vetëm në Eurozonë por edhe në rajonin tonë.

Ky proces, i njohur edhe si *deleverage*, ka sjellë pasoja negative. Për të shmangur ndodhitë e kësaj natyre, duhet një bashkëpunim më i madh midis politikëbërësve dhe mbikëqyrësve të ekonomive partnere.

Në këtë drejtim, Iniciativa e Vjenës është një platformë e mirë por e limituar bashkëpunimi. Kjo ndodh pasi, në konceptin e saj, Iniciativa e Vjenës është ngritur si një instrument për përballimin e një situate emergjente krize, ndërkohë që kërkesat e kohës janë për platforma dialogu të cilat mundësojnë një komunikim efektiv dhe të vazhdueshëm midis politikëbërësve. Minimalisht, ky dialog duhet të synojë shmangien e efekteve të padëshiruara reciproke, ndërkohë që një program më ambicioz do të synonte hartimin dhe zbatimin e nismave të koordinuara me interes reciprok.

Megjithatë, emergjencat potenciale të ardhura nga kontaminimi prej partnerëve tanë të Eurozonës, do të krijonin vështirësi shtesë duke krijuar kosto të mëdha efektive për ekonomitë e rajonit tonë.

Për këtë arsye, apelojmë për krijimin e mekanizmave dhe instrumenteve të përshtatshme të financimit me likuiditet nga ana e Bashkimit Evropian për vendet periferike të Eurozonës.

Besoj se procesi i integrimit financiar e bën edhe më emergjent këtë mbrojtje të përbashkët, nëpërmjet kuptimit të drejtë të fatit të lidhur të ekonomive të partnerëve tregtarë. Përfitoj nga prania në këtë konferencë e shumë prej drejtuesve të bankave qendrore të rajonit për të kërkuar një qëndrim *on block* të bashkërenduar dhe koordinuar në këtë drejtim.

Të nderuar pjesëmarrës,

Përvoja e krizës së fundit tregoi se vendet të cilat kishin më shumë hapësirë për reagim, në formën e bilanceve më të shëndosha fiskale apo të sistemit financiar apo edhe në formën e institucioneve më të besueshme publike, ishin në gjendje të përballonin më mirë pasojat e krizës. Ky mësim nuk duhet të humbë nga vëmendja e secilit nga ne. Ndër të tjera, ai nënkupton marrjen në kohë të masave dhe, nëpërmjet ndjekjes së politikave kundër-ciklike, krijimin e hapësirave të nevojshme për zbutjen e goditjeve potenciale. Gjithashtu, ai

nënkupton përpjekjet e vazhdueshme të politikave makro e mikroprudenciale për të minimizuar disbalancat financiare në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të tregut financiar.

Këto politika, të cilat shpesh njihen edhe si "lëvizje kundër erës" (*leaning against the wind*) kanë qenë dhe do të jenë pjesë e logjikës së veprimit të Bankës së Shqipërisë.

Në mbyllje të fjalës time dëshiroj t'ju siguroj edhe një herë se Banka e Shqipërisë do të bëjë përpjekjet maksimale për vazhdimin e historisë së suksesit edhe në dekadën e tretë të jetës së saj. Besoj se çështjet që ndava me ju ofrojnë një vizion të përmbledhur të disa drejtimeve kryesore të punës sonë gjatë kësaj periudhe. Duke shpresuar në një shkëmbim produktiv idesh dhe opinionesh gjatë vijimit të Konferencës.

Ju faleminderit për vëmendjen!

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit
Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
31 tetor 2012

Sot, në datën 31 tetor 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 4.0%. Ky vendim reflekton opinionin e Këshillit Mbikëqyrës se kushtet monetare aktuale janë të përshtatshme për respektimin e objektivit të inflacionit të Bankës së Shqipërisë në afat të mesëm. Nëpërmjet ruajtjes së normës bazë të interesit në nivelet minimale historike, ai siguron gjithashtu një stimul monetar të përshtatshëm për nxitjen e kërkesës së brendshme dhe për mbështetjen e rritjes ekonomike në vend.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Si pasojë e situatës së vështirë në ekonominë botërore, dhe veçanërisht në Eurozonë, ekonomia shqiptare është përballur me një ambient botëror sfidues gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012. Goditjet e ofertës, me origjinë të brendshme e të huaj, kanë përcaktuar profilin e rritjes ekonomike dhe kanë vazhduar të testojnë themelet makroekonomike dhe financiare të vendit. Gjatë kësaj periudhe, ekonomia shqiptare është përballur me një rritje të ngadaltë të kërkesës së huaj, me rritjen e primeve të rrezikut në tregjet financiare dhe me tendenca të uljes së ekspozimit ndaj ekonomisë shqiptare të disa agjentëve të tregut financiar. Këto zhvillime janë reflektuar gjithashtu në nivele të ulëta konsumi dhe investimesh në vend. Së bashku me reduktimin e stimulit fiskal përgjatë vitit 2012, ato kanë rezultuar në një kërkesë të zbehtë agregate dhe në një rritje të ulët ekonomike gjatë tre tremujorëve të parë të vitit.

Pavarësisht ndikimit negativ në ritmet e rritjes ekonomike, stabiliteti financiar dhe makroekonomik i vendit rezultoi i qëndrueshëm. Ndonëse në prani të luhatjeve të kërkesës dhe të problemeve të ofertës, niveli i inflacionit në vend rezultoi i ulët dhe nën kontroll, duke reflektuar ndër të tjera edhe ankorimin e mirë të pritjeve të publikut rreth objektivit tonë prej 3%. Qëndrueshmëria e ekuilibrave fiskalë, përmirësimi i pozicionit të jashtëm të vendit, si dhe bilancet e shëndosha të sektorit real dhe financiar të ekonomisë, kanë forcuar më tej stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit gjatë kësaj periudhe.

Inflacioni mesatar vjetor i çmimeve të konsumit rezultoi 2.7% në tremujorin e tretë të vitit, duke shënuar një rritje graduale gjatë vitit.

Shifra vjetore e inflacionit në këtë tremujor u formua më së shumti nga kontributi i shtuar i çmimeve të ushqimeve të papërpunuara dhe të mallrave të konsumit joushqimor. Nga ana tjetër, zhvillimet në çmimet e kategorive të tjera të shportës janë shfaqur të qëndrueshme dhe me luhatshmëri të vogël. Analiza ekonomike dhe monetare konfirmon praninë e presioneve të dobëta inflacioniste nga ana e kërkesës. Zhvillimet në sektorin real të ekonomisë kanë kushtëzuar rritjen e kontrolluar të çmimeve të prodhimit brenda vendit. Këto tendenca reflektohen në pririjen rënëse të inflacionit bazë dhe në inflacionin e ulët të kategorisë së mallrave të patregtueshme të shportës së konsumit.

Gjithashtu, ecuria e çmimeve të konsumit vijon të reflektojë presionet e ulëta nga ana e elementëve të tjerë të kostove. Në veçanti, çmimet e huaja kanë qenë të ulëta dhe, në prani të qëndrueshmërisë relative të kursit të këmbimit, kanë përcjellë presione të ulëta të inflacionit të importuar.

Pas tkurrjes ekonomike në tremujorin e parë, ekonomia shqiptare ka regjistruar një rritje vjetore prej 2.0% në tremujorin e dytë. Rritja e aktivitetit ekonomik është gjeneruar nga sektorët e bujqësisë, të industrisë dhe nga disa degë të sektorit të shërbimeve, ndërkohë që sektori i ndërtimit shënoi një rënie të fortë.

Nga këndvështrimi i kërkesës agregate, rritja ekonomike e tremujorit të dytë u mbështet më së shumti nga kërkesa e huaj, ndërsa kërkesa e brendshme vlerësohet të ketë mbetur e zbehtë. Shpenzimet konsumatore, ndonëse më të larta se në tremujorin e parë, nuk i janë rikthyer normave të rritjes së vitit të kaluar. Ecuria e këtij komponenti të kërkesës së brendshme vijon të ndikohet nga pasiguria e perceptuar, nga mungesa e dinamizmit në tregun e punës dhe, së fundi, edhe nga ngadalësimi i treguesit të të ardhurave të disponueshme. Të përballur me një kërkesë të ulët finale për produktet e tyre, si dhe prani të kapaciteteve të pashfrytëzuara dhe të kushteve relativisht të shtrënguara të kreditimit, edhe investimet private kanë mbetur të ulëta.

Në veçanti, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, niveli i ulët i investimeve private ka pasqyruar edhe kërkesën e ulët të familjeve për banesa rezidenciale.

Shpenzimet publike dhe stimuli fiskal kanë qenë gjithashtu të dobëta, në reflektim të natyrës konsoliduese të politikës fiskale dhe të respektimit të kufizimeve fiskale të përcaktuara në ligj. Procesi i konsolidimit fiskal, i bazuar më së shumti në reduktimin e shpenzimeve, ilustrohet nëpërmjet pririjes rënëse të ndjekur nga deficiti buxhetor përgjatë gjithë kësaj periudhe. Deficiti buxhetor rezultoi rreth 25.7 miliardë lekë gjatë nëntë muajve të parë të vitit, duke u ngushtuar me rreth 19% në terma vjetorë. Deri në muajin shtator, shpenzimet e realizuara janë rreth 0.2% më të ulëta se një vit më parë, ndërkohë që të ardhurat buxhetore janë rritur me 2.3%.

Të dhënat mbi zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë tregojnë një përmirësim të ndjeshëm të pozicionit të jashtëm të vendit. Eksportet në vlerë kanë shënuar një rritje vjetore prej 6.7% gjatë tetë muajve të parë,

në reflektim të moderimit të kërkesës së huaj dhe ecurisë së çmimeve në tregjet botërore. Po për këtë periudhë, importet janë tkurrur me 0.9% në terma vjetorë. Këto zhvillime kanë rezultuar në ngushtimin vjetor me 5.4% të deficitit tregtar deri në muajin gusht, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e kërkesës agregate. Gjithashtu, rënia e fortë e deficitit të llogarisë korrente gjatë tremujorit të dytë, është një sinjal pozitiv për qëndrueshmërinë afatgjatë të këtij treguesi dhe ndihmon në stabilizimin e kërkesës dhe ofertës për valutë në tregun e brendshëm.

Edhe zhvillimet në sektorin monetar konfirmojnë presione të ulëta inflacioniste në ekonomi. Ekspansioni i mjeteve monetare ka shfaqur shenja ngadalësimi gjatë tremujorit të tretë, në reflektim të reduktimit të kërkesës së brendshme për para.

Sjellja e kujdesshme e sektorit publik ka diktuar një kërkesë të ulët për mjete monetare, veçanërisht nga sistemi bankar. Nga ana tjetër, ecuria e ngadaltë e aktivitetit ekonomik dhe ekzistenca e kapaciteteve të lira duket të kenë kufizuar kërkesën për mjete monetare të agjentëve privatë të ekonomisë. Kredia për sektorin privat shënoi një rritje vjetore prej 5% në muajin gusht, duke ndjekur trajektoren ngadalësuese të nisur që në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011. Ecuria e muajve të fundit tregon se bankat janë më aktive në ndërmjetësimin në monedhën vendase ndërkohë që ato kanë ulur ndërmjetësimin në monedhë të huaj. Ky zhvillim është diktuar si nga gatishmëria e bankave për të investuar fondet në lekë ashtu edhe nga ndërgjegjësimi në rritje i agjentëve ekonomikë për rreziqet që mbart kreditimi në valutë.

Duke u ndalur te problemet e kreditimit, duhet theksuar se ecuria e dobët e kredisë i dedikohet në masën më të madhe kërkesës së ulët të agjentëve ekonomikë për mjete monetare. Megjithatë, edhe oferta e kredisë bankare paraqitet disi e shtrënguar.

Sistemi bankar vijon të jetë i kujdesshëm në përzgjedhjen e projekteve që financon, si pasojë e rënies së cilësisë së portofolit të kredisë dhe e pasigurive të perceptuara për të ardhmen. Bankat kanë vazhduar të mbajnë kritere të shtrënguara kredidhënieje, duke u shfaqur mjaft përzgjedhëse në vlerësimin e planeve të biznesit dhe në përmbushjen e kërkesave për kredi. Në tërësi, Banka e Shqipërisë vlerëson se krijimi i një klime më pozitive do të ndihmonte në gjallërimin e kërkesës për kredi dhe të aktivitetit kreditues. Sistemi bankar i vendit mbetet i mirëkapitalizuar, likuid dhe i aftë për t'iu përgjigjur nevojave të ekonomisë me kredi. Megjithatë, brenda parametrave të kujdesit financiar, ai duhet të jetë më largpamës në vendimet e veta dhe më fleksibël në mbështetjen financiare të biznesit shqiptar.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga prirje rënëse të normave të interesit gjatë tremujorit të tretë, të shoqëruara nga presione të ulëta likuiditeti dhe në reflektim të politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë.

Rritja e aktivitetit në tregun ndërbankar sugjeron një rritje të eficiencës së përdorimit të këtij tregu dhe është një premisë e mirë për zhvillimin e gjithë

tregut monetar në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe, janë përcjellë më mirë sinjalet lehtësuese të politikës monetare në drejtim të uljes së *yield*-eve të letrave me vlerë të qeverisë. Kjo përcjellje është favorizuar nga përfundimi i lëvizjeve strukturore në sistemin bankar dhe nga rënia e kërkesës të qeverisë për financim. Normat e interesit të depozitave kanë vijuar gjithashtu të ulen, por, sikurse reflektohet në nivelin e lartë të rritjes së depozitave këtë tremujor, ato nuk kanë frenuar rritjen e kursimeve financiare pranë sistemit bankar. Lehtësimi i kostove të financimit nuk ka gjetur përçim të plotë në segmentin e kredive për sektorin privat gjatë muajve korrik-gusht. Në veçanti, kostot shtesë që bankat kërkojnë për akordimin e kredisë së re mbeten ende të shtrënguara, në përgjigje të pasigurisë së perceptuar dhe mekanizmit reagues të tyre për reduktimin e rrezikut në procesin kredidhënës.

Në prani të një panorame ekonomike të karakterizuar nga ecuria e ngadaltë, aktuale dhe e pritur, e inflacionit dhe e kërkesës agregate, politika monetare thelloi natyrën e saj stimuluese në tremujorin e tretë. Në fund të muajit korrik, norma bazë u reduktua me 0.25 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin minimal historik prej 4.0%. Kjo ishte ulja e pestë radhazi e normës bazë, që prej muajit shtator 2011. Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të furnizojë sistemin bankar me likuiditetin e kërkuar, nëpërmjet operacioneve të saj të injektimit të likuiditetit me afate të ndryshme.

***

Zhvillimet e pritura në të ardhmen sugjerojnë se presionet inflacioniste mbeten të ulëta. Analizat dhe projeksionet tona arrijnë në përfundimin se aktiviteti ekonomik do të vijojë të mbetet nën potencial, duke ushtruar presione në kahun rënës mbi inflacion. Në të njëjtën kohë, edhe presionet e prodhuara nga faktorët e ofertës paraqiten të përmbajtur.

Bazuar në ecurinë e deritanishme të faktorëve përcaktues të inflacionit dhe projeksionet për ecurinë e tyre në të ardhmen, me një probabilitet prej 90%, inflacioni pritet të luhatet në intervalin 1.2% - 3.4% pas 12 muajsh. Zhvillimet e pritura ekonomike dhe në inflacion nënkuptojnë ruajtjen e natyrës stimuluese të politikës monetare edhe gjatë periudhës së ardhshme. Banka e Shqipërisë mbetet e vëmendshme ndaj zhvillimeve të ardhshme dhe informacionit të ri, e gatshme për të reaguar në masën dhe kohën e duhur në funksion të përmbushjes së misionit të saj ligjor.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Me rastin e çeljes së Ekspozitës "100 vjet pavarësi:
Pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare" në qytetin e Vlorës,
16 nëntor 2012

I nderuar Zoti Kryetar i Bashkisë,
Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Është një kënaqësi e madhe për mua të jem sot në Vlorë, me rastin e çeljes së Ekspozitës "100 vjet pavarësi: Pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare". Është e jashtëzakonshme pasi vetëm pak ditë na ndajnë nga festimi i njëqindvjetorit të pavarësisë sonë kombëtare.

Në cilësinë e institucionit përgjegjës për emetimin e parasë në Shqipëri, Banka e Shqipërisë e ndjen për detyrë njohjen dhe informimin e publikut të gjerë me historinë monetare të vendit. Ekspozita që po çelet sot është një kontribut në këtë drejtim, me paraqitjen e rrugëtimit të parasë në Shqipëri nga shpallja e pavarësisë deri në ditët e sotme. Kjo ekspozitë përmban një koleksion të gjerë artefaktesh të historisë monetare të shtetit shqiptar. Ajo ka një vlerë të madhe materiale dhe kulturore, për shkak se shumë prej objekteve janë unike dhe datojnë përpara emetimit të monedhës tonë kombëtare nga Banka e Shqipërisë.

Në udhëtimin e kësaj ekspozite në disa qytete të vendit si Berati, Gjirokastra, Korça, Shkodra, Tirana dhe sot pikërisht këtu në qytetin e shpalljes së pavarësisë, po shkelim në të njëjtin rrugëtim si monedha jonë kombëtare - leku. Në këtë mënyrë, ne synojmë të sjellim në vëmendje të publikut të gjerë se procesi shtetformues dhe historia jonë moderne nuk kanë të bëjnë vetëm me ngjarje politike dhe ushtarake, apo biografi personash dhe institucionesh, por janë të lidhura ngushtë edhe me historinë e monedhës sonë kombëtare.

Sapo hyn në këtë ekspozitë e ndjen menjëherë sesi historia e monedhës shqiptare ka ecur krah për krah me historinë e vet shtetit tonë, me momentet dhe figurat historike kryesore të tij. Aq të lidhura janë këto të dyja, sa kur merr në dorë një monedhë të shfaqet përpara si në një fotografi, periudha historike në të cilën ajo është prerë dhe është përdorur.

Monedha, së bashku me gjuhën, përbën një pjesë të pandarë të identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë tonë kulturore. Duke shpalosur në imazhet e veta njerëzit, ngjarjet dhe vlerat më të rëndësishme të historisë sonë, monedha ka kontribuar në forcimin e ndjenjës së identitetit kombëtar tek populli shqiptar.

Duke vepruar si një mjet i përbashkët i ndërveprimit shoqëror, paraja gjithashtu, ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në ndërtimin e një tradite dhe kujtese kombëtare, e cila ka fuqizuar ndjesinë e përkatësisë në kombin

shqiptar dhe ndarjen e një fati të përbashkët. Të gjitha këto kanë kontribuar në forcimin e sovranitetit kombëtar, sidomos kur monedha është administruar në mënyrë të qëndrueshme.

Historiani anglez i fundit të shekullit të 16, William Camden, e konsideronte paranë si elementin e pestë pas ajrit, zjarrit, tokës dhe ujit. Karakteri universal i parasë ka shqetësuar breza të tërë filozofësh dhe ka stimuluar imagjinatën njerëzore në mënyra nga më të ndryshmet. Paraja nuk është vetëm një akt ekonomik, por edhe një akt politik. Ajo përcakton kufijtë; ajo bëhet e rëndësishme për konsolidimin e identitetit të një vendi; ajo mund të krijojë premisa për konflikte dhe luftëra; por pavarësisht të gjitha këtyre, me një vullnet të mirë, paraja mund të bëhet pararendëse e paqes dhe stabilitetit të një apo shumë vendeve. Siç shprehet edhe ish kancelari gjerman Helmut Kohl 'flamuri i vërtetë i Republikës Federale Gjermane është marka gjermane'.

Nëse do të kishit jetuar në Shqipëri në periudhën e shpalljes së pavarësisë, paratë tuaja do të konsistonin kryesisht në franga ari franceze - ato që në gjuhën popullore ende sot njihen me emrin "Napolona" - dhe korona argjendi austriake. Duke qenë banorë të një qyteti bregdetar, për blerje të vogla, me shumë gjasa do të përdornit lireta dhe monedha bakri italiane. Gjatë Luftës së Parë Botërore, format kryesore të parasë nuk ishin vetëm monedhat prej ari dhe argjendi, por edhe kartëmonedha lokale, si ato të emetuara nga krahina autonome e Korçës.

Sot, ne kemi në përdorim, krahas parasë së emetuar nga Banka e Shqipërisë, edhe çeqe dhe mjete të pagesave elektronike. Në këtë mënyrë, edhe pse paraja ka marrë forma të ndryshme në kohëra të ndryshme, ajo ka qenë gjithmonë shumë e rëndësishme për njerëzit dhe për ekonominë. Madje aq e rëndësishme sa njerëzit vazhdojnë akoma të ruajnë monedha, çeqe apo kambiale të kohërave të shkuara dhe që sot nuk kanë asnjë vlerë ekonomike, si shenjë besimi që kanë tek monedha.

Projekti për një monedhë kombëtare shqiptare ishte pjesë e politikës së përgjithshme modernizuese të ndjekur nga Ismail Bej Vlora, në shtetin e sapokrijuar shqiptar.

Sipas tij, sa më shpejt që Shqipëria të forconte liritë ekonomike, aq më mirë mund të ruante lirinë e sapofituar politike, duke u shndërruar në një vend të begatë. Themeluesi i pavarësisë e konsideronte ngritjen e një banke qendrore si vendimtare për zhvillimin ekonomik të vendit, në përputhje me modelet e bankave të huaja, veçanërisht Bankës së Anglisë, e cila, në atë kohë, ishte në qendër të sistemit financiar botëror. Siç shprehet ai vet "E them me lavdërim se puna e Bankës për Shqipërinë është një i dyti fitim pas lirisë edhe nga pikëpamja ekonomike edhe politike". Edhe pse e konceptuar si një institucion me kapital privat, veprimtaria e bankës nuk do të orientohej ndaj gjenerimit të fitimit apo interesave të tjera komerciale, por drejt ofrimit të të mirave publike si emetimi i parasë dhe ushtrimi i funksionit të bankierit ndaj qeverisë, bankave dhe agjentëve të tjerë të ndërmjetësimit financiar në vend.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta, fitimi i pavarësisë nuk solli me vete krijimin e një sistemi monetar kombëtar dhe Shqipëria vazhdoi të ishte një ndër vendet e pakta që ende mbështetej mbi një qarkullim metalik monedhash të bazuar mbi arin.

Themelimi i një banke qendrore kishte një rëndësi jetike për frymëzimin e besimit të popullit shqiptar, duke e inkurajuar investimin e kursimeve në aksione dhe depozita bankare, për ta shndërruar bankën në një motor të sistemit të kreditimit në vend.

Nëse do të kthejmë sytë pas, do të shohim sesa shumë ka evoluar monedha në Shqipëri. Nga koha e shpalljes së pavarësisë, kur ari dhe argjendi konsideroheshin të vetmet forma reale të parasë, vijmë në ditët e sotme, kur Banka e Shqipërisë po projekton futjen në qarkullim të parasë elektronike.

Ndryshe nga metalet e çmuara, të cilët e ruajnë vlerën e tyre gjatë shekujve, vlera e kartëmonedhës është e barasvlershme me besimin e qytetarëve në stabilitetin e ekonomisë dhe në bankën qendrore që e hedh në qarkullim. Është pikërisht ky besim i publikut që garanton stabilitetin e monedhës dhe bën të mundur zhvillimin e një sistemi monetar modern.

Ky zhvillim është fryt i një periudhe të gjatë përvoje praktike dhe një numri të madh studimesh ekonomike, të cilat sugjerojnë se banka qendrore, përmes politikës së saj monetare, kontribuon në përmirësimin e perspektivës ekonomike dhe rritjen e standardeve të jetesës së qytetarëve, duke shmangur situatat e inflacionit dhe deflacionit të zgjatur. Gjithashtu, stabiliteti i çmimeve kontribuon në rritjen e veprimtarisë ekonomike dhe punësimit, duke nxitur mirëqenien ekonomike. Kështu, firmat dhe konsumatorët marrin vendime të informuara mbi konsumin dhe investimet; tregu i alokon në mënyrë më të efektshme burimet; potenciali prodhues dhe incentivat për të investuar në ekonomi rriten; ndërsa rishpërndarja e mirëqenies dhe të ardhurave bëhet më e drejtë, duke ndihmuar në forcimin e kohezionit shoqëror.

Për të lehtësuar ushtrimin edhe efektivitetin e politikës monetare në ekonomi, Banka e Shqipërisë i kushton një vëmendje të madhe nxitjes së edukimit ekonomik dhe financiar në vend. Ne besojmë se zgjerimi i njohurive bazë mbi mjedisin ekonomik përmirëson aftësinë e njerëzve për të procesuar informacionin e nevojshëm dhe për të marrë vendimet e duhura ekonomike.

Përveçse u mundëson qytetarëve një pjesëmarrje më efektive në shoqëri, ky edukim ndihmon gjithashtu në sigurimin e mbështetjes publike për politikat e ndjekura nga Banka e Shqipërisë.

Në realizimin e këtij misioni, busulla jonë mbetet e orientuar drejt Evropës dhe progresit të pandalshëm drejt konvergjencës ekonomike dhe ligjore me Bashkimin Evropian. Në fokus të veprimtarisë sonë do të vazhdojë të jetë forcimi i pavarësisë së Bankës së Shqipërisë, si një parakusht thelbësor për ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar në vend. Vetë monedha e përbashkët evropiane është kthyer në ankorën themelore të Bashkimit Evropian.

Mënyra më e mirë që Banka e Shqipërisë të përmbushë misionin e saj ndaj publikut është njohja dhe besimi në monedhën vendase. Një monedhë e fortë dhe e shëndetshme do të jetë një shoqëruese e pandarë e rrugëtimit tonë drejt Brukselit dhe Frankfurtit.

Zoti Kryetar i Bashkisë, zonja dhe zotërinj, sinqerisht shpresoj se do ta shijoni vizitën në Ekspozitën që jemi duke çelur sot këtu në "qytetin e flamurit". Është një kënaqësi e veçantë për mua, në emër të Bankës së Shqipërisë, ta deklaroj atë të hapur.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Mbajtur në Workshopin e 6-të të Kërkimeve Ekonomike
në Evropën Juglindore,
19 nëntor 2012

Të nderuar pjesëmarrës,
Të nderuar kolegë nga banka të tjera qendrore,

Kam kënaqësinë e madhe të jem sot këtu, në seminarin e 6-të të Kërkimeve Ekonomike në Evropën Juglindore. Ky seminar organizohet çdo vit nga Banka e Shqipërisë, për të sjellë së bashku kërkues nga rajoni ynë dhe më tej. Ne jemi shumë të gëzuar për kontributin tuaj personal si dhe për angazhimin e institucionit tuaj për këtë aktivitet. Harta e pjesëmarrjes zgjerohet nga viti në vit dhe ne e marrim këtë zhvillim si shenjë vlerësimi. Këtë vit, seminari zhvillohet ndërsa Shqipëria kremton përvjetorin e 100-të të pavarësisë së saj, e cila u shpall më 28 nëntor 1912. Ndaj, jemi shumë të lumtur t'ju mirëpresim në vigjilje të kësaj ngjarjeje të shënuar për ne.

Seminari i Kërkimeve Ekonomike në Evropën Juglindore përbën një platformë për forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e kërkimeve. Kjo traditë e konsoliduar tashmë është pjesë e kooperimit të gjithanshëm mes bankave qendrore të rajonit.

Banka e Shqipërisë beson fort në bashkëpunimin rajonal dhe për këtë arsye është kthyer në promotore të tij.

Vendet e Evropës Juglindore ngjasojnë në shumë aspekte, përfshirë problematikën ekonomike ashtu dhe kërkimin ekonomik. Aktualisht ne po punojmë për identifikimin e problemeve që kanë modelet ekzistuese. Sfida më e madhe e të gjitha sfidave është adoptimi i një filozofie dhe mënyre të re të të menduarit për hartimin dhe zbatimin e politikës.

Bankat qendrore janë mjedise të përsosura për gjenerimin dhe zhvillimin e këtyre ideve të reja. Ato sjellin bashkë një komunitet të nderuar analistësh dhe kërkuesish, si dhe një sërë problemesh që presin zgjidhje. Ky rrjet bashkëpunimi, ka mundësinë të ndikojë drejtpërdrejt mbi hartimin dhe zbatimin e politikave. Kjo karakteristikë e veçantë u jep kërkuesve në bankat qendrore mundësinë të zbatojnë gjetjet dhe të testojnë në praktikë përfundimet përkatëse.

Në këtë drejtim, përfundimet tuaja ndikojnë në mirëqenien e njerëzve dhe në rezultatet ekonomike. Për këtë arsye, është e domosdoshme që puna juaj kërkimore - shkencore të jetë e hapur ndaj gjithë faktorëve me peshë në qeverisjen e vendit. Një partner i rëndësishëm duhet të jetë dhe bota akademike vendase dhe e huaj, për të përvetësuar praktikat më të mira të metodave dhe shkrimeve akademike.

Nga një vështrim i shpejtë i programit, shoh se fokusi i punës kërkimore nga miqtë tanë është i ngjashëm me fokusin e punës kërkimore në Bankën e Shqipërisë.

Gjatë vitit të kaluar, jemi përqendruar te stabiliteti financiar dhe politika monetare, integrimi i tregtisë dhe marrëdhënieve tregtare si dhe modelimi i procesit ekonomik stokastik. Mbi të gjitha, kriza, ndërlikimet që ajo sjell, kanalet e transmetimit, dhe reagimi i politikës janë bërë qendra e kërkimit empirik dhe teorik në bankat qendrore dhe botën akademike gjatë katër vjetëve të fundit.

Rezultatet e këtij kërkimi dhe analizave i kanë çuar bankat qendrore dhe politikat e tyre rregullatore dhe monetare përtej atyre që janë quajtur kufij të shenjtë të politikës monetare. Megjithatë, koha ka provuar se kjo nuk e ka ndihmuar shumë ekonominë.

Tashmë, kanë kaluar afro pesë vjet që nga fillimi i krizës dhe sa më shumë që autoritetet merren me probleme afatshkurtra të rritjes ekonomike dhe papunësisë, aq më shumë ato nxjerrin në pah mungesë balancash dhe probleme strukturore në shkallë vendi dhe botërore. Ndërkohë, ende nuk jemi në gjendje të përkufizojmë, kuptojmë dhe modelojmë ekonominë në trajtën e saj të vërtetë stokastike.

Përgjithësisht, krizat e gjata e të thella ekonomike dhe sociale kanë ushqyer filozofitë e reja të mendimit ekonomik, duke çuar në ndryshime të rëndësishme politike dhe duke hapur rrugën drejt mirëqenies ekonomike. Mendimi ekonomik i Adam Smith, John Keynes dhe Milton Friedman është shfaqur në muzgun e krizave të mëdha.

Për fat të keq, jemi ende duke pritur një filozofi të re. Pra, ku ndodhet ky filozof? Është e qartë se na duhet një mënyrë e re e të menduarit, një qasje e re për politikën ekonomike e shumë ide të reja.

Idetë e reja nuk zbulohen lehtë, nuk shfaqen vetvetiu; ato fshihen në shtresat e të dhënave ekonomike dhe financiare, në historinë e zhvillimeve ekonomike dhe të mendimit ekonomik, në filozofinë e ndërveprimit social në nivel makro dhe mikro. Për shembull, nuk është e çuditshme që ekonomistët dhe politikanët kanë filluar të vënë në pikëpyetje disa besime që konsiderohen si të vërteta ekonomike universale.

Vihet në diskutim vërtetësia e rritjes si matës i lumturisë dhe i begatisë. Globalizimi kundërshtohet për eksternalitetet e tij në tregun e punës dhe pabarazinë. Vetë pabarazia po shqyrtohet si një keqbërës potencial i ngadalësimit ekonomik, e kështu me radhë. Kërkimi ekonomik duhet të zgjerojë gamën e vet dhe t'i përfshijë të gjitha këto fusha në punën e tij.

Puna kërkimore duhet të projektohet si një spirale në rritje, ku njohuritë e fituara rishtazi nga filozofia, historia ekonomike, kërkimi empirik dhe zbatimi i modeleve matematikore dhe statistikore, të kthehen në pikën fillestare për të

përballur të gjitha problemet e reja dhe të vjetra, për të testuar përgjithësinë e tyre, si dhe për të vlerësuar eksternalitetet potenciale.

Siç e përmenda në fillim, jemi në një vit jubilar, në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Ndaj, konferenca jonë vjetore e këtij viti u përqendrua në ecurinë e politikës monetare gjatë 100 viteve të fundit. Vëmendje e veçantë iu kushtua ndikimit të zhvillimeve politike dhe ekonomike vendase dhe të huaja në natyrën e Bankës Qendrore dhe në politikën e saj monetare.

Ndërthurja e zhvillimeve historike dhe ekonomike, larmia e regjimeve monetare, luhatshmëritë e papritura në regjimin ekonomik, politik dhe filozofik, dhe në ekonomiksin modern ishin mjaft vitalizuese, interesante dhe nxitëse të mendimit. Sigurisht që kjo meriton më shumë vëmendje.

Qasja jonë tradicionale ndaj kërkimit ka kontribuar ndjeshëm në mënyrën se si i kuptojmë çështjen e stabilitetit monetar dhe financiar, modelet me shumë parametra, parashikimet dhe analizat e goditjeve. Ajo ka pasuruar strukturën e modeleve dhe të metodologjive të disponueshme për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, si dhe ka rritur besimin tonë. Megjithatë, është koha të thellojmë njohuritë mbi bazat e sjelljes ekonomike, si një fenomen social dhe individual. Ky kuptim kërkon, ndër të tjera, një punë kërkimore kompetente mbi historinë ekonomike, sjelljen dhe mirëqenien ekonomike. E ritheksoj, s'ka pse ta bëni këtë gjë të vetëm dhe të izoluar.

Bashkëpunimi shkencor ndërkombëtar rrit mundësinë për të shfrytëzuar infrastrukturën dhe burimet kërkimore.

Ngritja e grupeve të punës me profesionistë të aftë, përfitimi nga njohuritë e krijuara përtej kufijve është diçka eficiente dhe moderne. Ne shpresojmë të kontribuojmë në këtë drejtim, nëpërmjet këtij seminari, si dhe nëpërmjet konferencave dhe aktiviteteve të tjera që organizojmë gjatë vitit.

Ju uroj suksese për seminarin dhe punën tuaj të përditshme, dhe shpresoj se njohja e punës së njëri-tjetrit të hedh themelet për bashkëpunim të mëtejshëm në të ardhmen.

Faleminderit!

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Me rastin e çeljes së Ekspozitës "100 vjet pavarësi:
Pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare"
në qytetin e Prishtinës,
23 nëntor 2012

Përshëndetje,

Së pari, si shqiptar ndihem tejet i emocionuar që ndodhem sot, në vigjilje të 100- vjetorit të shtetit tonë këtu në Kosovë, vendin e Ymer Prizrenit, Hasan Prishtinës, Isa Boletinit dhe shumë patriotëve të tjerë që bënë Shqipërinë. Si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, jam krenar të çel ekspozitën e organizuar për të kremtuar datëlindjen e njëqindtë të Shqipërisë: "100 vjet Pavarësi: Pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare". Udhëtimi i saj në disa qytete të Shqipërisë, si Berati, Gjirokastra, Korça, Elbasani, Shkodra, Tirana, Vlora, nuk do të kishte kuptim të mungonte në Prishtinë, pasi historia që paraja shqiptare shpalos është e jona, e përbashkët; historia e shqiptarëve kudo që ata jetojnë.

Kjo ekspozitë kërkon të vendosë në vëmendje të publikut të gjerë se procesi shtetformues dhe historia e shteteve moderne nuk lidhen vetëm me ngjarjet politike, ushtarake apo ekonominë reale, por lidhen ngushtë dhe me historinë e monedhës së tyre kombëtare. Vlera e parasë shkon përtej çmimit të saj! Ndër shekuj, perandori, mbretëri, fuqi ndërkombëtare kanë dokumentuar përmes konfigurimit të monedhave dhe kartëmonedhave lavdinë, historinë, traditën, vlerat kulturore dhe heronjtë kombëtarë. Në të do të shihni qartësisht se si historia e monedhës shqiptare, e cila megjithëse nuk mundi të instituohej si e tillë me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, pasqyron historinë e Shtetit Shqiptar por edhe atë të kombit. Ajo na kujton për sakrificat e atyre shqiptarëve, vlerat, trimëritë, të cilat mbështetën formimin e shtetit 100 vjet më parë.

Këto sakrifica të historisë tonë të përbashkët i mëshiron më së miri Lidhja Shqiptare e Prizrenit, një prej ngjarjeve më të ndritura të historisë së re të kombit shqiptar, e cila qëndron si themel i Shtetit Shqiptar; si e para lëvizje masive, e cila synoi të përmbushte programin madhor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, njohjen e kombit shqiptar si një bashkësi e pandarë, mbrojtjen e tërësisë territoriale të atdheut dhe formimin e një Shteti Shqiptar autonom e demokratik.

Vitet 1912-24 kanë qenë vite të rëndësishme në shekullin e kaluar. Këto ishin vite të rotacioneve politike, vite revolucionesh, vite luftërash botërore, vite ku civilizime të tëra shkuan drejt shuarjesh. Në këto vite u duk qartë fuqia e politikës dhe dominimi i saj, prandaj dhe politika dhe gjeografia ishin kryefjala e ditës.

Por, për shqiptarët nëntori i 1912-ës ishte fatprurës. Ai do t'u sillte shqiptarëve Pavarësinë, historia e të cilëve kishte lëvizur më ngadalë gjatë shekujve, e do të ndryshonte shpejtësinë pikërisht në këtë vit. Por, jo vetëm kaq. Viti 1912 dhe nëntori i tij do t'i sillte shqiptarëve simbolet kombëtare: flamurin dhe himnin, të cilët do të lidheshin pazgjidhshmërisht me njëri-tjetrin, pasi ky i fundit do të bashkonte gjithë shqiptarët duke kënduar rreth flamurit të përbashkuar. Flamuri do të sillte dhe shqiponjën dykrenare, e cila më vonë u bë simbol i shqiptarëve kudo në botë; dhe natyrshëm simbol i përdorur në monedhën tonë kombëtare.

Jam i lumtur që me anë të kësaj ekspozite të sjellim në vëmendjen e publikut ngjarje të tilla historike, siç janë edhe meritat e Ismail Qemalit, të cilat e vendosin atë në piedestalin e merituar për shkak të aktivitetit dhe vizionit të tij si shtetar dhe jo idealizmave romantike. Një ndër këto merita është përpjekja e tij për ngritjen e bankës së parë qendrore shqiptare, duke shprehur vizionin e tij të qartë për rolin e saj në sistemin ekonomik, si një qelizë bazë për rimëkëmbjen e kombit dhe prosperitetin e tij. Kjo përpjekje e tij është aktuale edhe në ditët e sotme.

Menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë, një ndër çështjet kryesore të Qeverisë ishte formimi i një banke qendrore, e cila duhet ta zhvillonte veprimtarinë e saj në përputhje me normat e bankave kombëtare të shteteve evropiane. Ismail Qemal bej Vlora e konceptoi krijimin e bankës së parë qendrore shqiptare si një institucion financiar, i cili duhej t'i jepte jetë zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të shtetit të pavarur shqiptar. Për fat të keq, Shteti Shqiptar lindi në vigjilje të Luftës së Parë Botërore dhe zhvillimet historike e lanë projektin e bankës vetëm në letër. Megjithatë, krijimin e Bankës Kombëtare, Ismail Qemal bej Vlora do ta quante si të dytën fitore pas shpalljes së Pavarësisë. Në një ndër fjalimet e tij ai do të shprehej: "Shqipëria, që atë ditë kur pati fatin e bardhë të bëhet një shtet në mes të shteteve të Ballkanit e të Evropës, ka të drejtë të ketë një edhe më tepër banka për të siguruar kreditin e botshëm (publik) si popull, edhe kreditin e veçantë për secilin shqiptar, si njeri. Këtë na e donte shpirti, por nuk guxonim ta prisnim të bëhej kaq shpejt nga shkaku që punët e Shqipërisë, qoftë nga kufijtë, qoftë nga organizimi i vendit që kemi, nuk kanë marrë fund. Pas shumë marrëveshjeve dhe pasi këmbyen shumë mendime, kabineti e pranoi projektin e fundit, i cili u nënshkrua. E themi me lavdërim se puna e bankës, për Shqipërinë është një i dyti fitim pas lirisë dhe nga pikëpamja ekonomike dhe politike".

Fjalët e tij vizionare qëndrojnë po aq të vlefshme edhe sot. Kriza ekonomike dhe financiare, rishtazi na dëshmoi se roli i bankave qendrore është themeltar për stabilitetin dhe mirëqenien e një vendi. Ai është gjithashtu, mjaft i lidhur edhe me aspekte të tjera, me rolin e monedhës si një dëshmi historike dhe artistike e kombeve ndër shekuj. Nëse e kthejmë vëmendjen tek leximi i parasë, duhet të kuptojmë se çdo monedhë dhe kartëmonedhë është një tregim, i shtypur në metal apo në letër, një rebus apo një pazëll piktoresk. Rrjedhimisht, pas besueshmërisë monetare qëndron një mesazh. Sidoqoftë, ky mesazh apo tregim do të marrë rëndësi më të madhe nëse "emetohet" edhe një tjetër tregim, përmes emetimit të serive të reja të monedhës. Prandaj "tregimi i parasë" është gjithmonë në shkruajtje e sipër.

Mesazhi që na jep "tregimi i parasë shqiptare", përmes Ismail Qemalit, portreti i të cilit qëndron në kartëmonedhën 500 lekëshe të qarkullimit, na thotë se ai, Ismail Qemal Vlora, së bashku me patriotët e kombit tonë, ditën të rreshtin të gjitha kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet dhe të na jepnin rezultate të jashtëzakonshme.

Mendoj se vizioni i tyre si shtetar shqiptar duhet të jetë në qendër të një tregimi të përbashkët në të ardhmen. Ne shqiptarët duhet të punojmë të bashkuar për të jetuar nën të njëjtin qiell dhe nën të njëjtin flamur: Atë të Bashkimit Evropian!

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit
Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
27 nëntor 2012

Sot, në datën 27 nëntor 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 4.00%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme. Këto kushte ofrojnë njëkohësisht dhe stimulin e nevojshëm monetar për mbështetjen e kërkesës së brendshme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Inflacioni vjetor në muajin tetor shënoi 2.4%, duke shënuar rënie për të dytin muaj radhazi. Ecuria e tij është përcaktuar kryesisht nga zhvillimet në çmimet e produkteve ushqimore, të cilat kanë kontribuuar me rreth 70% në krijimin e vlerës së inflacionit. Çmimet e mallrave të tjerë kryesore të shportës së konsumit kanë lëvizur në kahe të ndryshme, duke ruajtur kontributin e tyre në të njëjtat nivele me muajt e mëparshëm.

Nga këndvështrimi i faktorëve makroekonomikë, ecuria e inflacionit vijon të përcaktohet kryesisht nga veprime të faktorëve të përkohshme të ofertës, me origjinë në tregjet ndërkombëtare si edhe ndryshime strukturore të tregut vendas. Nga ana tjetër, ecuria e ngadaltë e aktivitetit ekonomik është shoqëruar me rritje të ulët të kostove të prodhimit dhe me presione të ulëta mbi inflacionin. Gjithashtu, moderimi i ritmeve të rritjes së treguesve monetarë, rritjet e ulëta të çmimeve në tregjet botërore dhe mirë-ankorimi i pritjeve inflacioniste kanë gjeneruar presione të përmbajtura inflacioniste. Në vija të përgjithshme, kjo situatë pritet të vazhdojë edhe gjatë periudhës së ardhshme.

Të dhënat mbi aktivitetin ekonomik gjatë tremujorit të tretë të vitit janë të pjesshme dhe mbështeten mbi tregues të tërthortë. Analiza e tyre tregon për një rritje pozitive, por të ulët, të ekonomisë vendase në këtë periudhë. Sektorët të cilët kanë mbështetur rritjen ekonomike vlerësohen të kenë qenë industria, bujqësia dhe shërbimet, ndërkohë që aktiviteti në sektorin e ndërtimit nuk vëren shenja të përmirësimit të aktivitetit aktual apo të pritur. Nga kahu i kërkesës agregate, kërkesa e huaj vijon të jetë nxitësi kryesor

i rritjes së aktivitetit ekonomik edhe në tremujorin e tretë të vitit. Kërkesa e brendshme shfaqet ende e dobët, e kushtëzuar nga mungesa e stimulit fiskal dhe plogështia e konsumit dhe investimeve private.

Politika fiskale ka patur një natyrë konsoliduese gjatë vitit 2012. Kjo politikë është reflektuar në uljen me 19% të deficitit buxhetor gjatë 10 muajve të parë të vitit, duke i shërbyer ruajtjes së qëndrueshmërisë së treguesve fiskalë në këtë periudhë. Nga ana tjetër, ecuria e shpenzimeve dhe e deficitit buxhetor nuk kanë mbështetur rritjen e kërkesës agregate.

Shpenzimet publike të dhjetë muajve të parë të vitit rezultojnë 0.2% më të ulëta se një vit më parë, një zhvillim i cili pasqyron edhe rritjen e ulët të të ardhurave buxhetore. Këto të fundit janë rritur me ritme të ulëta vjetore gjatë gjithë vitit dhe, në fund të muajit tetor, ato ishin vetëm 2% më të larta se një vit më parë. Banka e Shqipërisë vlerëson se, ndonëse sjellja e kujdesshme nuk ka patur një ndikim direkt pozitiv në rritjen ekonomike të kësaj periudhe, ajo ka ndihmuar në kontrollin e primeve të rrezikut dhe në uljen e normave afatgjata të interesit, duke favorizuar kështu nxitjen e investimeve private. Duke parë nga e ardhmja, ne vlerësojmë se politika fiskale duhet të ruajë orientimin e saj drejt qëndrueshmërisë së treguesve fiskalë, në mbështetje të stabilitetit ekonomik e monetar të vendit dhe si një parakusht i rëndësishëm i rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

Kërkesa e huaj ka vijuar të mbështesë rritjen e eksporteve dhe të aktivitetit ekonomik gjatë gjithë vitit 2012. Deficiti tregtar është ngushtuar me 7.9% në tremujorin e tretë të vitit, duke reflektuar kryesisht ecurinë e mirë të eksporteve. Këto të fundit u rritën me 17% në tremujorin e tretë, duke ruajtur prirjen pozitive të tremujorëve paraardhës. Nga ana tjetër, ecuria e importeve vijon të jetë e dobët, në reflektim të kërkesës së ulët për konsum e për investime. Në tremujorin e tretë të vitit, importet shënuan një rritje vjetore pozitive prej vetëm 0.7%.

Ecuria e treguesve monetarë dëshmon për presione të moderuara inflacioniste me natyrë monetare. Ritmi i rritjes vjetore të parasë së gjerë është ngadalësuar në 6.8% në muajin shtator. Në pasqyrim të ecurisë së dobët të kërkesës së brendshme, kërkesa e agjentëve ekonomikë për mjete monetare ka qenë e ulët.

Kërkesa e dobët për mjete monetare është shoqëruar me rënien e vazhdueshme të kontributit të financimit të sektorit publik e privat në rritjen e ofertës monetare gjatë gjithë vitit 2012. Kredia për sektorin privat ka vijuar të ngadalësohet edhe këtë muaj; ritmi i rritjes vjetore së saj arriti në 4.2%, duke shënuar një ndër nivelet më të ulëta historike.

Zhvillimet e fundit në tregjet financiare kanë reflektuar kushte të lehtësuara monetare dhe prime të ulëta apo në rënie të rrezikut të likuiditetit dhe inflacionit. Normat e interesit në tregun ndër-bankar kanë qenë në rënie, në ndjekje të sinjaleve të dhëna nga politika monetare. Në të njëjtën kohë, me sheshimin e problemeve strukturore në tregun primar, edhe *yield*-et e

bonove të thesarit kanë shënuar rënie të shpejtë në të gjitha maturitetet. Në një treg të qetë financiar dhe në mungesë të goditjeve shtesë në të ardhmen, lehtësimet e mëparshme të politikës monetare pritet të vijojnë të përcillen edhe në segmente të tjerë të tregut financiar. Në këto kushte, rritja e stimulit monetar në ekonomi do të mbështesë më tej nxitjen e kërkesës agregate, pa cënuar ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në afat të mesëm.

Në një masë të madhe, zhvillimet në kredi dhe në tregjet financiare reflektojnë hezitimin e individëve dhe të bizneseve për të ndërmarrë angazhime afatgjata. Megjithatë, shkalla e ngadaltë e rritjes së kredisë pasqyron edhe sjelljen e kujdesshme të bankave në kreditim. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë vëren se, megjithë rreziqet afatshkurtra të gjeneruara kryesisht nga mjedisi i jashtëm i ekonomisë, perspektiva afatmesme dhe afatgjatë e zhvillimit të vendit mbetet e shëndetshme. Konsumatori dhe biznesi shqiptar duhet të jenë më realistë në planet e tyre të zhvillimit dhe të adoptojnë një përqasje më pragmatiste drejt rritjes së konsumit dhe të investimeve aktuale.

Po ashtu, bilancet e shëndosha të sistemit bankar duhet të vihen më shumë në mbështetje të ekonomisë me fonde financiare, nëpërmjet rritjes së kreditimit.

Duke parë nga e ardhmja, informacioni i ri i marrë gjatë muajit të fundit konfirmon projeksionet tona të mëparshme mbi ecurinë e pritur të ekonomisë shqiptare përgjatë horizontit të veprimit të politikës monetare. Aktiviteti ekonomik në vend pritet të rritet me norma pozitive, por këto norma pritet të mbeten të ulëta dhe nën potencial. Ecuria e dobët e konsumit dhe investimeve private kufizon hapësirat e rritjes ekonomike. Nga ana tjetër, informacioni paraprak tregon se stimuli fiskal mund të jetë në rritje gjatë vitit të ardhshëm, duke plotësuar kërkesën e huaj si një mbështetës afatshkurtër i rritjes ekonomike gjatë vitit të ardhshëm. Megjithatë, efekti tërësor i stimulit fiskal do të varet nga reagimi i sektorit privat dhe ai i tregjeve financiare. Ndërkohë, efekti afatgjatë i tij do të varet nga kostot shtesë që do të sjellë ai në buxhet.

Banka e Shqipërisë gjykon se kërkesa agregate nuk do të ushtrojë presione rritëse mbi inflacionin. Në prani të një ambienti të qëndrueshëm monetar, të pritjeve të ankoruara inflacioniste, si dhe të një ndikimi të moderuar të çmimeve të huaja dhe të kursit të këmbimit, inflacioni pritet të qëndrojë pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë në periudhën e ardhshme. Në këto rrethana, politika jonë monetare pritet të vijojë të ruajë natyrën e saj stimuluese në një afat të mesëm.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 4.0%.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit
Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
20 dhjetor 2012

Sot, në datën 20 dhjetor 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 4.00%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme. Njëkohësisht, ato ofrojnë edhe stimulin e duhur monetar për mbështetjen e kërkesës së brendshme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Inflacioni vjetor në muajin nëntor shënoi vlerën 2.5%. Pjesa më e madhe e inflacionit vijon të përcaktohet nga ecuria e çmimeve të produkteve ushqimore. Kontributet e grup-mallrave të tjerë kryesorë kanë mbetur të pandryshuara në krahasim me muajin e mëparshëm. Luhatjet e inflacionit janë përcaktuar kryesisht nga faktorë të ofertës, me origjinë të brendshme dhe të huaj. Gjithsesi, goditjet e ofertës kanë patur një intensitet të ulët dhe një veprim të shkurtër në kohë. Këshilli Mbikëqyrës konstaton se zhvillimet në ekonominë reale dhe në tregjet financiare kanë prodhuar presione të ulëta inflacioniste. Ekonomia shqiptare vijon të mbetet nën potencial dhe kjo reflektohet në një rritje të ulët të pagave dhe të kostove të prodhimit. Çmimet në tregjet botërore dhe ecuria e kursit të këmbimit kanë qenë relativisht të qëndrueshme, duke mos ushtruar presione për rritjen e çmimeve në vend. Po kështu, inflacioni i pritur mbetet i ankoruar rreth objektivit tonë prej 3%. Së fundi, zhvillimet monetare karakterizohen nga një kërkesë e ulët për mjete monetare likuide. Politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka kontribuuar në nxitjen e kërkesës agregate, në administrimin e likuiditetit në sistem dhe në kontrollin e pritjeve inflacioniste. Kjo tablo e presioneve inflacioniste pritet të ruhet edhe në horizontin afatmesëm.

Mbulimi me shifra i aktivitetit ekonomik gjatë gjysmës së dytë të vitit është jo i plotë. Megjithatë, analiza e të dhënave të tërthorta konfirmon vlerësimet e mëparshme për një rritje pozitive në këtë periudhë, në nivele të ngjashme me tremujorin e dytë të vitit. Rritja ekonomike është mbështetur më së shumti nga kërkesa e huaj, ndërkohë që kërkesa e brendshme paraqitet ende e dobët.

Shpenzimet konsumatore vlerësohen të jenë rritur gjatë tremujorit të tretë, duke u reflektuar edhe në një aktivitet më të mirë të sektorit të shërbimeve. Megjithatë, konsumi privat mbetet i dobët, si pasojë e ecurisë së ngadaltë të ekonomisë dhe e pasigurisë së perceptuar për të ardhmen. Ecuria e tij në afat të mesëm mbetet ende e paqartë. Gjithashtu, investimet private mbeten të ulëta, në prani të shfrytëzimit jo të plotë të kapaciteteve të prodhimit, të pasigurisë mbi ecurinë e kërkesës së brendshme dhe të huaj, si dhe të kushteve më të shtrënguara të financimit nga sektori financiar.

Kërkesa e sektorit publik ka qenë gjithashtu e ulët në tremujorin e tretë, duke mos ndihmuar rritjen e kërkesës agregate. Deri në fund të muajit tetor, deficiti buxhetor i këtij viti është rreth 19.0% më i ulët se një vit më parë. Politika fiskale e ndjekur gjatë tre tremujorëve të parë të vitit është materializuar në një rënie vjetore të shpenzimeve publike në këtë periudhë, ndërkohë që rritja e të ardhurave ka qenë e ulët dhe deficiti buxhetor i kontrolluar. Nga ana tjetër, tremujori i katërt dhe viti 2013 pritet të karakterizohen nga rritja e shpenzimeve fiskale dhe e deficitit buxhetor. Kjo politikë fiskale rrit stimulin makroekonomik në afat të shkurtër, por ajo duhet të jetë e kujdesshme ndaj nevojës për qëndrueshmëri afatmesme dhe afatgjatë të borxhit publik.

Kërkesa e huaj ka qenë burimi kryesor i rritjes së aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë të vitit. Të dhënat më të fundit nga tregtia e jashtme konfirmojnë të njëjtën ecuri edhe në periudhën pasuese. Kështu, në muajin tetor, deficiti tregtar ka vijuar tendencën korrektuese, duke u ngushtuar me 10.3% në terma vjetorë. Ecuria e tij ka reflektuar kryesisht performancën e mirë të eksporteve, të cilat kanë ruajtur ritme pozitive të rritjes vjetore, prej 12.0% në këtë muaj. Importet gjithashtu kanë ndihmuar në ngushtimin e deficitit tregtar, duke u tkurrur me 2.3% në terma vjetorë në këtë muaj.

Analiza e treguesve monetarë tregon për presione të ulëta monetare mbi ecurinë e çmimeve. Rritja e ofertës së parasë, M3, ka vijuar të ngadalësohet më tej në muajin tetor, duke zbritur në 6.2%. Në mënyrë të veçantë, financimi i sektorit privat është ngadalësuar ndjeshëm. Rritja vjetore e kredisë për sektorin privat shënoi 2.4% në muajin tetor, duke zbritur në nivele të ulëta historike. Në një masë të madhe, ajo është ndikuar nga kërkesa e ulët e individëve dhe bizneseve për financim, sikurse pasqyrohet edhe nga ecuria e konsumit dhe e investimeve private. Nga ana tjetër, edhe sistemi bankar vijon të tregojë kujdes të shtuar në kreditim, ndonëse gëzon kushte të mira likuiditeti e kapitali.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga rënia e primeve të rrezikut të likuiditetit. Normat e interesit në tregun ndër-bankar janë ulur më tej në muajin nëntor, në reflektim të likuiditetit të bollshëm dhe të kushteve të lehtësuara monetare. Në tregun primar, *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë vijuar të bien. Gjithashtu, normat e interesit të depozitave dhe të kredive në lekë kanë shënuar rënie, duke vijuar përgjigjen ndaj sinjaleve të politikës monetare. Në periudhën në vazhdim, pritet një reagim më i plotë i ekonomisë reale ndaj kushteve të lehtësuara monetare.

***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjykon se inflacioni do të mbetet në nivele të ulëta dhe afër objektivit të Bankës së Shqipërisë në periudhën afatmesme. Ecuria e pritur e ekonomisë së brendshme, e ekonomisë së huaj, dhe e tregjeve financiare nuk parashikohet të gjenerojë shmangie të inflacionit nga objektivi i synuar prej 3.0%. Në këto kushte, dhe në mungesë të goditjeve të papritura të ofertës, çmimet e konsumit do të rriten me norma të ulëta dhe brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 4.00%. Mbajtja në nivele minimale e normës bazë të interesit ruan karakterin stimulues të politikës monetare, duke i mundësuar ekonomisë reale të përfitojë nga kushtet më të mira të financimit gjatë vitit 2013. Gjithashtu, kjo politikë ndihmon në kontrollin e pritjeve të inflacionit, duke ndihmuar në uljen e normave afatgjata të interesit.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Në takimin përmbyllës të vitit me Shoqatën Shqiptare të Bankave,
20 Dhjetor 2012

Të nderuar drejtues të bankave,

Në përfundim të këtij viti kalendarik dhe financiar, po shfrytëzoj këtë mundësi për të komunikuar me ju rreth arritjeve dhe sfidave të sektorit bankar, me besimin që ato do të shërbejnë për të orientuar veprimet tona për vitin e ardhshëm.

Ashtu siç pritej, viti 2012 ishte mjaft sfidues për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të vendit dhe të agjentëve të ndryshëm ekonomikë. Me shumë të ngjarë, rritja ekonomike gjatë këtij viti do të mbetet pozitive, por ndjeshëm më e ulët se vitin e kaluar. Kjo ecuri e ekonomisë është diktuar prej rënies së stimulit fiskal e monetar, si edhe prej ngadalësimit të konsumit dhe të investimeve private. Ngadalësimi i këtyre të fundit, është shoqëruar sidoqoftë me një ulje të importeve. Nga ana tjetër, kërkesa e huaj ka mbështetur më mirë rritjen e eksporteve, veçanërisht të produkteve të energjisë. Kjo ka sjellë një përmirësim të bilancit tregtar gjatë vitit 2012, duke shënuar rënie të deficitit në raport me PBB-në e vendit. Ndikimi i krizës ekonomike globale, vijon të jetë i pranishëm dhe perspektiva për një kapërcim të saj në vitin 2013 mbetet një shpresë, e cila nuk mbështetet nga pritjet e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe autoritetet publike, veçanërisht për situatën ekonomike në Eurozonë.

Gjatë vitit 2012, në tërësi, sektori bankar shënoi rezultat financiar pozitiv. Të ardhurat neto nga interesat ishin të qëndrueshme, por provigjonet për rrezikun e kredisë ulën madhësinë e fitimit. Sektori bankar ruajti përgjithësisht kontrollin mbi kostot e tjera të veprimtarisë. Treguesit e likuiditetit, afatshkurtër dhe ai strukturor, u paraqitën në nivele të kënaqshme. Të gjitha bankat plotësuan kërkesat e kuadrit rregullativ për madhësinë e aktiveve likuide, si në lekë ashtu edhe në valutat kryesore. Rritja e depozitave vijoi me ritme të mira, ndonëse në nivele më të ulëta se vitin e kaluar.

Si pasojë edhe e ngadalësimit të kreditimit, raporti kredi/depozita paraqitet në nivele shumë të përshtatshme për të mbështetur nevojat për likuiditet të sektorit. Treguesit e kapitalizimit të veprimtarisë qëndruan në nivele të mira, për shkak të rritjes së kapitalit nga disa banka dhe ngadalësimit të rritjes së aktiveve me rrezik. Gjatë vitit, Banka e Shqipërisë zbatoi kërkesa më të larta për likuiditet dhe kapitalizim të bankave në përputhje me profilin e rrezikut të veprimtarisë së tyre.

Në tregun ndërbankar, viti 2012 shënoi rritje të vëllimit të tregtimit dhe të pjesëmarrjes. Kjo ecuri është ndikuar prej lëvizjeve strukturore të likuiditetit, kërkesave të bankave dhe operacioneve në treg të Bankës së Shqipërisë në mbështetje të tyre.

Normat e interesit në treg kanë ardhur në rënie, duke reflektuar ecurinë e normës bazë të interesit dhe veprimet e bankave për të kontrolluar kostot e veprimtarisë dhe marzhet e fitimit. Tregu i këmbimeve valutore ka qenë i stabilizuar, megjithë rritjen e vëllimit të tregtimit dhe rritjen e pjesëmarrësve në treg. Bankat janë treguar aktive dhe të kujdesshme në shërbimin e kërkesave për valutë të klientëve të tyre.

Të nderuar drejtues të bankave,

Me lejoni tani të përqendrohem në disa çështje, që përbëjnë shqetësim për industrinë bankare dhe për Bankën e Shqipërisë, dhe që besojmë se duhen adresuar me kujdes gjatë vitit të ardhshëm.

Po e filloj me kreditimin, si aktiviteti me ndikimin kryesor në rezultatin financiar të bankave. Konstatojmë një rënie të ritmit të kreditimit dhe vijim të rënies së cilësisë së kredisë, veçanërisht për kredinë në valutë. Kjo ecuri ka si shkak kryesor rënien e kërkesës, por edhe një hezitim të qëndrueshëm nga bankat për të kredituar. Kjo prirje duhet të ndryshojë, duke adresuar problemet që rriten me ritmin e kredidhënies, si edhe ato që lidhen me trajtimin e kredive me probleme.

Rritja e qëndrueshme e depozitave si edhe rritja e ndjeshme e investimeve tek jorezidentët tregojnë që bankat kanë burime të mjaftueshme financiare për të kredituar me ritme më të larta. Këto burime duhet të përdoren për të kredituar kryesisht sektorin privat në vend, duke vepruar sigurisht në përputhje me kuadrin rregullativ dhe politikat tuaja për diversifikimin e investimeve. Nga ana tjetër, përpjekjet për adresimin e kredive me probleme duhet të shumëfishohen, si në drejtim të parandalimit ashtu edhe për trajtimin e tyre. Fokusi juaj duhet të jetë në procesin e kujdesshëm të ristrukturimit të kredive, veçanërisht përpara se ato të shndërrohen në kredi me probleme. Më tej, duhet vepruar me kujdes por në mënyrë konsistente për ekzekutimin e kolateralit tek kreditë pa shpresë arkëtimi. Ne i njohim tashmë problemet që ekzistojnë në këtë drejtim. Por konstatoj që, në sajë edhe të punës suaj, ndërgjegjësimi i autoriteteve publike vendimmarrëse rreth tyre është përmirësuar ndjeshëm. Pata rastin që të komunikoj rreth këtyre problemeve edhe sot, me përfaqësues të Komisionit të Ekonomisë dhe Financës në Kuvend. Kam besim se puna e nisur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për rishikimin dhe përmirësimin e disa akteve ligjore të rëndësishme, duke përfshirë edhe Kodin e Procedurës Civile, do të finalizohet me përfshirjen dhe miratimin në to të disa propozimeve konkrete që industria bankare dhe Banka e Shqipërisë kanë paraqitur për përmirësimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit.

Më tej, në përfundim të proceseve ligjore, është e nevojshme të procedohet me shpejtësi për fshirjen nga bilanci të kredive të humbura, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ. Ne kërkojmë nga ju dhe aksionerët tuaj

të dedikoheni në këtë proces, për të gjetur jo vetëm burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, por edhe format më të përshtatshme për të siguruar një trajtim të shpejtë, transparent dhe konsistent të kredive me probleme.

Duhet mbajtur parasysh që kreditimi, përmban rreziqe të cilat është e vështirë të njihen me saktësi që në momentin e dhënies së kredisë. Këto rreziqe përcaktohen jo vetëm nga cilësia e procedurave të kredidhënies së bankave, por edhe nga faktorë të jashtëm të rëndësishëm, ku përfshihet edhe ecuria e ekonomisë. Kjo pasiguri shoqëron edhe fazën aktuale në të cilën gjendet sektori ynë bankar. Për këto arsye është e nevojshme që strukturat drejtuese në banka dhe aksionerët, të angazhojnë burimet e nevojshme financiare për të përballuar kosto të mundshme shtesë në të ardhmen. Për aksionerët, kjo do të thotë që jo vetëm të pranojnë lënien në bankë të fitimeve të veprimtarisë, por edhe të shtojnë kapital të ri në rast nevoje. Kujtojmë që kjo përfaqëson edhe një prirje më të përgjithshme të industrisë bankare në nivel global, ku një sërë standardesh të reja parashikojnë përmirësimin e cilësisë së kapitalit dhe rritjen e madhësisë së tij. Bankat tona duhet të fillojnë gradualisht të përshtaten me këto standarde.

Për ju si drejtues, mbetet parësor forcimi i sistemeve të kontrollit të veprimtarisë së bankës, veçanërisht në aktivitetet ku gjenerohen të ardhurat dhe shpenzimet kryesore të veprimtarisë. Strukturat e administrimit të rrezikut duhet të fuqizohen realisht dhe të kenë një zë më të fuqishëm në vendimmarrje. Bankat duhet të vijojnë më tej me përmirësimin e eficiencës së veprimtarisë së tyre, duke përfshirë edhe vendosjen e një kontrolli më të mirë mbi kostot e veprimtarisë. Përcaktimi i aktiviteteve që kanë përparësi për institucionin tuaj, do të mundësojë identifikimin e nevojave të reja për investime, por edhe ato veprimtari që përfaqësojnë një përdorim joeficient të burimeve të bankës, e që duhen ristrukturuar. Ky proces do të ndikojë pozitivisht në rezultatin financiar të institucionit, dhe do të lejojë zbatimin e politikave të tjera aktive në drejtime të tjera që sjellin dobi për veprimtarinë e bankës.

Të gjithë e dimë që bankingu është një veprimtari e mbështetur tek besimi. Për këtë arsye, shërbimet e bankës ndaj klientëve duhet të jenë të klasit të parë, në të gjithë rrjetin e bankës. Kjo do të thotë që klientët duhet të shërbehen me korrektesë, në kohën e duhur dhe me transparencë. Shërbimet e bankave duhet të ofrohen në përputhje me kulturën financiare të klientëve të tyre, duke evidentuar në çdo rast përfitimet dhe rreziqet që klientët mund të kenë nga produktet bankare që mund të përdorin.

Banka e Shqipërisë, në kuadër të rolit të saj si mbikëqyrëse dhe rregulluese e veprimtarisë bankare, do të vijojë të monitorojë dhe të adresojë me kujdes sfidat me të cilat ndeshet kjo veprimtari. Kuadri ynë rregullativ dhe veprimtaria jonë operacionale e mbikëqyrëse do të përshtatet sipas nevojës për të dhënë të gjithë mbështetjen e nevojshme që veprimtaria bankare të kryhet e sigurt, me përfitim të shumëfishtë për vetë industrinë, për klientët dhe për ekonominë në përgjithësi. Në bazë të veprimtarisë sonë do të jetë komunikimi profesional dhe i vazhdueshëm me ju, për të identifikuar së bashku zgjidhjet më të mira që adresojnë nevojat tuaja dhe ato të grupeve të tjera të interesit.

Të nderuar drejtues të bankave,

Në mbyllje, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj një nga mësimet e mëdha të dala nga kriza, që kaloi sistemi financiar botëror, dhe që mendoj se është aktuale edhe në kushtet e Shqipërisë: përqendrimi në horizonte kohore afatshkurtra është i dëmshëm si për institucionet individuale financiare që angazhohen në to, ashtu edhe për gjithë sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi. Në këtë kontekst, ju ftoj të gjithëve të bëheni më largpamës në analizat e vendimmarrjet tuaja për të ardhmen e ekonomisë shqiptare dhe të industrisë së saj bankare.

Në vizionin tim, por edhe në konkluzionet e të gjitha analizave që fokusohen në këtë çështje, Shqipëria ka potenciale të mëdha, në një masë të madhe të pashfrytëzuara, për të mbështetur një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe konverguese me ekonomitë e partnerëve tanë të Eurozonës. Pavarësisht vështirësive afatshkurtra, të origjinuara në një masë të madhe jashtë saj, themelet e zhvillimit ekonomik të vendit mbeten të shëndosha. Stabiliteti makroekonomik, burimet natyrore, struktura dhe kostoja e fuqisë punëtore, e bëjnë investimin afatgjatë në ekonominë shqiptare një investim me kthim të sigurt.

Ju ftoj të gjithëve të bëheni pjesë e këtij vizioni; të angazhoheni më shumë në mbështetjen e ekonomisë shqiptare me kredi dhe shërbime financiare; si dhe të eksploroni fusha dhe drejtime të reja të zhvillimit ekonomik të vendit. Jam i bindur se ky është jo vetëm shërbimi më i mirë që mund t'i bëni vendit, por edhe strategjia më e mirë për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe fitimprurës të industrisë bankare në Shqipëri.

Të gjithë së bashku, nuk duhet të lejojmë që problemet afatshkurtra të shndërrohen në dobësi dhe në raste të humbura në afat të gjatë.

Tek Banka e Shqipërisë, ju do të gjeni gjithnjë një institucion tërësisht të vendosur në respektimin e objektivit të saj të stabilitetit të çmimeve dhe të stabilitetit financiar, një rregullator të drejtë dhe largpamës në fushën e mbikëqyrjes bankare, një administrues eficient të likuiditetit dhe të tregjeve financiare, si dhe një institucion thellësisht profesional dhe të dobishëm në analizat e saj makroekonomike.

Së fundi, dëshiroj të bëj një urim të sinqertë për mbarësi në jetën tuaj profesionale dhe personale, gjatë vitit të ri 2013!

Faleminderit.

# ANALIZA PERIODIKE*

** Pikëpamjet e shprehura në këto materiale janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

# ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR, T4 - 2012

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE, OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, JANAR 2013

## 1. BANKAT DHE NDËRMJETËSIMI FINANCIAR

Sistemi financiar shqiptar në fund të vitit 2012 vijon të dominohet nga sektori bankar. Sektori bankar përbëhet nga 16 banka private, ku bankat me kapital të huaj mbizotërojnë, duke zënë rreth 90% të totalit të aktiveve të sistemit. Në fund të muajit nëntor 2012, portofoli i kredisë për sektorin privat përbën rreth 42.7% të totalit të aktiveve të sistemit bankar, ndërsa depozitat zënë rreth 75% të pasivit.

Treguesit e ndërmjetësimit financiar për tremujorin e fundit[1] kanë ndjekur përgjithësisht një trajektore rënëse kundrejt një tremujori më parë. Raporti i kredisë për sektorin privat ndaj prodhimit të brendshëm bruto në fund të muajit nëntor ka shënuar vlerën 39.4%, ose rreth 1 pikë përqindje më i ulët se në fund të muajit shtator. Këto zhvillime kanë reflektuar ecurinë e plogësht të aktivitetit kreditues të sektorit privat gjatë kësaj periudhe. Sistemi bankar vijon të mbetet i mirëkapitalizuar dhe me likuiditet të mjaftueshëm. Por, megjithë monetizimin në rritje, sistemi bankar ka ngadalësuar ndërmjetësimin e këtyre fondeve në kanalin e kredisë. Kërkesa e ulët për kredi dhe politikat e kujdesshme të bankave në kreditim kanë ndikuar në ngadalësimin e mëtejshëm të normave të rritjes së kredisë së sektorit privat, si për individët ashtu edhe për bizneset.

Grafik 1. Kredia e sektorit privat dhe depozitat në raport me PBB*-në, (në %).




*Raportet janë llogaritur me një vlerësim të përafërt të PBB-së nominale për muajin nëntor, i cili bazohet në PBB-në e publikuar nga INSTAT dhe në vlerësimet e Departamentit të Politikës Monetare.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[1] *Të dhënat më të fundit monetare në analizë janë për muajin nëntor'12.*

Ndërmjetësimi financiar i matur si raport i kredisë për ekonominë ndaj totalit të depozitave në sistemin bankar, ka shfaqur shenja ngadalësimi gjatë vitit 2012, sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit. Në muajin nëntor, ky raport shënoi një vlerë prej 59.6% kundrejt 59.9% që shënonte në fund të tremujorit të tretë, dhe rreth 2.3 pikë përqindje më e ulët se në fund të vitit 2011. Ndërkohë, ngadalësimi i zgjerimit të stokut të depozitave në muajt tetor-nëntor të këtij viti ka ndikuar dhe në rënien e lehtë të raportit të tyre ndaj PBB-së krahasuar me tremujorin e tretë, duke shënuar një vlerë prej 69.1%.

Grafik 2. Raporti i kredisë ndaj depozitave; depozitat ndaj parasë së gjerë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 2. ECURIA E NDËRMJETËSIMIT

Treguesit e tremujorit të katërt tregojnë për thellimin e rolit ndërmjetësues të sistemit bankar në monedhën vendase. Raporti prej 45.6% i kredisë ndaj depozitave në lekë, është rreth 1.7 pikë përqindje më i lartë se një tremujor më parë dhe rreth 3.8 pikë përqindje më i lartë krahasuar me fundin e vitit 2011. Për tremujorin e katërt ky tregues shënoi dhe rritjen më të madhe tremujore për vitin 2012. Kjo përformancë pozitive është mbështetur nga orientimi i politikave të kreditimit të bankave drejt monedhës vendase si dhe nga qëllimi kryesor i përdorimit të kredisë së marrë nga agjentët ekonomikë. Ndërkohë, ecuria e depozitave ka qenë pozitive, por duke qëndruar në trendin ngadalësues të ritmeve vjetore të rritjes.

Për të njëjtën periudhë, aktiviteti ndërmjetësues në valutë është tkurrur me ritme më të ulëta se në tre tremujorët e tjerë të vitit. Kështu raporti prej 73.9% i kredisë ndaj depozitave në valutë është përkatësisht rreth 2 dhe 10 pikë përqindje më i ulët se në tremujorin e mëparshëm dhe se në fund të vitit 2011. Kjo ecuri është përcaktuar jo vetëm nga tkurrja e portofolit të kredisë që prej muajit prill, por edhe nga ecuria e mirë e depozitave në valutë, në përgjigje të prurjeve valutore nga jashtë. Ndërkohë, në muajin nëntor, rënia e depozitave në valutë krahasuar me tremujorin e tretë duket të ketë ndihmuar në frenimin e ritmeve të tkurrjes së raportit të ndërmjetësimit në valutë.

Grafik 3. Ecuria e ndërmjetësimit në lekë dhe në valutë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 3. KOSTOT E NDËRMJETËSIMIT

Thellimi i ndërmjetësimit në monedhën vendase në tremujorin e katërt është përkrahur edhe nga reduktimi i kostos së aktivitetit ndërmjetësues. Kështu në fund të muajit nëntor, kostoja mesatare e ndërmjetësimit shënoi 5.1 pikë përqindje përkundrejt 6.6 pikësh përqindje në tremujorin e tretë. Krahasuar me mesataren e vitit 2011, mesatarisht marxhi i ndërmjetësimit të aktivitetit në lekë është 0.5 pikë përqindje më i ulët. Rënia e kostos së ndërmjetësimit në tremujorin e katërt ka ardhur si pasojë e rënies më të ndjeshme të normës së interesit të kredisë në lekë (1.52 pikë përqindje), ndërkohë që mesatarja e normave të interesit të depozitave ka mbetur në të njëjtin nivel me tremujorin e tretë. Gjithsesi, ecuria e normave të interesit të kredisë në lekë është ndikuar nga disbursimi i një kredie të madhe me kushte preferenciale për ndërmarrjet publike. Duke mënjanuar këtë efekt, normat e interesit të kredisë në lekë do të ishin lehtësisht më të ulëta se më parë. Ndërkohë, *diferenca* mes normës së interesit të kredisë në lekë dhe *yield*-it të bonove 12-mujore të thesarit është rreth 1 pikë përqindje më e ulët se niveli mesatar prej 4 .1 pikë përqindje i tremujorit të kaluar.

Kostoja e ndërmjetësimit në euro[2] në muajt tetor dhe nëntor ka shënuar rritje kundrejt tremujorit të mëparshëm, duke rezultuar mesatarisht 5.1 pikë përqindje, krahasuar me 4.2 pikë përqindje tremujorin e tretë. Kjo ecuri është diktuar si nga rritje e lehtë e normave të interesit të kredisë në euro ashtu edhe nga rënia e normave të interesit të depozitave në euro, si pasojë e përfundimit të ofertave promocionale të tremujorit të tretë. Zhvillimet në tremujorin e katërt duket të kenë rikthyer marxhin e ndërmjetësimit pranë mesatares së vitit 2012, duke përjashtuar rënien e përkohshme që shfaqi në tremujorin e tretë. Marxhi i ndërmjetësimit në muajin nëntor është në nivele të njëjta me fundin e vitit 2011.

[2] *Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.*

Grafik 4. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në lekë*.




*Marzhi llogaritet si diferencë mes normave të interesit të kredisë dhe atyre të depozitave. Spread-i llogaritet si diferencë mes normës së interesit të kredisë/depozitave dhe asaj referencë.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Diferenciali i normës mesatare të interesit të kredisë me normën referencë të tregjeve ndërkombëtare, *euribor* dymbëdhjetëmujor, duke përjashtuar tkurrjen e përkohshme të dy muajve të verës, ka ndjekur trendin rritës të vënë re që nga fundi i vitit të kaluar. Ky tregues është ndikuar më së shumti nga zvogëlimi i normës së interesit në tregun ndërkombëtar. Kjo ecuri nga ana tjetër vijon të tregojë për divergjencën e normave të interesit të depozitave në euro në vend ndaj interesit të tregjeve ndërkombëtare, në reflektim të primeve të rritura të rrezikut të kërkuar nga bankat për ndërmjetësimin në valutë.

Grafik 5. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në euro.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 4. ECURIA E ELEMENTEVE JO-KOSTO NË NDËRMJETËSIM

Në tremujorin e katërt të vitit 2012, kushtet e kreditimit për bizneset kanë vijuar të shtrëngohen, ndërkohë që ato për individë kanë mbetur të pandryshuara. Pjesa më e madhe e elementeve jo-kosto të këtyre kushteve vazhdojnë të veprojnë në kahun shtrëngues.

Grafik 6. Ecuria e kushteve të kreditimit për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas)*.




*Balanca neto e përgjigjeve në këtë vrojtim.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kushtet e kreditimit për bizneset janë shtrënguar më tej në tremujorin e katërt të vitit 2012, thuajse në të njëjtën masë sa edhe në tre tremujorët e mëparshëm. Me përjashtim të kushtit për madhësinë e kredisë, i cili është lehtësuar në këtë tremujor, kërkesat për kolateral janë forcuar dhe maturiteti maksimal i kredisë është ulur, duke ndikuar në shtrëngimin e kushteve të përgjithshme të kreditimit të bizneseve në këtë tremujor.

Kushtet e financimit për individët mbetën të pandryshuara në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, për të tretin tremujor radhazi. Veprimi në kahun lehtësues i elementeve kosto të kreditimit për individë ka balancuar efektin shtrëngues të madhësisë së kredisë dhe të kërkesave për kolateral. Kushtet për maturitetin maksimal të kredisë[3] dhe ato për raportin kërkesë/të ardhura kanë mbetur të pandryshuara për 2 tremujorët e fundit.

## 5. ZHVILLIMET NË DEPOZITA

Raporti i stokut total të depozitave ndaj parasë së gjerë, ka mbetur thuajse i pandryshuar kundrejt një tremujori më parë, duke shënuar vlerën prej 83.3% në fund të muajit nëntor. Ky raport rezulton rreth 1.6 pikë përqindje më lart se në fund të vitit 2011, duke shënuar ndër vlerat më të larta historike të tij. Zhvillimet pozitive në depozita gjatë vitit janë mbështetur gjerësisht nga prirja e individëve e orientuar më shumë drejt kursimit. Njëkohësisht, prurjet e larta

[3] *Kushtet për maturitetin maksimal të kredisë për individë kanë mbetur të pandryshuara në dy vitet e fundit.*

valutore me origjinë nga sektori i jashtëm, të përqendruara kryesisht gjatë muajve të verës, kanë ndikuar edhe në rritjen e raportit të depozitave ndaj PBB-së krahasuar me fundin e vitit 2011.

Në periudhën tetor-nëntor vërehet një zgjerim më i përmbajtur i depozitave krahasuar me tremujorin e tretë të vitit. Stoku total i depozitave gjatë kësaj periudhe shënoi një rritje me 7.3% në terma mesatarë vjetorë, kundrejt 9.7% që rezultoi në tremujorin paraardhës. Megjithatë, stoku total i tyre mbetet thuajse i njëjtë krahasuar me fundin e muajit shtator.

Grafik 7. Ecuria e depozitave sipas monedhës.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zgjerimi i depozitave në tremujorin e fundit ka marrë kryesisht formën e depozitave në lekë, të cilat janë rritur me rreth 4.7% në terma vjetorë kundrejt mesatares prej 6.8% në tremujorin e tretë të vitit. Në terma absolutë, stoku i depozitave në monedhë vendase rezulton rreth 5 miliardë lekë më i lartë se fundi i muajit shtator. Rritja e depozitave në lekë është mbështetur kryesisht nga depozitat e individëve dhe në një masë më të ulët nga depozitat e bizneseve.

Ndërkohë, depozitat në valutë kanë ngadalësuar ritmin vjetor të rritjes në mesatarisht 10%, ose rreth 2.8 pikë përqindje më e ulët krahasuar me normën e tremujorit të tretë. Ecuria mujore e depozitave konfirmon për një ngadalësim dhe më pas tkurrje të depozitave në valutë në muajin nëntor. Ky kontribut negativ i komponentit valutor të stokut të depozitave ka ardhur kryesisht nga depozitat e bizneseve. Zhvillimet e depozitave në valutë të bizneseve luhaten sipas aktivitetit ekonomik dhe kanë mbështetur rritjen e importeve në sektorë të caktuar të ekonomisë.

Struktura kohore e depozitave vëren një kontribut më të lartë të depozitave me afat në zgjerimin e stokut total, veçanërisht për monedhën vendase. Totali i depozitave me afat në periudhën shtator-tetor ka shënuar një rritje me mbi 1 miliardë lekë, kundrejt rënies së depozitave pa afat. Zgjerimi i depozitave me afat ka marrë kryesisht trajtën e depozitave me afat të individëve dhe bizneseve në monedhë vendase.

## 6. ZHVILLIMET NË KREDI

Aktiviteti kreditues në tremujorin e katërt konfirmoi ngadalësimin e ndjeshëm të ritmeve të rritjes së kredisë, të ndikuar nga ecuria e kredisë për sektorin privat. Mbas një rënieje në muajin tetor, portofoli i kredisë së bankave u rrit lehtësisht në muajin nëntor. Në fund të muajit nëntor, rritja vjetore e portofolit të kredisë shënoi 4.0%, përkundrejt 5.6% që shënonte në shtator dhe 10.4% në vitin 2011. Ngadalësimi i vazhdueshëm i ritmeve të rritjes së portofolit të kredisë ka reflektuar si rënien e kredive të disbursuar krahasuar me një vit më parë dhe shlyerjet e parakohshme të kredive, ashtu edhe proceset e fshirjes së kredive të këqija nga bilancet e bankave. Këto fenomene kanë reflektuar njëkohësisht kërkesën e dobët të sektorit privat për të financuar aktivitetin e plogësht ekonomik dhe politikat më të kujdesshme të bankave drejt ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Në kushtet e rritjes së raportit të kredive me probleme ndaj totalit, bankat kanë vijuar të mbajnë standarde të shtrënguara në kreditim. Në të njëjtën kohë, pasiguria për të ardhmen i ka bërë si klientët e bankave ashtu edhe vetë bankat më të kujdesshme për aktivitetin kreditues.

Në tremujorin e katërt një ndikim pozitiv në ecurinë e portofolit të kredisë ka patur kredia për ndërmarrjet shtetërore të cilat kanë rritur ndjeshëm portofolin e kredisë. Viti 2012 është karakterizuar nga dominimi i kreditimit në lekë dhe ndërmarrjet shtetërore kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm. Impulsi i kredisë së ndërmarrjeve shtetërore ndaj PBB-së për vitin 2012 vlerësohet 0.7% përkundrejt 0.9% që ka dhënë sektori privat.

Grafik 8. Karakteristikat e zhvillimeve në aktivitetin kreditues*.




*Impulsi i kredisë për sektorin privat në PBB është matur si raport i flukseve neto vjetore të kredisë ndaj PBB-së. Ky tregues vlerësohet se është sinjalizues për kontributin që kredia jep në rritjen ekonomike. Shkurtimi NSh i referohet ndërmarrjeve shtetërore.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kreditimi në lekë gjatë tremujorit të katërt i është rikthyer tendencës pozitive të normave vjetore të rritjes. Në dy muajt tetor-nëntor, portofoli i kredisë në lekë është rritur me 10 miliardë lekë duke shënuar edhe rritjen më të lartë tremujore për vitin 2012. Në terma vjetorë ky portofol është rreth 18.1% më i lartë, krahasuar me 15.8% që shënonte në tremujorin e tretë. Kjo ecuri pozitive është mbështetur nga rritja e kreditimit për qëllime likuiditeti, e ndikuar kryesisht nga kredia dhënë ndërmarrjeve shtetërore. Një pjesë e kësaj kredie ka

shërbyer edhe për të shlyer një pjesë të kredisë në valutë. Ndërkohë, kontributi i kredisë për qëllime investimi në lekë ndaj totalit në lekë, mesatarisht prej 6.8 pikë përqindje, është ulur më tej për periudhën tetor-nëntor.

Grafik 9. Kreditimi në lekë sipas agjentëve ekonomikë dhe qëllimit të përdorimit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia në valutë që nga tremujori i parë i vitit ka filluar të ngadalësohet me ritme të shpejta. Në fund të muajit nëntor, kjo kredi është 3.2% më e ulët se një vit më parë dhe në dy muajt e fundit norma e tkurrjes është zgjeruar. Në këtë ngadalësim kontributin kryesor e ka dhënë rënia e shpejtë e kredisë për qëllime likuiditeti në valutë si dhe mungesa e kredisë për qëllime investimi si për bizneset ashtu edhe për individët. Sikurse tregojnë edhe vrojtimet e aktivitetit kreditues, në tërësi kërkesa e agjentëve ekonomikë për këtë lloj kredie ka rënë ndjeshëm, e ndikuar nga situata makroekonomike në vend, tregu i pasurive të paluajtshme edhe pasiguritë për të ardhmen. Në të njëjtën kohë, edhe bankat janë më të kujdesshme në përzgjedhjen e projekteve të investimit që ato financojnë.

Grafik 10. Kreditimi në valutë sipas agjentëve ekonomik dhe qëllimit të përdorimit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

# INFORMACION MBI TREGUES EKONOMIKË E MONETARË TË DISA VENDEVE TË EVROPËS QENDRORE-LINDORE DHE JUGLINDORE, T4 - 2012

DORIANA LAMA, MEDVIN SHEHU
DEPARTAMENTI I POLITIKES MONETARE, JANAR 2013

## HYRJE

Ekonomia botërore vazhdon rritjen me ritme të moderuara dhe ripërtëritja ka qenë e ngadaltë dhe e rrethuar nga faktorë pasigurie. Rezultatet e vrojtimeve si dhe tregues paraprakë për muajt e fundit kanë shfaqur disa shenja stabilizimi duke sinjalizuar një përmirësim të lehtë në tremujorin e katërt. Problemet e lidhura me krizën e borxhit të lartë publik të shumë vendeve të zhvilluara në Eurozonë kanë vijuar të jenë të pranishëm në panoramën ekonomike e financiare botërore, duke kushtëzuar ecurinë e ripërtëritjes së aktivitetit ekonomik. Zhvillimet e fundit pozitive në arritjen e një zgjidhje të qëndrueshme dhe të gjithëpranuar mbi mekanizmat e duhur në përballimin e problemeve të lidhura me borxhin publik kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së besimit në treg dhe rritjen e aktivitetit financiar nga ana e agjentëve. Vendimet e fundit të BQE dhe qëndrimi i guvernatorit të saj në takimet e kryera me institucionet e tjera qendrore monetare kanë ndikuar pozitivisht në uljen e pasigurisë tek agjentët financiare dhe biznesit. Tregjet financiare kanë reflektuar këto zhvillime ku ecuria e *yield*-eve dhe primet e rrezikut të kërkuara kanë qenë dukshëm në kahun rënës. Gjithsesi, ngërçi i tejzgjatur në shumë segmente të tregut të kapitaleve ka kushtëzuar qarkullimin e kapitaleve të nevojshme për mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik ka qenë i pranishëm tek shumë ekonomi të zhvilluara dhe ka prekur shumë nga shtetet e Eurozonës të cilat kanë regjistruar norma negative rritjeje. Vendet e EQL[1] kanë paraqitur një panoramë ekonomike të karakterizuar nga një rënie ekonomike dhe në rastin më të mirë ngadalësim të saj (Poloni). Faktor i përbashkët tek këto shtete ka qenë tkurrja e përgjithshme e konsumit të brendshëm dhe në disa prej tyre dhe e investimeve. Zëri tjetër i rëndësishëm ka qenë dobësimi i kërkesës së jashtme e cila është kushtëzuar nga gjendja e brishtë e ekonomisë botërore në përgjithësi dhe asaj në Eurozonë në veçanti. Pesha e madhe që kjo zonë zë tek eksportet respektive të këtyre shteteve e ka bërë edhe më të fortë ndikimin tek performanca ekonomike. Nevoja e ndjekjes së politikave konsoliduese të bilancit nga qeveritë respektive ka ngushtuar hapësirat e stimulit fiskal duke e bërë kështu më të vështirë ripërtëritjen. Në pjesën e fundit të vitit 2012, vërehet se vlerësimi i agjencive për këto shtete nuk është përkeqësuar dhe në disa raste ka pasur përmirësim, por gjithsesi ky zhvillim nuk është përkthyer akoma në flukse investimi të konsiderueshme drejt këtyre ekonomive. Perceptimi i përgjithshëm i rrezikut nga ana e agjentëve kryesorë të tregut ndaj këtij rajoni po faktorizon gjendjen aktuale të Eurozonës, dobësinë e kërkesës së brendshme dhe situatën e përgjithshme në tregjet botërore. Dinamika inflacioniste ka qenë e përmbajtur në Eurozonë, në vendet e EQL dhe në pjesën më të madhe të

[1] *Evropa Qendrore dhe Lindore.*

shteteve të zhvilluara. Inflacioni ka regjistruar rënie muaj pas muaji, duke reflektuar presionin e dobët që vjen nga kërkesa e brendshme si dhe ecurinë rënëse të çmimit të produkteve energjetike dhe lëndëve të para në botë.

## 1. DISA TREGUES TË EKONOMISË DHE ORIENTIMI I POLITIKËS MONETARE NË EKONOMITË E ZHVILLUARA

### EUROZONË

Ekonomia e Eurozonës në tremujorin e tretë të këtij viti ka vijuar tkurrjen. Rritja ekonomike e saj ka qenë -0.1% nga tremujori i kaluar dhe -0.6% në terma vjetorë. Treguesit paraprakë direkt dhe të tërthortë për tre muajt e fundit nuk janë inkurajues dhe sugjerojnë për një vijim të performancës negative. Panorama e zhvillimeve ekonomike gjatë këtij tremujori nuk ka ndryshuar duke u karakterizuar nga tkurrja e konsumit të brendshëm, investimeve dhe dobësi e përgjithshme e sektorëve prodhues. Eksportet neto në këtë tremujor kanë zvogëluar kontributin e tyre tek PBB-ja, duke shtuar peshën e zërave negativë në formimin e saj. Papunësia ka vijuar të rritet, duke i shtuar pikëpyetjet mbi pritjen e një ripërtëritje të shpejtë e të afërt të konsumit të brendshëm. BQE është fokusuar kryesisht në mirëfunksionimin e tregut financiar dhe kapërcimin e ngërçeve të krijuara në segmente të caktuara të tij. Në këtë drejtim kanë ndihmuar edhe deklaratat e guvernatorit Mario Draghi dhe krijimi dhe funksionimi i mekanizmave automatikë për përballimin e vështirësive të lidhura me borxhin publik. Efektet e këtyre lëvizjeve kanë qenë pozitive, duke i rikthyer klimës së tregut dhe biznesit sinjale optimizmi dhe sigurie. Në këtë kontekst titujt e borxhit të shteteve të Eurozonës kanë përfituar dhe janë karakterizuar nga ulje të *spread*-eve në veçanti dhe primeve të rrezikut të kërkuara në përgjithësi. Gjallërimi i këtij aktiviteti shikohet me optimizëm nga analistët e BQE, duke u konsideruar si një pararendës i rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik. Presionet inflacioniste kanë qenë të përmbajtura këto muaj duke reflektuar ecurinë rënëse të çmimeve të energjisë dhe produkteve të lidhura me të.

*Tabelë 1. Normat bazë të interesit në ekonomitë e zhvilluara.*

| | Euro zona (BQE) | ShBA (FED) | MB | Japoni |
|---|---|---|---|---|
| Objektivi i inflacionit | < 2% | n.a. | 2% | 1%[1] |
| Ndryshimet e normës bazë të interesit | 08.11.12 (0.00)<br>06.12.12 (0.00)<br>10.01.13 (0.00) | 13.09.12 (0.00)<br>24.10.12(0,00)<br>11.12.12 (0,00) | 07.11.12 (0,00)<br>05.12.12 (0,00)<br>09.01.13 (0,00) | 19.11.12 (0.00)<br>19.12.12 (0,00)<br>21.01.13 (0,00) |
| Norma aktuale e interesit | 0.75% | 0-0.25 % | 0.50% | 0-0.1 % |
| Inflacioni i fundit[2] | 2.2% | 1.7% | 2.7% | 0.4%[3] |
| Mbledhjet e ardhshme të KMPM-së | 07 shkurt<br>07 mars<br>04 prill | 29-30 janar<br>19-20 mars<br>30 prill | 06-07 shkurt<br>06-07 mars<br>03-04 prill | 13-14 shkurt<br>06-07 mars<br>03-04 mars |
| Ngjarje të ardhshme | 14 shkurt<br>14 mars<br>Buletini mujor | 06 mars<br>17 prill<br>Beige book | 13 shkurt<br>15 maj<br>Raporti Inflacionit | 15 shkurt<br>08 mars<br>Raporti mujor |

[1] *Banka e Japonisë nuk ka adoptuar inflacionin e shënjestruar dhe niveli i kuptuar si stabilitet çmimesh nga kjo bankë është intervali 0-2% ose me saktë pika e mesit 1.00%.*
[2] *Dhjetor 2012.*
[3] *Nëntor 2012.*
*Burimi: Bankat qendrore përkatëse.*

Mbas ndryshimit të fundit, në fillim të muajit korrik BQE-ja nuk e ka ndryshuar normën e saj bazë duke e mbajtur atë në 0.75% (niveli më i ulët historik) si edhe e ka çuar në zero normën e remunerimit për depozitat njëditore. Gjatë kësaj periudhe, BQE-ja ka ndjekur një politikë lehtësuese, duke vazhduar përdorimin e instrumenteve jotradicionale të politikës monetare. Krahas përmirësimit të kërkesave rregullatore të shumë treguesve të likuiditetit ndaj bankave, është për t'u theksuar edhe lehtësimi i kushteve mbi likuiditetin dhe kapitalin e nevojshëm të parashikuara nga akordi Basel 3, që u vendos të hyjnë në fuqi gradualisht nga viti 2015 deri në vitin 2019. Së fundi, BQE-ja njoftoi se do të vijojë kryerjen e operacioneve kryesore të injektimit të likuiditetit në sistem me normë fikse dhe shumë të hapur deri në muajin korrik 2013.

### SHBA

Ekonomia amerikane ka rifituar forcë në tremujorin e tretë, duke regjistruar një rritje më të fortë se tremujori paraardhës. Aktiviteti ekonomik është zgjeruar si në terma tremujorë (0.7%) ashtu edhe vjetorë (+2.6%). Në vlerësimin e fundit të kryer nga zyra qendrore e statistikave evidentohet se gjallërimi i aktivitetit ekonomik është ndikuar pozitivisht nga rritja e konsumit dhe e shpenzimeve private si dhe nga zgjerimi i eksporteve neto. Të dhënat paraprake direkte dhe indirekte për tremujorin e fundit flasin më shumë për ruajtjen e ritmit të rritjes në të njëjtat nivele me tremujorin e kaluar. Libri bezhë[2], i publikuar disa ditë më parë, e paraqet ekonominë e ShBA-së në vlera pozitive dhe në rastin më pesimist, aktiviteti ekonomik llogaritet të ketë ruajtur vlerat e tremujorit të tretë. Banka qendrore amerikane (FED), e ka gjykuar të nevojshme zgjatjen e operacioneve të saj jo konvencionale, me qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për gjallërimin e ekonomisë. Në këtë drejtim, ajo ka komunikuar vazhdimin e operacioneve të lehtësimit sasior (QE) pa afat në kohë dhe pa limit me shumë 45 miliardë dollarë në muaj, si dhe të blerjeve të titujve të garantuara nga asete me vlerën 40 miliardë dollarë në muaj. Gjithashtu, FED nuk e ka ndryshuar normën e saj bazë gjatë kësaj dhe ka parashikuar që ajo të jetë në këto nivele për aq kohë sa norma e papunësisë do qëndrojë mbi 6.5% dhe parashikimet për inflacionin në harkun kohor 1-2 vjet të jenë nën 2.5%. Inflacioni ka qenë në rënie gjatë këtyre muajve i ndikuar kryesisht nga çmimet e ushqimeve dhe produkteve të sektorit të energjisë.

## 2. AKTIVITETI EKONOMIK, INFLACIONI DHE ORIENTIMI I POLITIKËS MONETARE NË DISA VENDE TË EQL[3]

Vendet e EQL të vrojtuara në këtë raport, gjatë tre tremujorëve të këtij viti kanë shfaqur ngadalësim të ritmeve të rritjes dhe zbehje të aktivitetit ekonomik. Emëruesi i përbashkët tek këto shtete ka qenë dobësimi i vazhdueshëm i konsumit, e si rrjedhojë, tkurrja e kërkesës së brendshme. Nevoja për ruajtjen dhe ndjekjen e politikave konsoliduese fiskale ka zvogëluar edhe hapësirat e ndërhyrjeve me karakter stimulues nga ana e qeverive, duke qenë kështu një

[2] *Beige Book, janar 2013.*
[3] *Ky rajon përfshin Republikën Çeke, Hungarinë dhe Poloninë.*

zë negativ në ecurinë e PBB-së. Ripërtëritja e ritmit të rritjes duket se do jetë e ngadaltë dhe e zhvendosur në pjesën e dytë të vitit 2013. Polonia ka qenë shteti i vetëm që ka regjistruar rritje pozitive, por këmbanat e alarmit kanë rënë edhe atje, pasi ritmi i rritjes është dobësuar më tej këtë tremujor duke sinjalizuar një gjendje joinkurajuese të ekonomisë. Shtetet e tjera ndërkohë vijuan të shfaqin rënie ekonomike si krahasuar me vitin e kaluar ashtu edhe me tremujorin paraardhës.

Gjendja e brishtë ekonomike e vendeve kryesore të zhvilluara që përbëjnë pjesën kryesore të tregut të eksporteve të këtyre shteteve ka kushtëzuar ecurinë e kërkesës së jashtme. Dobësimi i këtij zëri që përbën mbështetësin primar në PBB-në e të këtyre shteteve ka përshpejtuar dhe thelluar ngadalësimin e rritjes ekonomike. Ndjekja e politikave rigoroze për konsolidimin e ekuilibrave fiskalë ka shtuar edhe më shumë presionet frenuese tek rritja e PBB-së. Në mungesë të forcimit të kërkesës së brendshme, parashikimet e rritjes ekonomike për vitin 2012 janë rishikuar për poshtë. Prirja rritëse e inflacionit e parë në pjesën e parë të 2012, ka qenë e shkaktuar kryesisht nga faktorë të përkohshëm si rritja e TVSH-së dhe e një numri akcizash, ndërkohë që normat e inflacionit në gjysmën e dytë të vitit 2012, janë shfaqur përgjithësisht rënëse dhe presionet gjykohen të përmbajtura. Në mungesë të rrezikut të inflacionit dhe në prani të një shtrëngimi ekonomik të vazhdueshëm, bankat qendrore të këtij rajoni kanë kryer ulje të njëpasnjëshme të normave bazë me qëllim lehtësimin e kushteve monetare dhe nxitjen e kreditimit të ekonomisë.

## 2.1 Aktiviteti ekonomik

| Klasifikimi ÇEKI | | |
|---|---|---|
| A1 (stabël)<br>(Moody's) | AA- (stabël)<br>(S&P) | A+ (pozitive)<br>(Fitch) |

Rritja e PBB-së (v/v) për tremujorin e tretë të vitit 2012 në Republikën Çeke rezultoi -1.3 % nga -1.0% një tremujor më parë. Panorama e zhvillimeve ka qenë e njëjtë me tremujorin e kaluar, ku vijimi i rënies së konsumit privat ka qenë faktori kryesor që ka ndikuar në rezultatin negativ. Edhe zërat e tjerë që kontribuojnë në PBB kanë paraqitur rënie ku prodhimi i industrisë, specifikisht në sektorët e mallrave, minierave dhe energjisë ka vuajtur efektin e dyfishtë të rënies së kërkesës së brendshme si dhe moderimin e asaj të jashtme. Reduktimi i kërkesës së brendshme është reflektuar dukshëm veçanërisht tek shpenzimet e individëve, kategori kjo që ka regjistruar tkurrje prej një viti. Performanca e eksporteve neto në këtë tremujor, ndonëse e mirë, nuk arriti të kompensonte kontributin negativ të këtyre zërave në formimin e PBB-së. Të dhënat për muajt e fundit si prodhimi industrial, shitjet me pakicë dhe ndërtimi sugjerojnë për vijim të dobësisë së ekonomisë çeke edhe në tremujorin e fundit.

| Klasifikimi HUNGARI | | |
|---|---|---|
| Ba1 (negativ)<br>(Moody's) | BB+ (negativ)<br>(S&P) | BB+ (negativ)<br>(Fitch) |

Ekonomia në Hungari vijoi të tkurret edhe në tremujorin e tretë ku shifra -1.5% (v/v) ishte edhe më e lartë se tremujori i kaluar. Në terma tremujorë, ngadalësimi ishte i njëjtë me atë të periudhës paraardhëse (-0.2%). Mënjanë vijimit të dobësisë së konsumit, faktor tjetër kryesor në tkurrjen e ekonomisë ka qenë performanca e prodhimit bujqësor si dhe ecuria negative e shumë degëve të industrisë. Vlera pozitive kanë shënuar vetëm disa degë të veçanta të sektorëve prodhues, kryesisht ato për mjetet e transportit dhe të komunikimit. Eksportet neto gjithashtu kanë shënuar ngadalësim dhe ndikimi i tyre ka qenë negativ. Të dhënat paraprake të muajve tetor dhe nëntor si prodhimi industrial, konsumi i individëve dhe shitjet me pakicë sugjerojnë për vijim të dobësisë edhe në tremujorin e fundit të këtij viti. Në analizat e ekspertëve të BQH rritja ekonomike pritet të forcohet nga fundi i vitit 2013, duke e lidhur kryesisht me ripërtëritjen e kërkesës së jashtme dhe hapësirat më të zgjeruara që qeveria do të ketë vitin tjetër për të stimuluar kërkesën e brendshme. Presionet në inflacion janë në kahun rënës edhe për shkak të peshës që kërkesa e dobët e brendshme ushtron në ecurinë e çmimeve. Banka Qendrore e Hungarisë në këto tre muajt e fundit ka ulur normën bazë me qëllim krijimin e kushteve më të përshtatshme për nxitjen e aktivitetit kreditues në vend.

| Klasifikimi POLONI | | |
|---|---|---|
| A2 (negativ) (Moody's) | A- (stabël) (S&P) | A- (stabël) (Ftich) |

Të dhënat ekonomike për Poloninë për tremujorin e tretë konfirmuan ecurinë rënëse të vërejtur gjatë këtij viti. Megjithëse me vlera pozitive (1.9%) shifra vjetore për rritjen e PBB-së rezultoi në rënie nga një tremujor më parë (2.55%), ndërkohë që rritja ekonomike në terma tremujor rezultoi afër 0.4%. Dobësimi i rritjes ekonomike ka ardhur si rrjedhojë e vijimit të uljes së konsumit privat, dhe për herë të parë nga viti 2010 edhe fluksi i investimeve ka shënuar tkurrje. Treguesit e rritjes së kredisë për ekonominë konfirmojnë momentin jopozitiv të ecurisë ekonomike gjatë këtij viti. Performanca e eksporteve neto ka kontribuar pozitivisht në formimin e PBB-së. Eksportet e Polonisë janë të orientuara kryesisht drejt Gjermanisë dhe pjesëve të tregut të jashtëm që vijojnë të performojnë pozitivisht edhe në këtë moment krize. Gjithsesi, në kushtet e dobësimit të theksuar të konsumit brenda vendit dhe perspektivës jo optimiste për aktivitetin ekonomik, edhe Banka Qendrore e Polonisë është përpjekur të lehtësojë kushtet monetare, duke e ulur normën e saj bazë tre herë në këto muajt e fundit. Ashtu si edhe në rastin e Hungarisë, presionet e brendshme dhe ato me origjinë nga jashtë në inflacion kanë qenë dhe parashikohen të jenë të përmbajtura, duke lejuar bankën qendrore të fokusohet më shumë drejt nxitjes së aktivitetit kreditues.

## 2.2 Inflacioni dhe politika monetare

Inflacioni në Çeki ka ndjekur ecuri rënëse gjatë tremujorit të fundit. Vlera e tij vjetore ishte 2.4% në muajin dhjetor nga 2.7% një muaj më parë dhe inflacioni i përshtatshëm[4] i përdorur nga politika monetare e bankës qendrore

[4] *'Relevant monetary policy inflation'*

iu afrua kufirit të poshtëm të intervalit rreth objektivit të shënjestruar[5]. Ecuria e dobët e ekonomisë dhe zbehja e konsumit kanë përcjellë presione të forta rënëse në ecurinë e inflacionit gjatë kësaj periudhe. Mbas shuarjes së efekteve të krijuara nga ngjarje të përkohshme si përcjellja e ndryshimit të TVSH-së dhe e disa çmimeve të administruara tek shumë grupe mallrash, ecuria e inflacionit ka qenë rënëse. Tregu i punës (rritja e papunësisë), situata e brendshme e konsumit dhe ecuria e qëndrueshme e kursit të këmbimit kanë qenë disa nga faktorët me efekt anti-inflacionist. Gjatë kësaj periudhe, banka qendrore ka ulur normën bazë dy herë me 45 pikë bazë. Me normën bazë në nivelin 0.05% ekspertët e bankës qendrore mendojnë se një mënyrë tjetër për lehtësim monetar mund të jetë ndërhyrja tek kursi i këmbimit.

Grafik 1. Norma e inflacionit dhe objektivi për inflacionin, Çeki.




Burimi: Banka Qendrore e Çekisë.

Në Hungari, norma e inflacionit shënoi 5.2% në muajin dhjetor nga 6.0% në muajin nëntor. Gjatë këtij viti ajo ka qëndruar mbi objektivin prej 3% të bankës qendrore. Ecuria e inflacionit është influencuar kryesisht nga efekti i rritjes së shumë taksave jo-direkte dhe akcizave. Presionet inflacioniste kanë ardhur kryesisht si rezultat i faktorëve të përkohshëm dhe përcjelljes së rritjes së çmimeve të mallrave ushqimore në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që pjesa e lidhur me presionet e kërkesës së brendshme në inflacion ka ndjekur ecuri rënëse. Banka Qendrore e Hungarisë e ka ndryshuar tre herë normën bazë të interesit gjatë kësaj periudhe, duke e zbritur atë në nivelin 5.75% në dhjetor nga 6.50% në shtator. Presionet inflacioniste që vijnë nga faktorët e përkohshëm të vërejtura gjatë vitit duket ta kenë konsumuar efektin e tyre dhe prirja rënëse me burim nga kërkesa e brendshme paraqitet më e fortë. Në parashikimet e bankës qendrore për periudhën e afërt gjykohet se inflacioni do të ndjekë një trajektore rënëse dhe presionet do jenë të balancuara kryesisht në afatin e mesëm. Gjithsesi niveli i pasigurisë në parashikimin e ecurisë së inflacionit është i konsiderueshëm përsa i takon horizontit të veprimit të politikës monetare. Kjo ndodh pasi nuk është akoma i qartë ndikimi i presioneve rritëse që mund të vijë nga rritja e çmimeve të administruara dhe shkalla e përcjelljes së tyre tek çmimet e prodhimit, si dhe sasia e kompensimit që mund të vijë nga ana e kërkesës së dobët vendase.

Grafik 2. Norma e inflacionit dhe objektivi për inflacionin, Hungari.




Burimi: Banka Qendrore e Hungarisë.

Norma vjetore e inflacionit në Poloni ka shfaqur ecuri rënëse në gjysmën e dytë të këtij viti. Në muajin dhjetor ai shënoi 2.4% duke qenë poshtë objektivit

[5] *Objektivi i inflacionit është 2% me interval +/- 1.*

Grafik 3. Norma e inflacionit dhe objektivi për inflacionin, Poloni.




Burimi: Banka Qendrore e Polonisë.

të shënjestruar (2.5%). Duke filluar që prej muajit korrik 2012 inflacioni ka regjistruar ulje, duke qëndruar poshtë kufirit të sipërm të intervalit të objektivit. Banka Qendrore e Polonisë në tre muajt e fundit e ka ulur normën bazë tre herë duke e çuar atë në 4.00%. Ekspertët e kësaj banke kanë shprehur shqetësimin se norma e inflacionit do të drejtohet në nivele poshtë objektivit të shënjestruar në periudhat e ardhshme në një kohë që dhe të dhënat që vijnë nga ekonomia reale nuk janë inkurajuese. Vijimi i rënies së inflacionit bazë si dhe i çmimeve të prodhimit konfirmon presionet e forta joinflacioniste që vijnë nga kërkesa e brendshme, në kushtet kur efektet e rritjes së disa çmimeve të administruara, TVSH-së dhe disa akcizave janë shuar në pjesën e parë të vitit. Performanca e treguesve ekonomikë të brendshëm, ajo e ekonomisë botërore dhe ecuria e dobët e tregut të punës janë reflektuar tek parashikimet e ekspertëve për inflacionin që llogaritet të jetë afër objektivit në gjysmën e parë të vitit 2013.

## 3. AKTIVITETI EKONOMIK, INFLACIONI DHE ORIENTIMI I POLITIKËS MONETARE NË DISA VENDE TË EVROPËS JUGLINDORE[6]

Grafik 4. Rritja vjetore e PBB-së reale.




Burimi: Bankat qendrore dhe agjencitë statistikore përkatëse.

Pas një përmirësimi modest në tremujorin e dytë, vendet e Evropës Juglindore kanë treguar rënie të aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë. Serbia ka vijuar të mbetet në territor negativ (PBB v/v), duke shënuar një kontraktim më të fortë nga tremujori i kaluar. Pas vlerave pozitive në dy tremujorët e parë të vitit, Rumania ka shënuar tkurrje ekonomike në tremujorin e tretë, ndërsa Bullgaria dhe Maqedonia kanë rezultuar me një rritje pozitive por të ngadaltë.

Lidhjet e forta ekonomike e financiare me vendet e BE, kanë bërë që rajoni të vuajë efektet e problemeve të borxhit të vendeve të zhvilluara evropiane dhe të luhatëshmërisë së tregjeve ndërkombëtare në trajtën e rënies së kërkesës për eksportet e rajonit, rënies së hyrjes së kapitalit të huaj dhe remitancave, si dhe shtrëngimit të kushteve të kredidhënies (*deleveraging*).

Ngadalësimi ekonomik është mbështetur nga një kërkesë e brendshme e dobët, shoqëruar me rënie të pagave reale dhe rritje të papunësisë, si dhe nga ritmet më të ulëta të investimeve. Kreditimi i ekonomisë ka rënë ndjeshëm në të gjitha vendet e konsideruara. Kjo prirje reflekton pjesërisht rënien e

[6] *Vendet e përfshira janë: Bullgari, IRJM, Rumani dhe Serbi.*

kërkesës për kredi, dhe pjesërisht shtrëngimin e ofertës për kredi si pasojë e politikave të bankave të mëdha evropiane.

Gjithashtu, shifrat negative të rritjes ekonomike (v/v) për disa vende (Serbi, Rumani) duket të jenë ndikuar dhe nga baza krahasuese, po të kemi parasysh ecurinë tepër të mirë të sektorit bujqësor vitin e kaluar. Në tremujorin e tretë, kushtet e pafavorshme klimaterike kanë dëmtuar prodhimin bujqësor, duke ndikuar negativisht rritjen e PBB-së. Në Rumani, zgjedhjet elektorale të përfunduara në nëntor 2012, duket se kanë shtyrë në kohë kryerjen e reformave strukturore, duke ngadalësuar rritjen.

Norma e inflacionit ka vijuar të rritet edhe në tremujorin e katërt. Në Serbi dhe Rumani, ku aplikohet regjimi i inflacionit të shënjestruar, ky tregues ka kaluar ndjeshëm objektivin kryesor të bankës qendrore duke kapur vlera afër maksimales në fund të vitit. Banka Qendrore e Rumanisë nuk ka ndryshuar qëndrimin e politikës monetare, ndërsa ajo e Serbisë ka ndërmarrë vendime të njëpasnjëshme, duke e rritur normën bazë në total me 0.75 pikë përqindje brenda periudhës gusht-dhjetor.

Në muajin janar 2013, Banka Botërore ka publikuar parashikimet për rritjen ekonomike të vendeve të rajonit në 2012-2013[7], shifra të cilat janë rishikuar për poshtë nga parashikimet e FMN-së në tetor 2012. Parashikimi për vitin në vazhdim (2013), supozon se ambienti i huaj nuk do të ketë zhvillime të papritura negative, ndërkohë që faktorët e brendshëm që kanë kushtëzuar rritjen ekonomike do të vijojnë të jenë të pranishëm.

Grafik 5. Parashikime per rritjen ekonomike te vitit 2012 dhe 2013.




Burimi: Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, raporti nënvizon nevojën për reforma strukturore dhe masa korrektuese vendore për të adresuar problemet me disbalancat e jashtme (deficiti i llogarisë korrente) dhe ato të brendshme (deficiti fiskal, borxhi publik, kushtet e tregut të punës), si dhe përmirësimin e konkurueshmërisë.

[7] *Global Economic Prospects, Banka Botërore, Janar 2013.*

### 3.1 Aktiviteti ekonomik

| Klasifikimi BULLGARI | | |
|---|---|---|
| Baa2 (stabël) (Moody's) | BBB (stabël) (S&P) | BBB- (stabël) (Fitch) |

Ekonomia e Bullgarisë u rrit me ritme të ngadalta në tremujorin e tretë, 0.5% (v/v), normë e njëjtë me atë të tremujorit të kaluar. Kontribues i rëndësishëm i rritjes ekonomike rezultoi konsumi privat, i cili është dhe përbërësi kryesor i PBB-së. Në terma vjetor, ky përbërës u rrit 3.0% nga 3.2% në tremujorin e dytë. Shtytësit kryesorë të konsumit vlerësohen të kenë qenë pagat relativisht të larta në terma real, dhe rritja sezonale e punësimit. Për herë të parë që prej tremujorit të katërt 2008, investimet shënuan normë pozitive rritjeje vjetore, 1.0%, fakt që ka shtuar optimizmin se ky sektor ka hyrë në cikël rritës. Investimet janë mbështetur ndjeshëm nga ritmi më i mirë i tërheqjes së fondeve të BE-së. Pesha e investimeve në formimin e PBB-së ka rënë nga 37% në 2008 në 23% në 2011, pjesërisht dhe si rezultat i rënies së konsiderueshme të IHD-ve (rreth 7 herë). Eksportet neto kanë dhënë një kontribut negativ, por më të zbutur sesa tremujori i dytë, falë ngadalësimit të importeve.

| Klasifikimi MAQEDONI | | |
|---|---|---|
| - (Moody's) | BB ( stabël) (S&P) | BB+ (stabël) (Fitch) |

Ndryshe nga një tremujor më parë, PBB-ja e Maqedonisë shënoi normë pozitive rritjeje në tremujorin e tretë, 0.2% (v/v). Kjo rritje u mbështet kryesisht nga investimet në sektorin e ndërtimit. Konsumi privat dhe eksportet u vlerësuan në rënie (përkatësisht 2.4% dhe 2.9% më të ulëta se një vit më parë). Konsumi privat duket të jetë ndikuar dhe nga rritja e çmimeve të ushqimeve në tremujorin e tretë, ndërkohë që eksportet kanë vuajtur efektet e krizës së zgjatur në Evropë dhe situatën e vështirë të partnerëve tregtarë. Shifrat për prodhimin industrial në muajin nëntor flasin për rënie të tij, duke paralajmëruar aktivitet të ngadaltë ekonomik edhe në tremujorin e katërt.

| Klasifikimi RUMANI | | |
|---|---|---|
| Baa3 (negativ) (Moody's) | BB+ ( stabël) (S&P) | BBB- (stabël) (Fitch) |

Në Rumani, prodhimi i brendshëm bruto u kontraktua 0.6% (v/v) në tremujorin e tretë, nga një rritje +1.1% një tremujor më parë. Aktiviteti ekonomik u ndikua nga përkeqësimi i ndjeshëm i kërkesës së brendshme si dhe nga rënie e kontributit të kërkesës së huaj. Konsumi privat ra me 1.4% në terma vjetorë, ndërsa ai publik me 1.7%. I pari duket të jetë ndikuar dhe nga rënia reale e pagave dhe rritja e çmimeve të ushqimeve. Nga ana tjetër, ritmi i investimeve, ndonëse pozitiv, u ngadalësua në 9.9% nga 15.5% në tremujorin e dytë. Këto u ndikuan nga rënia e investimeve publike në sektorin e ndërtimit. Nga pikëpamja sektoriale, faktor i rëndësishëm që duket të ketë ndikuar vlerën negative është rënia e prodhimit bujqësor. Ecuria tepër e mirë e këtij sektori vitin e kaluar, nuk u përsërit këtë vit. Përkundrazi, thatësira gjatë muajve të verës ka shkaktuar dhe të korra më të ulëta sesa pritej, duke rezultuar në rënie të prodhimit bujqësor (29.8%) në tremujorin e tretë.

| Klasifikimi SERBI | | |
|---|---|---|
| - (Moody's) | BB- (negativ) (S&P) | BB- (negativ) (Fitch) |

Aktiviteti ekonomik në Serbi u tkurr me 2.5% në terma vjetorë në tremujorin e tretë, nga -0.6% një tremujor më parë. Sektorët që pësuan rritje në këtë periudhë ishin ai financiar, i telekomunikacionit dhe i transportit. Bujqësia vijon të jetë sektori me ecurinë më të dobët, duke shënuar një tkurrje vjetore prej 17.1% në tremujorin e tretë. Kjo vlerë u ndikua si nga kushtet e pafavorshme atmosferike këtë vit, ashtu dhe nga ritmi tepër pozitiv i rritjes së prodhimit bujqësor një vit më parë. Sektori i ndërtimit dhe i energjisë, gjithashtu kontribuuan negativisht në shifrën e PBB-së vjetore.

Të dhënat lidhur me prodhimin industrial deri në nëntor flasin për dobësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik edhe në tremujorin e katërt. Tregues të shitjeve kanë pësuar rënie të ndjeshme vjetorë në tetor-nëntor, duke reflektuar pjesërisht edhe rritjen e taksave indirekte (rritje e TVSH-së nga 18% në 20%). Banka qendrore pret rritje negative të PBB-së në tremujorin e katërt, ndikuar nga kontributi negativ i konsumit privat dhe publik, dhe kontributi i lehtë pozitiv nga eksportet neto dhe investimet. Megjithatë, vështirësitë më të mëdha me të cilat përballet Serbia lidhen me sektorin fiskal. Misioni i FMN-së në muajin nëntor, nuk arriti asnjë dakordësi lidhur me aktivizimin e marrëveshjes *Stand-By* me qeverinë e Serbisë. Misioni shprehu mosbesim ndaj pozicionit fiskal të vendit dhe objektivave të parashikuara, në kushtet kur borxhi publik është rritur ndjeshëm dhe deficiti fiskal vlerësohet i paqëndrueshëm. Sipas Këshillit Fiskal të Serbisë, në fund të vitit 2012 deficiti fiskal do të arrijë 6.7% të PBB-së ndërkohë që borxhi do të afrohet pranë vlerës 60% e PBB-së, ndjeshëm mbi kufirin 45% të rregullit fiskal.

### 3.2 Inflacioni dhe politika monetare

Në Bullgari, niveli i çmimeve vijoi të rritet edhe në tremujorin e katërt, mesatarisht 4.2% nga 4.0% në tremujorin e tretë. Në fund të vitit, inflacioni vjetor shënoi 4.2%, nga 2.8% një vit më parë. Faktorët kryesorë që kanë shtyrë inflacionin në këto nivele janë rritjet e çmimeve të ushqimit dhe të karburantit në tregjet ndërkombëtare. Krahas këtyre, rritja e çmimit të energjisë dhe gazit prej 1 korrikut ka ndikuar dhe pritet të ndikojë formimin e inflacionit.

Pas rënies në nëntor, norma e inflacionit u rrit sërish në 4.8% në muajin dhjetor në Maqedoni. Faktorët kryesorë që kanë çuar në rritjen e çmimeve lidhen me presionet nga çmimet e importit dhe ato të rregulluara. Banka qendrore nuk ka ndryshuar kursin e politikës monetare ndonëse ka tërhequr

Grafik 6. Norma vjetore inflacionit.




Burimi: Bankat qendrore përkatëse.

Grafik 7. Norma e inflacionit dhe objektivi për inflacionin, Rumani.




Burimi: Banka Qendrore e Rumanisë.

vëmendjen se ecuria e ardhshme e inflacionit është e rrethuar nga rreziqe që lidhen me pasiguritë në tregjet ndërkombëtare. Niveli i rezervave valutore vlerësohet i përshtatshëm dhe pozicioni i jashtëm i vendit i qëndrueshëm në periudhën afatmesme.

Në Rumani, inflacioni vjetor ka ndjekur trajektore rritëse, duke shënuar 5.0% në dhjetor nga 3.1% një vit më parë. Kërcimi i inflacionit në dhjetor ishte në linjë me parashikimet e bankës qendrore, të cilat faktorizonin rritje të çmimeve të ushqimeve si pasojë e thatësirës së zgjatur dhe rënies së prodhimit bujqësor. Presionet nga kërkesa vazhdojnë të mbeten të dobëta në praninë e një hendeku negativ të prodhimit. Banka qendrore ka ruajtur të pandryshuar normën bazë të interesit, në 5.25%, në përgjigje të presioneve disinflacioniste të cilat mund të theksohen në kushtet e një ngërçi ekonomik në vend dhe në Eurozonë. Nga ana tjetër, përfundimi i procesit elektoral në nëntor dhe përpjekjet për përmbushjen e parametrave fiskalë kanë përmirësuar besimin e investitorëve, duke ndihmuar në lehtësimin e presioneve mbi kursin e këmbimit. Banka qendrore parashikon se norma e inflacionit do të hyjë brenda intervalit të tolerancës (2%-4%) në gjysmën e dytë të vitit 2013.

Grafik 8. Norma e inflacionit dhe objektivi për inflacionin, Serbi.




Burimi: Banka Qendrore e Serbisë.

Norma e inflacionit në Serbi ka kërcyer në 12.2% (v/v) në fund të vitit 2012 si rezultat i rritjes së çmimeve të produkteve bujqësore dhe çmimeve të administruara, si nga efekti i bazës krahasuese. Në përgjigje të rritjes së inflacionit, me qëllim kontrollin e pritjeve inflacioniste dhe efekteve të mundshme të raundit të dytë, Banka Qendrore e Serbisë ka rritur normën bazë nga 10.50% në gusht, në 11.25% në dhjetor. Inflacioni pritet që të zbresë brenda intervalit të tolerancës vetëm në fund të vitit 2013. Kontributi të rëndësishëm në këtë ecuri pritet të japin edhe masat konsoliduese fiskale. Rreziqet që rrethojnë këtë projeksion lidhen me ecurinë e çmimeve të ushqimit në vend dhe në tregjet botërore, si dhe atyre të administruara në vend.

# ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË TREMUJORI I III-TË 2012

MERITA BOKA, OLTI MITRE
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, JANAR 2013

## 1. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE[1]

Ashtu si dhe në dy vitet e mëparshëm, marrëdhëniet tregtare me jashtë gjatë vitit 2012 ishin nën ndikimin dhe presionet e zhvillimeve makroekonomike ndërkombëtare, veçanërisht atyre në Eurozonë dhe vendet fqinje. Ngadalësimi i rritjes ekonomike në këto vende dhe dobësimi i kërkesës së huaj çuan në moderim të ndjeshëm të normës së rritjes së eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve për tremujorin e tretë të vitit 2012. Kërkesa e brendshme e moderuar dhe shuajtja e efekteve të para të liberalizimit të vizave me vendet e Shengen-it vlerësohet të kenë ndikuar në rënien e importeve të mallrave dhe shërbimeve gjatë kësaj periudhe. Deficiti i eksporteve neto në tremujorin e tretë të vitit 2012 u tkurr me rreth 14.4% në terma vjetorë. Vijimësia e situatës së vështirë të punësimit, veçanërisht ndër emigrantë, në vendet me përqendrimin më të lartë të tyre vlerësohet të ketë ndikuar në rënien progresive të dërgesave të emigrantëve gjatë kësaj periudhe. Si pasojë e lëvizjeve të flukseve valutore në këto llogari, bilanci i llogarisë korrente rezultoi me një deficit prej 198.1 milionë euro, në rënie me rreth 18.8% në terma vjetorë. Prurjet valutore në llogarinë kapitale dhe financiare rezultuan rreth 176.8 milionë euro, në rënie me rreth 22.3% në terma vjetorë. Suficiti i regjistruar në këtë llogari gjatë vitit 2011 arriti të financojë rreth 89.2% të deficitit korrent të regjistruar në këtë periudhë.

*Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave.*

| | T3 2011 | T4 2011 | T1 2012 | T3 2012 | T3 2012 | 9M 2011 | 9M 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Llogaria Korrente (në mil euro) | -244.1 | -352.1 | -253.1 | -219.9 | -198.1 | -769.9 | -671.1 |
| Ndryshim vjetor | 1.8% | -1.2% | 19.4% | -29.9% | -18.8% | 16.3% | -12.8% |
| / PBB-së | -10.2% | -15.2% | -11.8% | -8.6% | -7.7% | 11.1% | 9.2% |
| Bilanci tregtar | -593.1 | -658.6 | -465.3 | -475.5 | -540.5 | -1,583.0 | -1,481.4 |
| Eksporte, f.o.b. | 344.1 | 360.0 | 325.8 | 394.2 | 402.5 | 1,045.5 | 1,122.5 |
| Importe, f.o.b. | -937.2 | -1,018.6 | -791.2 | -869.7 | -943.0 | -2,628.5 | -2,603.9 |
| Bilanci i shërbimeve | 116.7 | 41.2 | 8.5 | 26.2 | 132.6 | 93.4 | 167.3 |
| Kredi | 629.8 | 428.5 | 293.8 | 381.1 | 578.1 | 1,318.9 | 1,253.0 |
| Debi | -513.1 | -387.3 | -285.4 | -354.9 | -445.4 | -1,225.4 | -1,085.7 |
| Shërbime udhëtimi - eksport | 469.4 | 285.1 | 185.1 | 246.4 | 445.3 | 884.3 | 876.8 |
| Shërbime udhëtimi - import | -386.5 | -256.8 | -180.8 | -240.1 | -325.6 | -864.8 | -746.5 |
| Shërbime udhëtimi - neto | 82.9 | 28.4 | 4.3 | 6.2 | 119.7 | 19.5 | 130.2 |
| Bilanci i të ardhurave | 14.1 | 14.5 | -1.9 | -10.2 | 20.8 | 33.1 | 8.7 |
| Kredi | 77.5 | 67.5 | 59.7 | 60.9 | 74.9 | 202.0 | 195.5 |
| Debi | -63.3 | -53.0 | -61.6 | -71.1 | -54.1 | -169.0 | -186.8 |
| Të ardhura nga IHD-neto | -22.0 | -7.9 | -30.2 | -30.1 | -18.7 | -48.2 | -79.0 |
| Transferta korrente | 218.2 | 250.8 | 205.7 | 239.7 | 188.9 | 686.6 | 634.2 |
| Kredi | 245.6 | 279.1 | 242.3 | 279.6 | 227.3 | 771.2 | 749.2 |
| Debi | -27.5 | -28.3 | -36.7 | -39.9 | -38.4 | -84.7 | -115.0 |
| Dërgesa nga emigrantët -neto | 153.8 | 188.7 | 159.5 | 178.6 | 138.9 | 499.2 | 477.0 |

[1] *Të dhënat më të fundit të bilancit të pagesave i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2012.*

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kapitale dhe Financiare (mil euro) | 227.6 | 277.1 | 258.3 | 172.2 | 176.8 | 649.9 | 607.4 |
| Ndryshim vjetor | 29.1% | -32.6% | 12.2% | -10.3% | -22.3% | 40.9% | -6.5% |
| / PBB-së | 9.5% | 11.8% | 12.1% | 6.7% | 7.0% | 7.0% | 8.4% |
| Llogaria kapitale | 6.5 | 27.8 | 12.9 | 43.0 | 9.8 | 57.1 | 65.8 |
| Llogaria financiare | 221.1 | 249.3 | 245.4 | 129.2 | 167.0 | 592.8 | 541.6 |
| A. Detyrime | 413.3 | 390.7 | 307.5 | 268.6 | 375.9 | 860.9 | 951.9 |
| IHD | 160.1 | 289.7 | 201.8 | 178.3 | 171.2 | 457.2 | 551.4 |
| Inv. portofoli | 11.1 | 11.4 | 14.3 | 13.2 | 14.9 | 28.4 | 42.4 |
| Inv. të tjera | 242.1 | 89.6 | 91.3 | 77.1 | 189.8 | 375.3 | 358.2 |
| Huamarrje | 110.2 | 39.2 | 41.5 | 30.8 | 27.2 | 181.4 | 99.5 |
| Monedha dhe depozita | 137.2 | 54.1 | 73.0 | 44.6 | 149.9 | 191.7 | 267.5 |
| B. Mjete | -192.3 | -141.3 | -62.0 | -139.4 | -208.9 | -268.1 | -410.3 |
| IHD | -3.9 | -19.8 | -2.6 | 0.0 | -7.3 | -10.4 | -9.9 |
| Inv. portofoli | -57.1 | 14.4 | -61.0 | 9.9 | -26.4 | -103.1 | -77.5 |
| Inv. të tjera | -131.2 | -135.9 | 1.5 | -149.3 | -175.2 | -154.6 | -322.9 |
| Monedha dhe depozita | -114.8 | -94.3 | -11.0 | -137.6 | -173.8 | -79.9 | -322.4 |
| Hua (per financim tregtie) | -34.5 | -57.0 | 9.7 | 0.6 | -1.7 | -62.6 | 8.6 |
| IHD (neto) | 156.2 | 270.0 | 199.3 | 178.3 | 163.9 | 446.9 | 541.5 |
| Investime portofoli (neto) | -46.0 | 25.7 | -46.6 | 23.1 | -11.5 | -74.7 | -35.1 |
| Investime të tjera (neto) | 110.9 | -46.4 | 92.8 | -72.2 | 14.6 | 220.7 | 35.2 |
| Gabime dhe harresa | 72.9 | 68.8 | -2.0 | 55.2 | 111.0 | 97.6 | 164.1 |
| Mjetet e rezervës | -56.4 | 6.2 | -3.2 | -7.5 | -89.7 | 22.4 | -100.4 |

*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

## 1.1. LLOGARIA KOrRENTE

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 198.1 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2012. Në terma vjetorë, deficiti korrent u ngushtua me rreth 18.8%, duke përforcuar kështu tendencën e nisur që prej tremujorit të parë të vitit 2012. Deficiti korrent u vlerësua në 7.7% ndaj PBB-së nominale[2] ose rreth 0.8 pikë përqindje më i ulët krahasuar me nivelin e tij në tremujorin e tretë të vitit 2011. Dinamika e llogarisë korrente gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, ashtu si dhe në dy tremujorët e mëparshëm, u ndikua gjerësisht prej ecurisë së bilancit të eksporteve neto. Në terma vjetorë, ngushtimi i deficitit tregtar me rreth 8.9% si dhe përmirësimi i bilancit të llogarisë së shërbimeve me rreth 13.7%, çuan në ngushtimin e deficitit të eksporteve neto për këtë periudhë me rreth 14.4%. Bilanci neto i llogarisë së të ardhurave rezultoi në suficit prej 20.8 milionë eurosh, kryesisht si pasojë e rënies së fluksit dalës të të ardhurave nga investimet e huaja direke dhe përmirësimit të bilancit nga të ardhurat e investimeve të portofolit. Suficiti i llogarisë së transfertave korrente u ngushtua me rreth 13.4% në terma vjetorë. Nënzëri kryesor i kësaj llogarie, transfertat prej emigrantëve, vijojnë pririjen rënëse vjetore. Në terma kumulativë nëntëmujorë, deficiti korrent u ngushtua me rreth 12.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë duke lehtësuar disi çështjen e qëndrueshmërisë së tij.

Grafik 1. Kontributi sipas zërave në deficitin korrent (në pikë përqindje).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[2] *PBB – ja nominale e përdorur për periudhën 2003 – 2010 është ajo e publikuar nga INSTAT-i. Shpërndarja nëpër tremujorë është bërë në bazë të peshave të PBB-së reale tremujore. Për vitin 2011 dhe 2012 janë përdorur projeksione të Departamentit të Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.*

Treguesi i shkallës së hapjes ekonomike të vendit tonë për tremujorin e tretë të vitit 2012 shënoi vlerën 92.4%, 8.9 pikë përqindje më i ulët krahasuar me nivelin e këtij raporti në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

*Ecuria e treguesve të sektorit të jashtëm të ekonomisë pasqyron ngushtim në terma vjetorë të deficitit të eksporteve neto reale,[3] gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012. Ngushtimi i deficitit të eksporteve neto ka ardhur si pasojë e rënies së importit të mallrave e shërbimeve në terma realë, me rreth 1.1%, dhe e rritjes së eksporteve të tyre me rreth 2.0% në terma vjetorë. Zhvillimet në balancën e importit dhe eksportit të mallrave e shërbimeve në terma realë, janë materializuar në një kontribut pozitiv të këtij komponenti në rritjen e kërkesës agregate përgjatë kësaj periudhe.*

Grafik 2. Kontributi i eksporteve neto në PBB-në reale (në pikë përqindje).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, flukset financiare nga pozicioni neto i kombinuar i llogarisë së të ardhurave, transfertave korrente dhe shërbimeve shënuan rënie me rreth 1.9% në terma vjetorë. Si rezultat, flukset neto të këtyre tre llogarive së bashku financuan rreth 63.3% të deficitit tregtar të regjistruar gjatë kësaj periudhe, raport ky rreth 4.5 pikë përqindje më i lartë krahasuar me atë të një viti më parë.

Bilanci neto i llogarisë së shërbimeve për tremujorin e tretë të vitit 2012 rezultoi me një suficit prej 132.6 milionë eurosh, në rritje me rreth 13.7% krahasuar me një vit më parë. Pas ngushtimit të theksuar të suficitit të kësaj llogarie gjatë vitit 2011, si pasojë e heqjes së regjimit të vizave ndaj Shqipërisë me vendet e Shengen-it, nëntë muajt e parë të vitit 2012 shënuan një ecuri mjaft pozitive të kësaj llogarie. Rritja e flukseve valutore në llogarinë e shërbimeve ishte më e ndjeshme gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, periudhë kjo që përkon dhe me sezonin turistik veror. Për pasojë, bilanci neto i llogarisë së shërbimeve të udhëtimit (personale dhe biznesi) luajti rolin më të rëndësishëm në zhvillimet në këtë llogari për periudhën e konsideruar. Bilanci neto i nën-zërit shërbime udhëtimi u përmirësua me rreth 44.4% në terma vjetorë, kryesisht si pasojë e rënies së shpenzimeve për shërbime udhëtimi për qëllime turizmi e biznesi të rezidentëve jashtë vendit me rreth 15.8% në terma vjetorë. Ndërkohë, prurjet valutore nga shërbimet personale të udhëtimit nga jorezidentët në vend shënuan rënie me rreth 5.1%, gjatë periudhës në analizë. Nën zëri shërbime të tjera (ku përfshihen shërbimet e komunikacionit, konstruksionit, qeveritare, financiare, kompjuteri dhe informacioni etj) regjistroi një bilanc pozitiv prej 31.5 milionë eurosh, në rënie me rreth 40.5% në terma vjetorë. Nga ana tjetër, bilanci negativ i shënuar në nënzërat e shërbimeve të transportit dhe shërbime sigurimi vijojnë të kontribuojnë negativisht në bilancin total të shërbimeve për tremujorin e tretë të vitit 2012.

[3] *Për kalimin nga terma nominalë në terma realë të importeve dhe eksporteve të mallrave është përdorur Indeksi i Vlerës Njësi përftuar nga të dhënat në vëllim të tregtisë së jashtme. Ndërsa, për importet dhe eksportet e shërbimeve është përdorur Indeksi i çmimeve të Konsumit të kategorisë së shërbimeve, llogaritur nga Banka e Shqipërisë.*

Grafik 3. Bilanci i shërbimeve
(flukse neto, në milionë euro).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Bilanci i të ardhurave
(flukse neto, në milionë euro).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kushtet e perceptimit të një rreziku të lartë, duke filluar prej vitit 2009, bilanci i të ardhurave shënoi një përkeqësim të vazhdueshëm, diktuar kryesisht nga rritja e përshpejtuar e riatdhesimit të të ardhurave nga investimet. Gjatë vitit 2011, bilanci i kësaj llogarie u përmirësua e ndikuar nga rënia e fluksit dalës të të ardhurave totale me rreth 44.9% në terma vjetorë. Bilanci neto i llogarisë të të ardhurave rezultoi me një suficit prej 8.7 milionë eurosh gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2012, në rënie me rreth 73.6% në terma vjetorë. Kahu i zhvillimeve në këtë llogari gjatë kësaj periudhe u përcaktua kryesisht nga rënia e kompensimit të punonjësve me rreth 21.6% në terma vjetorë. Në të njëjtin drejtim ndikoi dhe deficiti neto i të ardhurave nga investimet, i cili u zgjerua me rreth 5.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pas përkeqësimit për dy tremujorë radhazi të bilancit neto të të ardhurave, tremujori i tretë i vitit 2012 u mbyll me një bilanc pozitiv prej 20.8 milionë eurosh, në rritje me rreth 47.6% në terma vjetorë. Edhe pse në një nivel më të ulët krahasuar me një vit më parë, prurjet valutore të të ardhurave neto nga puna ndihmuan në përmirësimin e pozicionit të llogarisë të të ardhurave totale. Rritja e flukseve hyrëse të të ardhurave nga investimet dhe rënia e flukseve dalëse prej tyre përcaktuan ngushtimin e deficitit të të ardhurave neto nga investimet me rreth 83.9% krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Në terma vjetorë, deficiti i të ardhurave nga investimet e huaja direkte neto u tkurr me rreth 14.9% në terma vjetorë. Ndryshe nga viti 2011, bilanci neto i të ardhurave nga investimet e portofolit për tremujorin e tretë të vitit 2012 rezultoi me një suficit prej 17.6 milionë eurosh, nga 6.0 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Bilanci i të ardhurave nga investimet e tjera neto vijoi të shënojë vlera negative që prej tremujorit të katërt të vitit 2010, kryesisht si pasojë e rritjes së pagesave neto të interesit të borxhit privat dhe publik. Në tremujorin e tretë të vitit 2012, deficiti i këtij nën zëri të llogarisë të të ardhurave rezultoi rreth 2.4 milionë euro, kundrejt 6.0 milionë eurove që ishte një vit më parë. Pagesat neto të interesit të borxhit privat dhe publik në periudhën e konsideruar kanë ulur detyrimet e vendit me rreth 26.7 milionë euro.

Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2012 vihet re një rënie progresive e suficitit të llogarisë së transfertave korrente në terma vjetorë, burim ky i

rëndësishëm për financimin e deficitit korrent. Ngushtimi i suficitit të kësaj llogarie gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012, me rreth 7.6% në terma vjetorë u ndikua kryesisht prej rënies në zërat e transfertave korrente të tjera.

Grafik 5. Përbërja e të ardhurave nga investimet (flukse neto, në milionë euro).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Raporti i financimit të importeve të mallrave nga shuma e eksporteve, remitancave dhe IHD-ve.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tremujori i tretë i vitit 2012, u karakterizua nga një ngushtim me rreth 13.4% i suficitit të transfertave korrente neto. Transfertat e sektorit shtetëror dhe ato të sektorëve të tjerë shënuan rënie me përkatësisht 38.2% dhe 12.7% në terma vjetorë. Ndikuar nga kufizimet në tregjet e punës në vendet ku përqendrimi i emigrantëve është më i lartë, dërgesat e emigrantëve neto vijuan prirjen rënëse vjetore të nisur që prej vitit 2007, edhe pse me një ritëm më të moderuar. Në tremujorin e tretë të vitit 2012, flukset hyrëse të dërgesave të emigrantëve shënuan rënie me rreth 9.7% në terma vjetorë. Raporti i tyre kundrejt deficitit tregtar vlerësohet në nivelin 26.0%, raport ky rreth 0.6 pikë përqindje më i ulët se raporti i financimit i regjistruar në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## 1.2. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare regjistruan një bilanc pozitiv prej 176.8 milionë eurosh gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, duke financuar 89.2% të deficitit korrent të regjistruar gjatë kësaj periudhe. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, flukset kapitale dhe financiare shënuan rënie me rreth 22.3% dhe u vlerësuan në rreth 6.9% në raport ndaj PBB-së nominale. Rënia në terma vjetorë e flukseve valutore në këtë llogari u përcaktua kryesisht nga rënia me rreth 24.5% në terma vjetorë e flukseve financiare. Në raport ndaj PBB-së nominale, llogaria financiare u vlerësua rreth 6.5%, raport ky rreth 2.7 pikë përqindje më i ulët krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2011. Flukset neto në llogarinë kapitale shënuan një suficit prej 9.8 milionë eurosh gjatë tremujorit të tretë. Detyrimet financiare të rezidentëve ndaj jo-rezidentëve pësuan një rënie prej 9.1% në terma

vjetorë. Norma e rënies së detyrimeve financiare reflekton pjesërisht rënien e detyrimeve në formën e investimeve të tjera ndërsa detyrimet nga investimet e portofolit dhe IHD-të kanë shënuar rritje vjetore. Në kahun e mjeteve vendase të investuara në ekonomitë jo-rezidente evidentohet rritja e tyre me rreth 8.6% në terma vjetorë. Kjo ecuri u ndikua kryesisht nga rritja e mjeteve në formën e investimeve të tjera dhe IHD-ve. Investimet e portofolit shënuan rënie të mjeteve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012.

Investimet e huaja direkte neto (flukse hyrëse – dalëse) shënuan një rritje me rreth 4.9% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2011. Ky ndryshim vjen, në masën më të madhe, nga rritja me rreth 6.9% e detyrimeve në formën i IHD-ve (flukseve hyrëse të IHD-ve). Sipas instrumentit të përdorur për investime, IHD-të hyrëse në trajtën e letrave me vlerë të pasurisë (aksione) dhe ri-investim të fitimeve u vlerësuan në rënie me rreth 12.9% në terma vjetorë. Gjithashtu, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, u regjistrua një hyrje e lehtë kapitali në formën e kapitaleve të tjera ndërkohë që gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011 kjo kategori shënonte një dalje të kapitaleve të tjera. Në terma nëntëmujorë, investimet e huaja direkte neto kanë shfaqur një rritje prej 21.2% në terma vjetorë kryesisht nga rritja e detyrimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve. Shpërndarja sektoriale i IHD-ve, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, sugjeron për një përqendrim të tyre në sektorin e nxjerrjes së hidrokarbureve (rreth 64%) dhe sektori i telekomunikacionit (rreth 11%).

Grafik 7. Llogaria kapitale dhe financiare
(flukse neto, në milionë euro).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Investimet e portofolit hyrëse për tremujorin e tretë të vitit 2012 kontribuuan në rritjen e mjeteve vendase të investuara në ekonomitë e huaja me rreth 26.4 milionë euro. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ato rezultuan rreth 30.7 milionë euro më të ulëta. Në periudhën e konsideruar, rezidentët kanë investuar rreth 27.4 milionë euro në tituj borxhi. Flukset hyrëse të investimeve të portofolit shënuan rritje me rreth 33.7% në terma vjetorë, kryesisht të përqendruar në tituj borxhi. Për tremujorin e tretë të vitit 2012, pozicioni neto i investimeve të portofolit rezultoi -11.5 milionë euro duke reflektuar nivelin më të lartë të mjeteve tona të investuara në këtë instrument në ekonomitë e huaja. Në terma kumulativë nëntëmujorë, investimet e portofolit neto ishin rreth -35.1 milionë euro nga -74.1 milionë në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kahu i investimit u përcaktua nga mjetet tona të investuara në ekonomitë e huaja.

Grafik 8. Përbërësit e llogarisë kapitale
(flukse neto, në milionë euro).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, llogaria e investimeve të tjera neto u mbyll me një bilanc pozitiv duke kontribuar me rreth 14.6 milionë euro në rritjen e detyrimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve. Kjo vlerë është ndjeshëm më e ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ku investimet e tjera neto rezultuan në rreth 110.9 milionë euro. Kahu i flukseve financiare në këtë llogari u përcaktua nga rritja me rreth 175.2 milion euro e mjeteve tona të investuara në ekonomitë e huaja për tremujorin e tretë të vitit 2012. Në llogarinë e investimeve të tjera, detyrimet tona kundrejt jo – rezidentëve shënuan rënie me rreth 21.6% në terma vjetorë kryesisht si pasojë e rënies së huamarrjes private dhe shtetërore. Huamarrja private dhe shtetërore rezultoi rreth 27.2 milionë euro gjatë tremujorit në analizë nga 110.9 milionë euro që ishte në tremujorin e tretë të vitit 2011. Pagesat e borxhit (kryegjësë ose principalit) ulën detyrimet e vendit tonë me rreth 34.8 milionë euro në tremujorin në analizë

Duke filluar që prej tremujorit të dytë të vitit 2012, vihet re një rritje e mjeteve tona të investuara në ekonomitë jorezidente, kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve në formën e monedhave dhe depozitave të sistemit tonë bankar jashtë vendit. Kështu, depozitat e sistemit bankar vendas u rritën me 173.8 milionë euro nga 114.8 milionë euro të shënuara në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

*Borxhi i jashtëm bruto*

*Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2012, stoku i borxhit të jashtëm bruto i Shqipërisë shënoi vlerën totale prej 5,044.6 milionë euro. Në vlerë, stoku i borxhit u rrit me rreth 184.8 milionë euro krahasuar me tremujorin e mëparshëm dhe me rreth 633.1 milionë euro krahasuar me stokun e tij në fundin e tremujorit të tretë të vitit 2011. Në pjesën më të madhe, rritja e stokut të borxhit në fund të tremujorit të tretë të vitit 2012 u shkaktua nga rritja e huamarrjes së sistemit bankar dhe qeverisë qendrore. Në ndarjen sipas sektorëve institucionalë, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2012, sektori i qeverisë së përgjithshme zotëori rreth 44.9% të stokut total të borxhit. Pjesa tjetër është shpërndarë midis: sektorë të tjerë (19.1%), bankat (18.8%), investime të huaja direkte – hua ndërkompani (15.4%) dhe autoriteti monetar (1.8%).*

*Sektori me peshën më të madhe në totalin e stokut të borxhit mbetet qeveria qendrore. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2012, stoku i borxhit të sektorit të qeverisë qendrore rezultoi në rreth 2.3 miliardë euro. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2012 pesha e borxhit të qeverisë qendrore është luhatur në intervalin 44.9%- 51.5%, me peshën më të ulët në tremujorin e tretë të vitit 2012. Krahasuar me fundin e vitit 2011, vërehet një rënie e peshës së borxhit të qeverisë qendrore nga 46.0% në 44.9% në fundin e tremujorit të tretë të vitit 2012. Stoku i borxhit të jashtëm bruto të sistemit bankar në fund të tremujorit të tretë të vitit 2012 rezultoi në rreth 946.6 milionë euro, në rritje më rreth 235.3 milionë euro krahasuar me fundin e vitit 2011. Stoku i borxhit të jashtëm të sektorëve të tjerë rezultoi në rreth 964.6 milionë euro, duke shënuar një rritje të lehtë nga viti 2011 me rreth 43.8 milionë euro. Pesha e tij në totalin e stokut të borxhit të jashtëm për periudhën e konsideruar ishte rreth 19.1%, në rënie krahasuar me fundvitin 2011 dhe 2010. Stoku i investimeve të huaja gjatë periudhës së konsideruar u vlerësua në rreth 778.0 milionë euro, në rritje me rreth 9.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.*

*Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2012, rreth 66.2% e stokut të borxhit (duke përjashtuar investimet direkte – hua ndërkompani), vlerësohet të jetë borxh afatgjatë kryesisht në formën e huave. Borxhi afatshkurtër për periudhën e konsideruar vlerësohet në rreth 18.4% i marrë kryesisht në formën e monedhave dhe depozitave nga sektori bankar. IHD-te përfaqësojnë rreth 15.4% ndaj stokut total të borxhit publik. Sektori i qeverisë së përgjithshme dhe autoritetit monetar zotërojnë vetëm borxh afatgjatë ndërsa sektori bankar dhe sektorët e tjerë zotërojnë një portofol të përbërë prej borxhit afatgjatë dhe afatshkurtër.*

Grafik 9. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve institucionalë (stok në fund të vitit, në % ndaj totalit).




*Shënim: Kjo e dhënë i referohet stokut të borxhit në fund të tremujorit të tretë të vitit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 10. Struktura e borxhit të jashtëm sipas maturitetit (stok në fund të vitit, në milionë euro).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Në ndarjen sipas instrumenteve dhe maturitetit, huatë përfaqësojnë instrumentin kryesor afatgjatë të investimit, me rreth 84.2% ndaj totalit të borxhit afatgjatë. Rreth 14.2% e borxhit afatgjatë mbahet në trajtën e dëftesave dhe obligacioneve (rreth 14.2% në periudhën e konsideruar).*

Grafik 11. Borxhi i jashtëm afatshkurtër dhe afatgjatë (stok në fund të vitit, në milionë euro).




*Shënim: Kjo e dhënë i referohet stokut të borxhit në fund të tremujorit të tretë të vitit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Borxhi afatshkurtër përfaqësohet kryesisht nga instrumenti i monedhave dhe depozitave, rreth 84.7% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2012. Kreditë tregtare gjatë periudhës së konsideruar përfaqësuan rreth 12.2% të stokut të borxhit afatshkurtër.*

Mjetet e rezervës valutore u rritën me rreth 89.7 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit 2012. Në fund të muajit shtator 2011, stoku i rezervës valutore rezultoi rreth 2.024,3 milionë euro, nivel ky i mjaftueshëm për mbulimin e 4.5 muaj importesh të mallrave dhe të shërbimeve.

# STUDIME E ARTIKUJ*

** Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

# "TRAJNIMI, TRANZICIONI, DHE ZHVILLIMI: ROLI I JOINT VIENNA INSTITUTE"

## ESEJA FITUESE E KONKURSIT ME RASTIN E 20 VJETORIT TË KRIJIMIT TË INSTITUTIT NDËRKOMBËTAR TË VJENËS

ALBINA DEMOLLARI

Duke menduar për rolin e edukimit në përgjithësi dhe trajnimeve në veçanti, mendja më shkon te një situatë e vështirë, teksa po ngisja makinën përgjatë një rruge malore. Papritur, u ndodha përballë një shtëllunge të dendur mjegulle e s'dija ç'drejtim të merrja, si ta qartësoja shikimin, me parmakët anësorë të vetmit mbrojtës nga vdekja. Një situatë kaq e ngjashme me dikë të pashkolluar, të patrajnuar, që s'di ç'hapa të hedhë, ç'alternativë të zgjedhë, si të përparojë. E tillë ishte Shqipëria para viteve 1990, duke ndjekur rrugën e gabuar, atë të planifikimit qendror, pa ditur asgjë për ekonominë e tregut. Është një situatë, të cilën edukimi në përgjithësi dhe trajnimi i ofruar nga Joint Vienna Institute (JVI) në veçanti, e kanë ndihmuar të rregullohet, duke rritur njohuritë dhe aftësitë profesionale të punonjësve publikë, duke i ndihmuar ata të largojnë terrin e të gjejnë rrugën e duhur, duke e lehtësuar tranzicionin dhe duke i bërë ekonomitë e tregut të lulëzojnë.

Para viteve të tranzicionit, shqiptarët nuk dinin asgjë për liberalizimin, caktimin e çmimeve nga forcat e tregut, lirinë e fjalës apo pluralizmin. Madje, as që guxonin të mendonin për pronën private apo të drejtat mbi pronën; e gjithë ekonomia zotërohej nga shteti dhe gjithçka kontrollohej e planifikohej nga qeveria.

Fatmirësisht, viti 1991 erdhi e bashkë me të erdhën edhe ndryshime të pashmangshme, të përhershme, transformime rrënjësore, agimi i një epoke të re, rënia e ekonomisë së centralizuar dhe nisja e rrugëtimit drejt ekonomisë së tregut. Ishte një proces që kishte filluar tashmë në vendet e tjera ish-socialiste, por që trokiti edhe në derën tonë, duke ndikuar në jetën dhe mendësinë e shqiptarëve.

Gjatë viteve të para të tranzicionit, shqiptarët e kuptuan se nevojiteshin transformime të mëdha. Gjendja e krijuar kërkonte reforma rrënjësore, ekonomike, ligjore dhe strukturore. Shqipëria kish qenë një vend i mbyllur, ndaj njerëzit nuk e njihnin botën e përparuar, arritjet e saj, mënyrën e funksionimit të ekonomisë së tregut. Arsimi që ata kishin përfituar deri atëherë e kish vënë theksin te planifikimi qendror dhe dobitë e pronës së përbashkët. Njerëzit zgjodhën ndryshimin, aspiruan reformimin e vendit të keq-qeverisur dhe hyrjen në Evropën e bashkuar, por nuk dinin çfarë reforma konkrete të ndërmerrnin, apo çfarë ndryshime ligjore nevojiteshin.

Shqipëria filloi të hapej ndaj botës së jashtme, e bashkë me të filloi të rritej edhe ndërgjegjësimi për përfitimet nga ekonomia e tregut dhe për arritjet e vendeve të industrializuara, gjë që shtroi si nevojë të ngutshme edukimin dhe

trajnimin e punonjësve në fushën ekonomike. Duke u përpjekur të përfitonin nga mësimet e nxjerra prej vendeve që kishin përparuar ekonomikisht, duke e ndjerë progresin e tyre, shqiptarët e kuptuan se kishin në dorë fatin e vendit. Ndaj, e kthyen vështrimin te vendet e zhvilluara, me synim zhdukjen e prapambetjes ekonomiko-financiare të rrënjosur thellë për rreth 50 vjet, përfitimin nga përvoja e përparuar dhe politikat e suksesshme, përvetësimin e praktikave dhe standardeve më të mira, për ta bërë etapën e re të prodhojë rezultate pozitive, e për të ndërtuar një vizion të qartë për zhvillimin ekonomik të vendit.

Më konkretisht, shqiptarët iu drejtuan organizmave ndërkombëtare trajnuese, të etur për njohuri mbi mënyrën se si funksiononte ekonomia e tregut, si mund të kryhej privatizimi, si mund të ofroheshin produkte financiare, si mund të arrihej stabiliteti financiar. Ata ishin të vetëdijshëm se s'kishin çfarë të shpiknin, thjesht të dëgjonin këshillat e duhura, t'i kushtonin vëmendje ekspertizës dhe të trajnoheshin mbi standardet ndërkombëtare të pranuara gjerësisht, zbatimi i të cilave do ta ndihmonte ekonominë të rritej dhe Shqipërinë të përparonte.

Nga ana tjetër, organizatat ndërkombëtare trajnuese e shqyrtuan nevojën e ngutshme për trajnim të punonjësve publikë të vendeve me ekonomi në tranzicion, përfshirë Shqipërinë, dhe e vendosën atë në qendër të vëmendjes. Vullnetarisht, hartuan programe trajnuese gjithëpërfshirëse dhe ftuan punonjës të nivelit të mesëm dhe të lartë, si dhe drejtues të sektorit privat nga vendet në tranzicion, si Shqipëria, Evropa Qendrore dhe Lindore, Azia Qendrore, Ukraina, Rusia e shtete të tjera të reja e të pavarura, për të marrë pjesë në konferenca, seminare, tryeza akademike dhe takime konstruktive, me qëllim pajisjen e tyre me njohuri të thella dhe aftësi praktike mbi çështje që lidhen me ekonominë e tregut, duke iu dhënë atyre mundësi që do t'i ndihmonin të kontribuonin në kalimin e suksesshëm të vendit të tyre nga ekonomi e planifikuar në ekonomi tregu.

Për rrjedhojë, organizata të ndryshme ndërkombëtare ofruan kurse të shumta trajnuese. Mund të përmendim këtu Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Institutin Ndërkombëtar të Trajnimeve Vjenë, Institutin e Stabilitetit Financiar dhe Bankën për Rregullime Ndërkombëtare, Bankën Botërore, Bankën Qendrore Evropiane, Deutche Bundesbank, Bankën Qendrore të Italisë, Bankën e Gjermanisë, Bankën Kombëtare Çeke, GTZ, Bankën e Rezervës Federale të Nju Jorkut, etj. Trajnimet iu ofruan pjesëmarrësve të përshtatshëm nga Shqipëria dhe vendet e tjera të përmendura më lart, duke iu dhënë atyre mundësinë të ndiqnin kurse profesionale në fusha të ndryshme ekonomike, të zhvillonin aftësitë e tyre për shumë çështje ekonomike dhe të forconin rritjen e tyre profesionale.

Falë rolit kyç të edukimit dhe trajnimit të ofruar përgjithësisht nga qendrat trajnuese ndërkombëtare, shqiptarët kaluan nga koha kur ishin plotësisht të pavetëdijshëm për rreziqet që burojnë nga investimet në skemat piramidale, të cilat përfundimisht shemben, në rritjen e ndërgjegjësimit të tyre mbi raportin rrezik-kthim; nga koha kur numri i profesionistëve planifikohej nga

qeveria, në një sistem arsimor të liberalizuar; nga koha kur nuk ekzistonte prona private, në privatizimin e shumë ndërmarrjeve shtetërore; nga koha kur produktet financiare nuk njiheshin, në ofrimin e një game të gjerë produktesh financiare, duke rritur kështu shkallën e njohjes së përfitimeve nga diversifikimi i rrezikut.

Nga një vështrim mbi bazën e të dhënave të burimeve njerëzore të Bankës së Shqipërisë mbi trajnimin e stafit dhe nga një pyetësor i zhvilluar me pjesëmarrës të ndryshëm në kurset trajnuese, duket qartë se që prej vitit 1992, JVI ka luajtur rol vendimtar në trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të Bankës.

Ky kontribut i çmuar vërehet çdo ditë në Bankën e Shqipërisë, një institucion që shënoi kalimin në sistemin bankar dynivelor, një institucion që ka në organikën e tij një numër të madh akademikësh dhe ekspertësh të trajnuar pranë JVI. Nëpunësit e trajnuar janë kthyer të pajisur më së miri me ide të reja mbi profesionin e tyre, me shumë frymëzim, por mbi gjithçka me aftësi praktike dhe njohuri të thella mbi çështjet ekonomike, të vendosur për të kontribuar në këtë botë në ndryshim.

Siç përcaktohet edhe nga misioni i JVI, "JVI ofron udhëzim në standardin më të lartë, për t'i ndihmuar vendet në kalimin në ekonomi me bazë të plotë tregu". Që nga krijimi, JVI i ka ndihmuar shqiptarët të dëshmojnë arritjet e botës së përparuar dhe të kuptojnë lidhjen e qartë ndërmjet trajnimit dhe përparimit. Për më tepër, JVI e ka lehtësuar procesin e tranzicionit, duke i bashkuar nëpunësit nga Shqipëria dhe nga vendet e tjera me ekonomi në tranzicion për të diskutuar dhe trajtuar çështje e shqetësime lidhur me tranzicionin, duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre aktive në analizimin e çështjeve të ndryshme ekonomike, duke i njohur ata me modelet e suksesshme, duke i ndihmuar të kryejnë kërkime dhe të propozojnë plane të reja për përmbushjen me sukses të reformave ekonomike.

Më konkretisht, JVI, ky institut ndërkombëtar trajnimesh që sponsorizohet nga FMN, Autoritetet Austriake dhe organizata të tjera, ka kontribuar ndjeshëm në përgatitjen e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për etapën e re, me qëllim rolin e tyre aktiv në procesin e tranzicionit të Shqipërisë. Prej rreth dy dekadash, JVI ka investuar për nëpunës dhe drejtues shqiptarë, duke iu mundësuar pjesëmarrjen në seminare të shumta mbi një numër të madh temash të specializuara, duke i trajnuar vazhdimisht, duke zgjeruar njohuritë profesionale dhe aftësitë e tyre praktike, të cilat kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme në funksionimin e Bankës së Shqipërisë dhe në transformime të mëdha të sistemit bankar shqiptar e më gjerë.

Nga viti 1992 e në vazhdim, pjesëmarrja në seminaret e JVI ka siguruar jo vetëm analiza të hollësishme për çështje ekonomike, por edhe shkëmbim përvoje ndërmjet bankierëve, ekspertëve të Ministrisë së Financave dhe lektorëve të kualifikuar. Në këto seminare lektorët e përkushtuar iu janë përgjigjur pyetjeve të të pranishmëve mbi detaje teknike dhe shqetësime në lidhje me çështje të ndryshme. Bashkëpunimi, ndarja e njohurive, shkëmbimi

i ideve, kanë kontribuar në përmirësimin e imazhit të Bankës së Shqipërisë, rritjen e qëndrueshmërisë të sistemit financiar, fuqizimin e sektorit bankar dhe rritjen ekonomike.

Nga një shikim i shpejtë i temave të shumta të trajtuara në seminaret dhe konferencat e JVI, të bie në sy fakti se shumë prej tyre janë ri-trajtuar vit pas viti, duke siguruar mundësinë që e njëjta temë të trajtohet me pjesëmarrës të tjerë, duke e përditësuar dhe pasuruar atë me gjetje të reja kërkimore, në përputhje me risitë dhe zhvillimet e reja që ndodhin në këtë botë të globalizuar.

Temat e trajtuara në kurset trajnuese të JVI variojnë nga çështje e shqetësime të përbashkëta mbi tranzicionin dhe mënyrat e trajtimit të tyre, në bankingun qendror, politikën monetare dhe të kursit të këmbimit, zbatimin e tyre, kanalet dhe mekanizmat e transmisionit të politikës monetare, të cilat kontribuojnë në kalimin e suksesshëm në ekonomi tregu dhe stabilitetin makroekonomik.

Është e vështirë të përcaktohen qartë temat më të vlefshme, pasi ato janë të shumta e mjaft produktive. Megjithatë, do të doja të vija në dukje disa prej tyre, të cilat, sipas mendimit tim, kanë kontribuar në nxitjen e reformave dhe kanë ndikuar ndjeshëm në transformimet e sistemit financiar shqiptar në përgjithësi, dhe atij bankar në veçanti.

## STABILITETI FINANCIAR

Gjatë viteve të para të tranzicionit, planifikimi qendror, ndonëse në rënie, i përballi me shumë dobësi e mangësi të trashëguara vendet me ekonomi në tranzicion, të cilat po përjetonin transformime të mëdha, në përpjekje për të ndërtuar një ekonomi të lirë tregu.

Për rrjedhojë, JVI i kushtoi prioritet stabilitetit financiar. Kurse përkatëse, seminare, leksione, raste studimore dhe panele diskutimesh kanë trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse çështje të sektorit financiar. Ato i kanë pajisur bankierët qendror dhe përfaqësues të ministrive të financës dhe të agjencive rregullatore me informacion mbi rolin dhe rëndësinë e tregjeve financiare, tregjeve të letrave me vlerë, instrumentet financiare, caktimin e çmimit, administrimin e rrezikut, rreziqet e tregut dhe të kredisë, tregjet e kapitalit dhe të parasë, rolin e sektorit financiar në ekonomi, rolin e qeverisë në mbarëvajtjen e sektorit financiar, raportin ndërmjet bankës qendrore dhe sektorit financiar, mësimet e nxjerra nga kriza të ndryshme, modele të administrimit të rrezikut, instrumente për injektimin e likuiditetit, prova e rezistencës etj, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e analizës dhe vlerësimin financiar, dhe çojnë drejt stabilitetit të përgjithshëm financiar.

JVI ka ndihmuar Shqipërinë dhe vendet e tjera me ekonomi në tranzicion të përmbushin me sukses reformat në sistemin financiar, duke sjellë si rezultat risi në tregjet financiare në përgjithësi dhe në instrumentet financiare në veçanti. Kështu, në Shqipëri, janë krijuar tregjet primare dhe sekondare të letrave me vlerë; është rritur numri i institucioneve financiare duke e plotësuar panoramën

e përgjithshme të sektorit financiar; janë ofruar shërbime financiare edhe në zonat më të largëta të vendit; është zgjeruar spektri i produkteve financiare; është rritur besimi i publikut në sistemin financiar; dhe është arritur stabiliteti financiar.

## POLITIKA MONETARE

Politika monetare e vendeve në tranzicion ka evoluar në të njëjtën linjë me transformimet e mëdha të secilit vend. Në Shqipëri, vitet e para të tranzicionit ishin kaotike, me firmat piramidale të destinuara për t'u shkatërruar në vitin 1997 dhe me një normë inflacioni galopant, me njerëz tërësisht të painformuar për sistemet dhe produktet e shëndetshme financiare.

Seminaret e JVI kanë trajtuar një tërësi çështjesh lidhur me politikën monetare, duke e konsideruar atë si prioritet kyç për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Ato i kanë njohur bankierët qendrorë të vendeve në tranzicion me bazat teorike, objektivat e bankës qendrore, rolin e saj në drejtimin e politikës monetare, rolin e politikës monetare në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomike, bashkëveprimin ndërmjet politikave monetare e fiskale e regjimet e politikës monetare.

Seminaret përkatëse i përgatitën pjesëmarrësit të vlerësonin regjimet e ndryshme të politikës monetare dhe të propozonin regjimin më të favorshëm për vendin, duke nënvizuar stabilitetin e çmimeve si objektivin primar të shumë bankave qendrore. Falë këtyre trajnimeve, ekspertët e Bankës së Shqipërisë kanë kontribuuar në zbatimin e shënjestrimit të inflacionit në Shqipëri, me synim mbajtjen e inflacionit në kontroll.

Gjithashtu, JVI i ka kushtuar vëmendje të veçantë forcimit të pavarësisë së bankës qendrore nëpërmjet transparencës dhe eficiencës. Si rezultat, ekspertët e Bankës së Shqipërisë e kanë trajtuar shpesh këtë çështje dhe kanë mundësuar rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë të Bankës së Shqipërisë, pavarësinë dhe besueshmërinë e saj, dhe efektivitetin e politikës monetare. Përvoja e shkëmbyer ka çuar në ndërtimin e një metodologjie për hartimin e indeksit të transparencës dhe në një komunikim më të mirë me publikun e gjerë.

Në këto seminare, janë identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në regjimin e kursit të këmbimit, avantazhet dhe disavantazhet e tyre, dhe mësimet e nxjerra nga vende që zbatojnë një regjim të caktuar. Duke mësuar nga përvoja e vendeve të ndryshme në këtë drejtim, ekspertët shqiptarë kanë zbatuar suksesshëm regjimin e kursit të luhatshëm të këmbimit në vend, duke çuar kështu në reduktimin e luhatshmërisë të kursit të këmbimit, forcimin e sistemit bankar në tërësi dhe rritjen e besimin të publikut ndaj Bankës së Shqipërisë.

## KUADRI RREGULLATOR

Kurset trajnuese të JVI kanë ndikuar ndjeshëm në plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator të ekonomive në tranzicion. Në Shqipëri, kanë ndihmuar në transformimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, hartimin e akteve të reja ligjore e nënligjore. Rezultate më të rëndësishme janë arritur në drejtimet e mëposhtme:

### Privatizimi

Në Shqipëri, kontributi i JVI ka ndihmuar në hartimin e ligjeve që do të çonin drejt privatizimit të shpejtë, parakusht për kalimin në një ekonomi të lirë tregu. Falë rekomandimeve dhe ndarjes së njohurive nga aktivitetet përkatëse të organizuara nga JVI dhe institucione të tjera trajnuese, falë gatishmërisë së shqiptarëve për privatizimin e ekonomisë, kuadri ligjor dhe rregullator u ndryshua, plotësua dhe përmirësua; u krijuan institucione të reja; sektori privat filloi të lulëzojë; u vendosën të drejtat mbi pronën, të drejtat mbi pronësinë intelektuale; dhe njerëzit u bënë më të pasur.

### Ndryshime institucionale në rrugën drejt Bashkimit Evropian

Shqiptarët aspirojnë anëtarësim në Bashkimin Evropian. Megjithatë, ata po përballen me shumë sfida në rrugën drejt integrimit evropian.

Në drejtim të legjislacionit bankar, diskutimet dhe ndarja e përvojës ka bërë që ekspertët e Bankës së Shqipërisë të propozojnë dhe nxitin iniciativa që çojnë në ndryshime të legjislacionit shqiptar dhe transformime të ekonomisë në tërësi. Për rrjedhojë, pavarësia institucionale është forcuar; eficienca ekonomike është rritur; dhe legjislacioni shqiptar është përafruar me atë të Bashkimit Evropian.

### Mbikëqyrja bankare

Vitet e tranzicionit sollën shumë sfida për mbikëqyrësit bankarë, të cilëve iu mungonin njohuritë në këtë drejtim. Megjithatë, JVI iu erdhi në ndihmë duke iu dhënë mundësi të trajnoheshin në temat dhe konceptet përkatëse, në parimet bazë dhe standardet më të mira. Si rezultat i kualifikimeve përkatëse, mbikëqyrësit bankarë janë aftësuar në kryerjen e inspektimeve në vend dhe analizave nga jashtë. Ata kanë zbatuar me sukses parimet bazë, kanë përmirësuar kuadrin licencues, i kanë kushtuar vëmendje mbikëqyrjes me bazë rrezikun, kanë krijuar zyrën e regjistrit të kredive, duke përmirësuar kredinë bankare dhe menaxhimin e rrezikut të kredisë, duke i kushtuar vëmendje mbikëqyrjes të konsoliduar dhe ruajtjes së stabilitetit të përgjithshëm.

### Sistemet e pagesave

Seminaret lidhur me sistemet e pagesave kanë nënvizuar rëndësinë e tyre dhe kanë ofruar informacion mbi rreziqet që i shoqërojnë dhe shërbimet e parasë elektronike. Si rezultat, ekspertët shqiptarë kanë implementuar sistemin

shqiptar të pagesave ndërbankare në vlerë të madhe dhe sistemin e shlyerjes së pagesave në vlerë të vogël, duke sjellë kështu risi në bankingun elektronik, rritje të numrit të mbajtësve të kartave të kreditit dhe debitit, si dhe rritje të numrit të transaksioneve elektronike, gjë që ka reduktuar përdorimin e parasë të gatshme në ekonomi dhe rrezikun nga sistemet e pagesave. Për rrjedhojë, vendi është pajisur me sisteme moderne pagesash dhe besimi i publikut në sektorin bankar shqiptar është rritur.

## ZHVILLIMI INSTITUCIONAL

Seminaret përkatëse të JVI i kanë trajnuar pjesëmarrësit për identifikimin e treguesve të stabilitetit ekonomik dhe financiar, mënyrën, parimet dhe metodat kryesore të hartimit të tyre. Për rrjedhojë, është rritur niveli i ekspertizës së pjesëmarrësve mbi konceptet përkatëse dhe aspektet institucionale, duke i bërë ata profesionistë më të mirë, duke i pajisur me njohuri të përditësuara e gjetje të reja shkencore, duke i përgatitur për një mënyrë të re pune, duke çuar në ndryshime gjithëpërfshirëse në kuadrin institucional, duke përmirësuar kapacitetin institucional, duke ndikuar kështu në ecurinë e përgjithshme institucionale.

Në këtë drejtim, të bën përshtypje mënyra se si lektorë të zotë e profesionistë të suksesshëm të kurseve trajnuese të JVI, pas nxjerrjes së thelbit të një teme të caktuar, organizojnë raste studimore dhe veprimtari të tjera interaktive, duke i përfshirë pjesëmarrësit në diskutime për shembuj konkretë, duke gërshetuar aspektet teorike me ato praktike, duke tërhequr interesin e tyre, duke iu hapur mendjen ndaj alternativave të shumta, duke i bërë ata të nxjerrin në dritë mendimet individuale, duke testuar nivelin e njohurive të tyre dhe duke i përgatitur të zbatojnë me sukses mësimet e nxjerra.

Nga këndvështrimi praktik, aktivitetet interaktive përgjithësisht kanë rezultuar më të efektshme se teoritë e përftuara nëpërmjet leximit individual. Aktivitete të tilla kanë nxitur analizën për çështje lidhur me tranzicionin, përvojën specifike të vendeve, zhvillimin ekonomik të vende të ndryshme, faktorëve përcaktues për opsionet e politikave ekonomike, si dhe avantazhet dhe disavantazhet e secilit opsion. Në këtë mënyrë, këto aktivitete iu kanë rritur pjesëmarrësve njohuritë mbi çështjet përkatëse, formimin e tyre të përgjithshëm, aftësimin për të dalluar të drejtën nga e gabuara dhe për të bërë zgjedhjen e duhur.

Temat e lartpërmendura dhe aktivitetet e shumta të organizuara nga JVI kanë përcjellë njohuri dhe ekspertizën më të mirë, trashëgiminë e pasur profesionale, duke e lehtësuar kështu periudhën e tranzicionit, duke e ngritur bashkëpunimin dhe partneritetet me homologët e huaj në një stad më të lartë, duke bërë të përvetësohen teoritë dhe praktikat më të mira, dhe duke i bërë përfitimet e ekonomisë me bazë tregu të prekshme në të gjithë vendin.

Aktualisht, vendet i kanë përballuar me sukses sfidat e tranzicionit. Megjithatë, roli i JVI ende nuk është përmbushur. Kundrejt një mjedisi me brishtësi dhe dobësi të shfaqura gjatë këtyre kohërave të trazuara të krizës

financiare globale, JVI ka ende shumë për të bërë. Ky institucion duhet t'iu përgjigjet zhvillimeve aktuale, të propozojë plane për pasurimin e kurseve trajnuese me çështje të reja në dritën e zhvillimeve dhe ndodhive të reja, me qëllim përgatitjen e pjesëmarrësve për trajtimin me profesionalizëm të problemeve dhe shqetësimeve aktuale, dhe për t'i ndihmuar ata të kontribuojnë në daljen me sukses.

## PËRFUNDIME

Tashmë që JVI po feston përvjetorin e 20-të të krijimit, jemi pushtuar nga mirënjohja dhe vlerësimi për këtë institucion ndërkombëtar trajnues, i cili ka luajtur një rol aktiv në procesin e tranzicionit në Shqipëri dhe është bërë një qendër e frytshme e ndarjes së përvojës, transferimit të njohurive dhe këshillimit ekonomiko-financiare, duke nxitur zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, duke rritur aftësitë profesionale të nëpunësve, duke i bërë ata të dalin në ballë me ide të reja dhe të kontribuojnë në zbatimin me sukses të reformave ekonomike.

Në përfundim të udhëtimit tim imagjinar mbi trajnimin, tranzicionin dhe zhvillimin, ndodhem përsëri në ngjitje të një rruge malore, plot me të përpjeta e të tatëpjeta, plot me sfida dhe rreziqe, ndonëse përballë kam lindjen e diellit, shikimin e qartë, ajrin e freskët dhe klimën e favorshme. Është një situatë që kontributi i pamasë i JVI ka krijuar në vendet me ekonomi në tranzicion, duke i larguar ata nga terri i shkaktuar prej planifikimit qendror e duke i çuar drejt dritës së diellit, duke iu përcjellë njohuri profesionale, teorike dhe praktike.

JVI i ka ndihmuar punonjësit e trajnuar të heqin perden e mjegullës e të qartësojnë shikimin, i ka bërë ata më të vetëdijshëm për përfitimet e ekonomisë së tregut dhe i ka ndihmuar të kontribuojnë për kalimin e suksesshëm të vendit nga ekonomi e centralizuar në ekonomi tregu.

Është ky kontribut i madh që e ka kthyer institutin e JVI, këtë qendër trajnuese profesionale, në një burim të pashtershëm njohurish, duke i pajisur njerëzit me pushtet për zbatimin e suksesshëm të reformave ekonomike, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm.

Në një kuadër më të gjerë, mendoj se trajnimi është një dhuratë që i bën individët e trajnuar të zotë e të hapur, i aftëson për zgjedhjen e duhur. Është cilësia që i dallon ata nga të tjerët, atributi që i bën ata të suksesshëm, mjeti që iu ndriçon mendjen. Është drita që i udhëheq nga ambiciet drejt arritjeve të prekshme. Është mjeti që çon drejt zhvillimit të mëtejshëm ekonomik në botë.

# SHËNJESTRIMI I PBBN-SË: RASTI I SHQIPËRISË

ENDRIT YZEIRAJ
DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

## I. HYRJE

Kriza financiare globale dhe efektet e saj kanë nxitur mjaft ekonomistë që të rishqyrtojnë kuadrin me të cilin ata vepronin. Nisur nga madhësia e tkurrjes ekonomike dhe paaftësia e ekonomive të ndryshme për t'u ripërtërirë në mënyrë të shpejtë, mjaft prej teorive të mëparshme po rianalizohen duke përdorur evidenca të mbledhura rishtazi. Në një material të rëndësishëm, Olivier Blanchard, kryeekonomisti i FMN-së, paraqet në terma mjaft të qartë se si kriza ndikoi mënyrën e të menduarit në fushën e ekonomisë[1]. Inflacioni i shënjestruar, kuadri i parapëlqyer për politikën e bankës qendrore, po shqyrtohet gjithashtu. Kjo nuk është befasuese pasi inflacioni ka qenë relativisht i qëndrueshëm në pjesën më të madhe të vendeve të prekura nga kriza, por ai është shoqëruar me rritje të ulët ekonomike. Një nga argumentet më të forta për zbatimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar ishte se duke ulur luhatshmërinë dhe pasigurinë, ai do të çonte në një rritje ekonomike afatgjatë më të lartë. Mbasi ka dështuar në dukje në arritjen e këtij objektivi, është krejtësisht normale që të pritet një diskutim mbi objektivat e rinj të mundshëm.

Banka e Shqipërisë ka qenë një nga bankat qendrore që ka zbatuar regjimin e inflacionit të shënjestruar. Ekonomia shqiptare po përjeton gjithashtu efekte të ngjashme me ato të vendeve të tjera. Ndonëse inflacioni ka mbetur brenda intervalit të objektivit të Bankës së Shqipërisë, norma e rritjes ekonomike është ngadalësuar gjatë viteve të fundit. Gjatë kohës së zbatimit të regjimit të inflacionit të shënjestruar, Guvernatori (2007) deklaroi se: "Banka qendrore duhet të vlerësojë në kohë efektet e ndryshimeve ekonomike, politike e shoqërore për t'iu përgjigjur këtyre ndryshimeve në kohë dhe me eficiencë". Si banka qendrore e një ekonomie të vogël dhe të hapur, nuk do ishte pozitive që të humbisnim lidhjet me zhvillimet e fundit në teorinë dhe politikat ekonomike monetare. Është me interes që të analizohet se çfarë mund të sjellë një regjim alternativ për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë dhe efektet e tij në ekonomi.

Qëllimi i këtij materiali është që të paraqesë në mënyrë të përmbledhur një nga objektivat e rinj më të njohur që po diskutohet sot, PBB-ja nominale (PBBN). Materiali vijon si më poshtë: Seksioni II bën një prezantim të shënjestrimit të PBBN-së, pasuar nga arsyetimet pro dhe kundër një politike të tillë. Seksioni III paraqet një diskutim mbi ndikimin që shënjestrimi i PBBN-së do të kishte mbi ekonominë shqiptare. Në fund, materiali paraqet konsideratat përfundimtare.

[1] *Blanchard et al. Rethinking Macroeconomic Policy. IMF Staff Positions Note. http://www.imf.org/external/pubs/ft/spn/2010/spn1003.pdf*

## II. KONSIDERATA TEORIKE

Një nga idetë që duket se ka ndikuar më së shumti në mendimin ekonomik në nivelet më të larta të vendimmarrësve është "Shënjestrimi i Nivelit të PBB-së Nominale" (që këtej e tutje Shënjestrimi i PBBN-së), konsideruar si "ideja e parë e lindur prej sferës së blogjeve ekonomike". Gjithsesi, kjo ide u përhap shpejt. Institucione financiare, si për shembull Goldman Sachs, i dhanë mbështetjen e tyre. Botime të rëndësishme, si për shembull "Financial Times" dhe "*The Economist*"[2], si dhe ekonomistë të tjerë[3], kanë dalë në mbështetje të saj. Zhvillimi më i rëndësishëm ndodhi gjatë Simpoziumit Vjetor në Jackson Hole të organizuar nga Rezerva Federale në shtator të vitit 2012. Michael Woodford, një nga ekonomistët monetarë më të shquar në botë, prezantoi një material gjithëpërfshirës në të cilin argumentonte se bankingu qendror duhet të përqendrohet më tepër në shënjestrimin e nivelit të PBB-së nominale sesa thjesht në shënjestrimin e inflacionit[4]. Materiali duket se ka pasur sukses në zhvendosjen e mendimit të bankave qendrore kryesore të botës lidhur me politikat e tyre. Gjuha e përdorur në deklaratat e fundit të Kryetarit të Fed, Ben Bernanke, ka ndryshuar dukshëm në krahasim me komunikimet e mëparshme, duke përfshirë gjithashtu objektiva dhe pritshmëri të reja.

Përpara se të fillojmë me shpjegimin e metodës, është e rëndësishme që të përmendim dy shënime. Së pari, për momentin nuk ekziston asnjë model apo metodologji formale e miratuar, domethënë matematikore, lidhur me shënjestrimin e PBBN-së. Gjatë kohës që ne po flasim, ekonomistët po zhvillojnë pjesën më të madhe të tij. Për këtë arsye, ky material ka natyrë përshkruese, duke u mbështetur në intuitën ekonomike mbi të cilën bazohet shënjestrimi i PBBN-së. Së dyti, ideja për shënjestrimin e PBBN-së është nxitur dhe nga pamjaftueshmëria e kuadrit aktual për të ngritur ekonomitë e goditura më shumë nga kriza për shkak të normës së interesit afër kufirit të poshtëm të zeros. Ky nuk është domosdoshmërisht rasti i ekonomisë shqiptare. Në këtë moment, norma e marrëveshjeve të riblerjes me afat njëjavor të Bankës së Shqipërisë është 3.75. Kjo tregon se politika monetare standarde ka hapësira të konsiderueshme për manovrim në rast përkeqësimi të mëtejshëm të kushteve ekonomike. Për këtë arsye, ky material nuk duhet të shihet si një thirrje për ndryshim të politikave, por si një përmbledhje e mënyrës se si ky objektiv hipotetik do të ndikonte politikën monetare në Shqipëri.

Në thelb, shënjestrimi i PBBN-së nënkupton se banka qendrore zgjedh një ecuri specifike rritjeje të PBB-së nominale dhe përpiqet të përdorë të gjitha instrumentet e mundshme për ta arritur atë. Norma e rritjes së PBBN-së është sigurisht shuma e normës së rritjes reale ekonomike dhe e normës së inflacionit[5]. Për këtë arsye, sipas objektivit të PBBN-së, banka qendrore duhet të ruajë një normë rritjeje nominale konstante.

---

[2] *The Economist http://www.economist.com/node/21526886*

[3] *Christina Romer, NY Times http://www.nytimes.com/2011/10/30/business/economy/ben-bernanke-needs-a-volcker-moment.html?_r=0*

[4] *Woodford, Michael. Methods of Policy Accommodation at the Interest-Rate Lower Bound. http://kansascityfed.org/publicat/sympos/2012/mw.pdf?sm=jh083112-4*

[5] *Për arsye përtej qëllimit të këtij materiali, inflacioni për PBBN-në zakonisht llogaritet si ndryshimi i deflatorit të PBB-së dhe jo i IÇK-së.*

Një risi e këtij kuadri është se është një objektiv niveli. Kjo kërkon që banka qendrore të arrijë një nivel të caktuar të PBBN-së dhe jo thjesht një normë rritjeje. Nëse për një periudhë të caktuar, ekonomia karakterizohet nga një nivel i ulët rritjeje të PBBN-së, atëherë sipas shënjestrimit të PBBN-së, asaj do t'i nevojitej për një kohë të caktuar në të ardhmen një rritje më e lartë se mesatarja, në mënyrë që t'i rikthehet ecurisë së mëparshme. Rasti i kundërt, domethënë nëse ekonomia rritet papritur me një normë rritjeje më të lartë se mesatarja, do të kërkonte gjithashtu një rregullim. Por, në këtë rast, kjo do të nënkuptonte një normë më të ulët rritjeje të PBBN-së. Ky kuadër do të përforconte faktin se "ngjarjet e kaluara nuk janë të harruara". Kjo do të thotë se dështimet e mëparshme për të arritur objektivin duhet të korrigjohen dhe kështu politika monetare bëhet "e varur nga historia". Një bankë qendrore e ndërton besueshmërinë e saj jo vetëm duke minimizuar devijimet nga objektivi në një periudhë të caktuar, por dhe duke minimizuar devijimet në të gjitha periudhat në total.

Matematikisht, kjo mund të shkruhet si:

$$x = \sum_{t=1}^{\infty}(Y_t - Y_t^*) \qquad 1$$

ku $x$ mat besueshmërinë e bankës qendrore, $Y_t$ përfaqëson PBB-në aktuale nominale dhe $Y_t^*$ objektivin optimal. Objektivi i bankës qendrore është që $x$ të jetë sa më afër zeros që të jetë e mundur. Termi brenda kllapave nuk është në katror apo i konsideruar në vlerë absolute, siç ndodh shpesh në ekuacionet ekonomike, saktësisht për të treguar se objektivi është që rritja nominale t'i rikthehet ecurisë së saj të mëparshme.

Përcaktimi i asaj që duhet të konsiderohet si një ecuri optimale e rritjes nominale debatohet mjaft nga ekonomistët. Për ekonomitë e zhvilluara, kjo ecuri duhet të jetë më e lehtë për t'u llogaritur. Duke qenë se këto vende janë në pararojë të zhvillimeve teknologjike apo në gjendje të qëndrueshme, ato nuk kanë të ngjarë që të përjetojnë periudha me normë të lartë rritjeje. Ato më së shumti kanë të ngjarë që të vijojnë të rriten në mënyrë të qëndrueshme, ashtu si dhe në të kaluarën e afërt. Objektivi i ecurisë optimale do të konsistonte në shumën e normës mesatare të rritjes dhe të normës optimale të inflacionit[6]. Duhet të jetë e lehtë që të kuptosh se kjo llogaritje do të ishte më problematike për vendet në zhvillim, por ne do t'i rikthehemi kësaj çështjeje më në thellësi kur të diskutojmë argumentet jo në favor të shënjestrimit të PBBN-së.

Për sa u përket instrumenteve dhe kuadrit operacional që mund të përdoren, përmenden ide të ndryshme. Disa nga mbështetësit më të hershëm të PBBN-së[7] kanë propozuar një treg i së ardhshmeve (*futures*) për PBBN-në, i ngjashëm me atë të letrave me vlerë të qeverisë. Propozime më ortodokse, si për shembull ai nga Woodford, kërkojnë përdorimin e vazhdueshëm të

[6] *Kjo sugjeron një nivel të objektivit optimal midis 4-5%. Kjo për shkak se, gjatë dekadave të fundit, ekonomitë e zhvilluara janë rritur zakonisht me 2-3%. Për të arritur nivelin e objektivit optimal, shtojmë një objektiv inflacioni prej rreth 2%.*

[7] *Këto propozime hasen zakonisht në sferën e blogjeve ekonomike. Blogu më i mirënjohur është ai i Scott Sumner www.themoneyillusion.com, i cili ka qenë në pararojë të argumentimit në favor të shënjestrimit të PBBN-së. Për më tepër informacion, referojuni seksionit të bibliografisë.*

normës bazë të interesit dhe një politikë të fuqishme të "lehtësimit sasior" atëherë kur normat e interesit janë në nivelin e poshtëm të zeros.

Ekzistojnë disa arsye të rëndësishme pse shënjestrimi i PBBN-së duhet të konsiderohet nga politika monetare. Pikënisja është sugjerimi që vjen nga teoria ekonomike se pritshmëritë janë të prirura që të jenë vetëpërmbushëse. Kjo nënkupton se nëse agjentët presin që ekonomia të rritet me një ritëm të caktuar, atëherë ata do të shpenzojnë dhe marrin hua në linjë me këtë pritshmëri. Kështu, pritshmëritë e tyre do të bëhen realitet dhe kjo do të rezultojë në një luhatshmëri më të ulët për ciklin e biznesit.

Në mënyrë të natyrshme, përqasja e PBBN-së përfaqëson një evoluim të traditës monetariste. Fillimisht, Milton Friedman supozonte që detyra e një banke qendrore është ruajtja e një ritmi konstant rritjeje të ofertës së parasë. Kjo është arsyeja pse ne sot përpiqemi që ta masim atë duke u bazuar në variabla të ndryshëm të njohur si agregatë monetarë. Friedman besonte se duke mbajtur një rritje konstante të ofertës së parasë, një bankë qendrore mund të luante rolin e saj të stabilizimit të ciklit të biznesit. Fatkeqësisht, këto variabla kanë mangësitë e tyre gjatë periudhave të recesionit, ku njerëzit kanë prirjen që të kursejnë më shumë se zakonisht dhe marrëdhënia midis agregatëve monetarë dhe rritjes shkëputet. Oferta e parasë mund të jetë konstante, por për shkak të një sasie më të madhe parash të kursyera, shpejtësia e qarkullimit të saj ka prirjen që të ulet. Shënjestrimi i PBBN-së mund të ndihmojë në tejkalimin e këtij problemi[8].

Prandaj, nën regjimin e shënjestrimit të PBBN-së, banka qendrore do t'i përgjigjej uljes së shpejtësisë duke rritur më tej ofertën e parasë, me qëllim kompensimin e saj (e kundërta vlen gjithashtu). Teksa gjatë periudhave të recesionit tendenca për të shpenzuar mund të pësojë rënie, nën regjimin e shënjestrimit të PBBN-së, banka qendrore do të garantonte që një gjë e tillë nuk ndodh dhe me sasinë e likuiditetit aktual në ekonomi. Një veçori e tillë do të çonte në më pak kredi të pashlyera, duke qenë se shumë prej kredive me probleme janë të varura nga gjendja e ekonomisë.

Gjithashtu, shënjestrimi i PBBN-së mund ta ndihmojë bankën qendrore që të përballojë më mirë goditjet reale (nga ana e ofertës). Një goditje negative nga ana e ofertës çon në rritjen e normës së inflacionit dhe në rënien e PBB-së gjithashtu. Norma rezultuese e inflacionit mund ta nxisë një vendimmarrës që të shtrëngojë politikën monetare kur nuk duhet. E kundërta është e vërtetë gjithashtu, kur një goditje pozitive mund ta nxisë një vendimmarrës që të zbatojë një politikë monetare më ekspansioniste sesa duhet. Duke kombinuar normën e inflacionit me normën e rritjes reale të PBB-së, vendimmarrja do të përmirësohej pavarësisht nga goditja në anën e ofertës. Është pikërisht për shkak të këtyre karakteristikave që shënjestrimi i PBBN-së shihet si një stabilizator më i mirë i ciklit të biznesit. Kjo ka të ngjarë që të çojë në më pak recesione.

[8] *Sipas Teorisë Sasiore të Parasë, MV=QP=Y, ku M është oferta e parasë gjerësisht e përkufizuar, V është shpejtësia e qarkullimit të parasë, Q është PBB-ja reale, P është niveli i çmimeve dhe Y është PBB-ja nominale. Sipas identitetit të mësipërm, shënjestrimi i PBB-së nominale do të ishte një mënyrë për të shënjestruar si ofertën e parasë, ashtu dhe shpejtësinë e qarkullimit të saj.*

Nga ana tjetër, ky regjim karakterizohet dhe nga disa mangësi të mundshme, të cilat shpesh nuk përmenden nga mbështetësit e tij. Pak më lart ne përmendëm shkurtimisht një nga mangësitë më të rëndësishme. Në rastin e një ekonomie në zhvillim, siç është Shqipëria, është e vështirë të zotërosh një matje të mirë të normës potenciale të rritjes.

Norma optimale e rritjes reale është e vështirë që të llogaritet për shkak të procesit të konvergjencës që përjetojnë vendet në zhvillim. Ato aktualisht karakterizohen nga norma më të larta të rritjes reale sesa vendet e zhvilluara, teksa hendeku i pasurisë mbyllet. Me kalimin e kohës, këto norma do të ngadalësohen. Teoria makroekonomike ofron dy skenarë të mundshëm lidhur me këtë proces. Skenari i parë është që vendet në zhvillim do t'i afrohen kufirit të teknologjisë dhe do të ulin mundësitë e tyre për rritje për shkak të procesit të përafrimit. Ky proces njihet ndryshe si konvergjenca e pakushtëzuar – në të cilin të gjitha vendet herët a vonë do të arrijnë të njëjtat nivele të të ardhurave. Skenari tjetër dhe më problematik është ai që njihet si konvergjenca e kushtëzuar. Ai supozon që niveli afatgjatë varet nga variabla të tjerë. Nëse supozojmë këtë lloj procesi ekonomik, është e mundur që rritja të ngadalësohet përpara se të arrihet kufiri i teknologjisë dhe nga ai moment të rritet me norma të qëndrueshme. Një zhvillim i tillë paraqet implikime të rëndësishme për shënjestrimin e PBBN-së. Rritja potenciale për vendet në zhvillim duhet të rillogaritet në mënyrë të vazhdueshme. Fatkeqësisht, siç e vumë re nga diskutimi lidhur me procesin e konvergjencës, llogaritja e PBB-së potenciale nuk është një shkencë ekzakte dhe ekziston mundësia për gjykime të pasakta. Për çdo kërkues shkencor është e vështirë që të identifikohet me saktësi jo vetëm norma aktuale potenciale por dhe ajo në periudhën afatgjatë[9]. Krahas kësaj, një objektiv i mirë është ai që komunikohet dhe kuptohet lehtë nga publiku. Ai duhet të jetë gjithashtu i qëndrueshëm, me qëllim orientimin e pritshmërive. Një objektiv që ndryshon në mënyrë të vazhdueshme, teksa rritja potenciale ndryshon për shkak të ekonomisë që i përafrohet gjendjes së qëndrueshme, nuk është aspak objektiv!

Kjo çon në një problem tjetër të mundshëm me shënjestrimin e PBBN-së – vështirësia në komunikim. Shënjestrimi i inflacionit gjente mbështetje për shkak të thjeshtësisë së tij për t'u komunikuar dhe zbatuar. Me arritjen e besueshmërisë, ai shpesh çon në pritshmëri të mirë-ankoruara. Nuk është e qartë nëse kjo do të vlente dhe për shënjestrimin e PBBN-së, i cili kërkon nga agjentët që të llogarisin në mënyrë të vazhdueshme normën e inflacionit dhe atë të rritjes reale. Kjo bëhet akoma dhe më e vështirë në rastin e një vendi në zhvillim siç është Shqipëria, ku siç përmendet dhe më lart, ecuria optimale mund të kërkojë rregullime të vazhdueshme. Në këtë rast, mund të jetë e vështirë për një bankë qendrore që ta komunikojë objektivin dhe për publikun që ta kuptojë apo ta presë atë që të arrihet. Për rrjedhojë, veçoria kryesore e shënjestrimit të PBBN-së, ajo e një ngjarjeje vetëpërmbushëse, mund të mos materializohet.

---

[9] *Kota (2007) sugjeron "një produkt potencial, i cili është i lidhur ngushtë me përmirësimet teknologjike, punësimin dhe stokun e kapitalit të vendit". Edhe nëse supozojmë saktësi të përsosur për të tashmen, nuk mund të jemi të sigurtë për ecurinë e ardhshme të këtyre tre variablave. Kështu, kjo e bën ecurinë e ardhshme të objektivit të PBBN-së problematike.*

Një problem i tretë dhe i fundit mund të jetë disponueshmëria e të dhënave brenda limitit të nevojshëm kohor. Siç përmendet dhe më lart, regjimi i shënjestrimit të PBBN-së mund të jetë më i përshtatshëm për përballimin e goditjeve nga ana e ofertës në krahasim me atë të shënjestrimit të inflacionit. Megjithatë, nuk është e lehtë që të kuptosh menjëherë nëse një goditje e caktuar është nga ana e ofertës apo e kërkesës. Të dhënat për PBB-në janë të disponueshme me një kohë vonesë[10] dhe shpesh subjekt korrigjimesh të mëvonshme. Të dhënat për inflacionin janë më shpejt të disponueshme. Kjo sugjeron se një bankë qendrore duhet të mbështetet në metodat e "vlerësimit afatshkurtër" (*nowcasting*) për PBB-në[11], të cilat gjithashtu nuk janë një shkencë ekzakte.

## III. RASTI I SHQIPËRISË

Duke pasur në mendje mohimet e mëparshme, tani do përqendrohemi tek rasti i Shqipërisë. Siç përmendet dhe më lart, Shqipëria është karakterizuar nga një periudhë me inflacion relativisht të ulët dhe të qëndrueshëm, por me norma të ulëta rritjeje. Këto janë rrethanat që në vende të tjera kanë krijuar dyshim mbi shënjestrimn e inflacionit dhe nëse ai përbën një regjim optimal për politikën monetare.

Me qëllim kryerjen e një analize përshkruese për ekonominë shqiptare, ky material përdor të dhëna të PBB-së nominale të marra nga INSTAT duke filluar nga viti 2000 deri në vitin 2010. Të dhënat e fundit janë llogaritur duke përdorur PBB-në reale dhe normën e inflacionit në vend të deflatorit të PBB-së. Së fundi, kemi përdorur shumën rrëshqitëse (*rolling sum*) të vlerave të PBB-së nominale për katër tremujorë, me qëllim rritjen e sasisë së të dhënave dhe rregullimin e efekteve sezonale.

Grafiku 1 përfaqëson ecurinë e PBB-së nominale në Shqipëri gjatë periudhës në shqyrtim, shprehur në milionë lekë në boshtin vertikal. Duke filluar nga fillimi i vitit 2009, vihet re një ngadalësim i rritjes së PBBN-së. Me qëllim ofrimin e një tabloje më të qartë të procesit, të dhënave përpara fillimit të periudhës së ngadalësimit iu është përshtatur një linjë prirjeje[12]. Si për këtë grafik po dhe analizat në vazhdim, një pikë ndërprerjeje e ndryshme nuk ndryshon përfundimet në mënyrë të konsiderueshme.

Shihet se rritja e PBB-së nominale pas vitit 2009 e zvogëloi hendekun për një periudhë shumë të shkurtër në fund të vitit 2010, por më pas iu rikthye ecurisë me rritje më të ulët. Duke përdorur pikat e të dhënave më të fundit, rezulton një hendek prej rreth 90 miliardë lekë, ose afërsisht 8%, midis tendencës së ecurisë së mëparshme dhe asaj së rritjes aktuale të PBBN-së.

---

[10] *Të dhënat për PBB-në në Shqipëri publikohen nga INSTAT (www.instat.gov.al) me një kohë vonesë prej deri në dy vjet. Normat mujore të inflacionit janë të disponueshme brenda një javë duke filluar nga fundi i muajit.*

[11] *Mancellari (2010) dhe Boka etj. (2010) kanë kryer studime mbi "vlerësimin afatshkurtër" për Shqipërinë.*

[12] *Trendi është eksponencial pasi kemi të bëjmë me të dhëna në nivele dhe jo me logaritme apo me ndryshime në përqindje.*

Grafik 1. PBB nominale.




Burimi: INSTAT dhe llogaritjet e autorit.

Për shkak të përdorimit të të dhënave në nivel në grafikun 1, trendi linear nuk ishte i justifikuar. Me qëllim korrigjimin e kësaj mangësie të mundshme, në grafikun 2 paraqesim të njëjtat të dhëna, por tashmë si ndryshim në përqindje. Ky është një skenar ku përdorimi i trendit linear është i justifikuar matematikisht.

Në grafikun 2, ndjekim të njëjtën procedurë të përshtatjes së prirjes tek të dhënat për periudhën deri në vitin 2009, dhe më pas e krahasojmë me zhvillimet më të fundit. Sërish vërejmë se që nga momenti i fillimit të ngadalësimit, PBBN-ja shënoi rritje të ngjashme me ecurinë e mëparshme vetëm për pak kohë. Të gjitha pikat e tjera të të dhënave qëndrojnë bindshëm nën prirjen e mëparshme.

Pavarësisht nga fakti nëse përdorim të dhëna në nivel apo të dhëna si ndryshim në përqindje, sipas objektivit hipotetik të PBBN-së, vërejmë shfaqjen e një hendeku. Nëse iu kthehemi të dhënave, periudha midis viteve 2000-2008 karakterizohej nga një rritje relativisht e lartë e PBBN-së, afërsisht rreth 10%. Kjo sugjeron një normë inflacioni prej 3-3.5% dhe një normë optimale rritjeje prej 6-6.5%. Që nga periudha e ngadalësimit[13], PBBN-ja është rritur me një normë mesatare prej gati 6%, me një ndarje të barabartë midis inflacionit dhe rritjes.

Grafik 2. Norma e rritjes së PBB nominale.




Burimi: INSTAT dhe llogaritjet e autorit.

Nëse do të ndiqnim një objektiv strikt të PBBN-së, rezultatet e mësipërme sugjerojnë se për të kompensuar humbjen e rritjes së PBB-së reale, do të na ishte dashur një normë inflacioni shumë më e lartë. Në fakt, për të ruajtur objektivin e mëparshëm, normës së inflacionit i duhet që të dyfishohet ose të rritet edhe më tej. Duhet të pyesim veten nëse një normë inflacioni prej 6-7% do të ishte me të vërtetë optimale.

Inflacioni ka qenë një nga sukseset makroekonomike të Shqipërisë gjatë dekadës së fundit. Grafiku 3 paraqet ecurinë e normës së inflacionit gjatë kësaj periudhe. Pasi u përball me disa goditje në fillim të viteve 2000, inflacioni në Shqipëri ka qenë tejet i qëndrueshëm duke filluar nga viti 2003. Ai është luhatur rreth objektivit 3 +/-1% të vendosur nga Banka e Shqipërisë.

Këtë sjellje mund ta shqyrtojmë më në hollësi në tabelën 1, ku paraqiten normat mesatare të inflacionit dhe devijimi standard. Sërish shfaqet një ecuri e pakundërshtueshme. Jo vetëm që normat mesatare janë afër objektivit, por dhe vlerat e devijimit standard konfirmojnë se luhatshmëria

[13] *Sërish, një pikë ndërprerjeje specifike prej +/- 2 tremujorë nuk e ndryshon analizën tonë.*

e këtij variabli ka qenë mjaft e ulët gjithashtu. Sipas kësaj analize, Banka e Shqipërisë e ka përmbushur detyrën e përcaktuar me ligj[14]. Kjo do të thotë që ajo nuk duhet të përpiqet që ta ulë hendekun e PBB-së reale apo nominale që përmendëm më lart, pasi në këtë mënyrë do të dilte jashtë mandatit të saj aktual.

Por ky proces ka dhe një qëllim tjetër. Shënjestrimi i PBBN-së do të ndërpriste stabilitetin e përmendur më lart. Ekonomistët u përpoqën që t'i eliminonin këto norma hipotetikisht të larta të inflacionit në vitet '80 dhe sigurisht që do të shqetësoheshin nëse do t'i shikonin sërish të materializuara.

Grafik 3. Inflacioni në Shqipëri.




Burimi: INSTAT dhe llogaritjet e autorit.

*Tabelë 1. Statistika përshkruese të inflacionit*

| Viti | Mesatarja | Devijimi Standard | Viti | Mesatarja | Devijimi Standard |
|---|---|---|---|---|---|
| 2000 | 0,52% | 1,84% | 2007 | 2,94% | 1,00% |
| 2001 | 3,13% | 1,14% | 2008 | 3,36% | 0,85% |
| 2002 | 5,22% | 1,73% | 2009 | 2,28% | 0,58% |
| 2003 | 2,37% | 1,03% | 2010 | 3,55% | 0,54% |
| 2004 | 2,87% | 0,76% | 2011 | 3,45% | 0,81% |
| 2005 | 2,37% | 0,71% | 2012 | 1,95% | 0,75% |
| 2006 | 2,38% | 0,66% | | | |
| Total | 2,77% | 1,5% | | | |

*Burimi: Llogaritjet e autorit.*

Për të arritur në një rekomandim përfundimtar lidhur me zbatueshmërinë e shënjestrimit të PBBN-së në Shqipëri, na duhet t'i kthehemi një nga shqetësimeve kryesore të përmendura më lart: PBB-së potenciale dhe ecurisë së rritjes së saj. Të dhënat e fundit sugjerojnë se megjithëse rritja ekonomike në Shqipëri është ngadalësuar, ndryshe nga vendet e tjera, këtu nuk bëhet fjalë për një periudhë të zgjatur recesioni. Shqipëria ka vijuar të shënojë rritje reale pozitive edhe gjatë kësaj periudhe. Për momentin nuk mund të jemi të sigurtë se si kjo rritje lidhet me potencialin e saj. Mund të ndodhë që të kemi ngadalësim të PBB-së sonë potenciale pas një periudhe të karakterizuar nga një rritje ekonomike relativisht të lartë. Konvergjenca e kushtëzuar do të sugjeronte që kjo është plotësisht e mundur.

Nëse PBB-ja potenciale do të ngadalësohej, përpjekja për të krijuar inflacion mund të kishte pasoja të rënda për ekonominë. Një gjë e tillë mund të krijonte flluska të paqëndrueshme, të cilat mund të shkaktojnë dëme të mëtejshme në të ardhmen. Ne gjithashtu do të humbnim besueshmërinë e fituar të inflacionit, e cili ka kontribuuar në arritjen e një suksesi të madh në politikën makroekonomike të Shqipërisë.

[14] *Në bazë të ligjit aktual, Banka e Shqipërisë është e mandatuar të ruajë stabilitetin e çmimeve. Ky mandat ndryshon nga disa banka të tjera qendrore, si për shembull Rezerva Federale apo Banka e Anglisë, të cilat kanë një "mandat të dyfishtë": nxitjen e stabilitetit të çmimeve por edhe të prodhimit ose punësimit maksimal të qëndrueshëm.*

Vështirësia në njohjen e saktë se cila duhet të jetë ecuria e objektivit tonë optimal të PBBN-së e bën komunikimin të vështirë gjithashtu. Nëse agjentët ekonomikë janë të pasigurtë për pritshmëritë e tyre, atëherë rreziku në treg rritet e për rrjedhojë, me këtë objektiv të ri, rritja ekonomike në periudhën afatgjatë do të ulet, në vend që të rritet.

## IV. PËRFUNDIME

Ky material bën një paraqitje të shkurtër të asaj që shënjestrimi i PBBN-së, një nga regjimet e reja që po diskutohen për politikën monetare, do të sillte për Shqipërinë. Nëse ne do të zbatonim këtë regjim, politikës monetare do t'i duhej që të projektonte një normë inflacioni shumë më të lartë, me qëllim ngushtimin e hendekut që është krijuar duke filluar nga viti 2009. Megjithatë, shënjestrimi i PBBN-së mbart rrezik të konsiderueshëm për ekonominë shqiptare. Vështirësia në njohjen e saktë të ecurisë së rritjes potenciale e bën zbatimin e këtij regjimi të vështirë për rastin tonë.

Kjo sugjeron se kërkimet në të ardhmen mund të përqendrohen në dy fusha. Fusha e parë është testimi i mëtejshëm i matjeve të PBB-së potenciale, me qëllim arritjen e një niveli të lartë sigurie lidhur jo vetëm me nivelin e saj aktual por, çfarë është më e rëndësishmja, dhe me ecurinë e saj në të ardhmen. "Vlerësimi afatshkurtër" i PBB-së mund të luajë gjithashtu rol në orientimin e vendimmarrjes gjatë periudhave të ngadalësimit ekonomik. Fusha e dytë është kryerja e hulumtimeve lidhur me objektiva mundësisht më të mirë. Duke qenë se regjimi i shënjestrimit të inflacionit po shqyrtohet në hollësi, nuk ka dyshim se do të sugjerohen objektiva të rinj. Pjesa më e madhe e tyre përpiqen të arrijnë stabilitetin si të ekonomisë reale ashtu dhe të inflacionit. Objektiva të mundshëm "hibridë", të cilët u japin variablave të ndryshëm një peshë të caktuar, mund të jenë një mënyrë për të mos hequr dorë nga stabiliteti i inflacionit i arritur me aq vështirësi, por dhe për të qenë vigjilentë lidhur me zhvillimet në ekonominë reale.

Si përfundim, është e dobishme që bankat qendrore të ndjekin zhvillimet më të fundit në teorinë dhe politikën monetare. Shënjestrimi i PBBN-së përfaqëson një zhvillim që mund të prodhojë rezultate pozitive brenda një tërësie të caktuar rrethanash. Megjithatë, nisur nga disponueshmëria e të dhënave dhe e informacioneve për momentin, si dhe të faktit se Shqipëria është një vend në zhvillim, është e vështirë që të pohohet me siguri se aktualisht shënjestrimi i PBBN-së përfaqëson një përmirësim të konsiderueshëm të kuadrit tonë të tanishëm.

## BIBLIOGRAFI


1. Blanchard, O. Dell' Ariccia, G. Mauro, P. 2010. Rethinking Macroeconomic Policy. IMF Staff Positions Note. SPN/10/03

2. Boka, M. Çeliku, E. Kristo, E. 2010. "Modelimi i PBB-së tremujore - Roli i treguesve ekonomikë dhe atyre të vrojtimeve". Material Diskutimi i Bankës së Shqipërisë.

3. Christensen, L. 2011. "The Second Monetarist Counter-revolution". http://marketmonetarist.com/

4. Economist, The. 2011 "Changing the target: Should the FED target nominal GDP" http://www.economist.com/node/21526886

5. Fullani, A. 2007. "Evoluimi dhe adoptimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë: Nga e kaluara drejt vizionit për të ardhmen dhe nevoja për të qenë pararendës". Strategjitë e Politikës Monetare për Ekonomitë e Vogla. Publikim i Bankës së Shqipërisë.

6. Koenig, E.F. 2012 "All in the Family: The Close Connection Between Nominal GDP Targeting and the Taylor Rule. Federal Reserve Bank of Dallas Staff Papers.

7. Kota, V. 2007. "Metoda alternative të matjes së produktit potencial në Shqipëri". Material Diskutimi i Bankës së Shqipërisë.

8. Mançellari, A. 2010. "Vlerësimi afatshkurtër (nowcasting) i PBB-së tremujore në Shqipëri". Material Diskutimi i Bankës së Shqipërisë.

9. McCallum, B. Nelson E. 2004. "Targeting vs. Instrumental Rules for Monetary Policy". NBER Working Paper No. 10612

10. NGDP Resources. www.ngdp.info

11. Romer, C. 2011. "Ben Bernanke needs a Volcker moment". New York Times

12. Sumner, S. 2011. "The Case for NGDP Targeting: Lessons from the Great Recession". Adam Smith Research Trust.

13. Sumner, S. 2009. "Misdiagnosing the crisis: the real problem was not real, it was nominal". www.voxeu.org

14. Sumner, S. "The Money Illusion" www.themoneyillusion.com

15. Svensson, L. 2000. "The zero bound in an open economy: a foolproof way of escaping from a liquidity trap." CEPR Discussion paper 2566

16. Woodford, M. 2012. Methods of Policy Accomodation at the Interes-Rate Lower Bound. Jackson Hole Symposium Discussion Paper. http://kansascityfed.org/publicat/sympos/2012/mw.pdf?sm=jh083112-4

# BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR,

# KORRIK-DHJETOR 2012

*Tryezë diskutimi me sistemin bankar*

Në kuadër të projektit të binjakëzimit, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën e Italisë, në datën 4 korrik 2012, organizoi një tryezë diskutimi me sistemin bankar me temë: "Për një sistem bankar të shëndetshëm dhe eficient në Shqipëri. Veprimtaritë dhe rezultatet e arritura në kuadrin e Projektit të Binjakëzimit".

Gjatë fjalës së mbajtur me këtë rast, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani vlerësoi ndihmën dhe partneritetin e dhënë nga Banka Kombëtare e Italisë dhe nga Banka Kombëtare e Francës, gjatë projektit të binjakëzimit. Në sajë të realizimit të këtij projekti, Banka e Shqipërisë ka përmirësuar kuadrin organizativ dhe atë operacional të departamenteve të saj kryesore, duke iu afruar kështu simotrave të saj evropiane.

*Përfundon projekti i Bashkimit Evropian për përafrimin e Bankës së Shqipërisë me Bankat Kombëtare të Vendeve Anëtare të BE-së*

Në datë 16 korrik 2012, u zhvillua ceremonia e përfundimit të projektit të binjakëzimit mes Bankës së Shqipërisë dhe bankave kombëtare të Italisë dhe Francës. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Ardian Fullani, z.Ettore Sequi, Shefi i delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, z.Franco Passacantando, Drejtor Ekzekutiv në Bankën Kombëtare të Italisë, dhe drejtuesi i projektit të binjakëzimit, z.Bruno Phillipe Jeudy, përfaqësues i Bankës Kombëtare të Francës, z. Rocco Schiavone, Këshilltar i përhershëm për projektin, drejtues të sektorit bankar në vend, si dhe përfaqësues nga komuniteti i biznesit etj.

Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, Banka e Shqipërisë ka përforcuar kapacitetet e saj në fusha të rëndësishme të veprimtarisë së saj si: mbikëqyrja, stabiliteti financiar, koordinimi i procesit të integrimit, edukimit financiar, sistemit të pagesave, statistikat si dhe zhvillimi i tregut ndërbankar.

Projekti i binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë u financua nga Bashkimi Evropian me një shumë prej 1 milionë eurosh. Projekti nisi të zbatohet në nëntor të vitit 2010 dhe përfundoi në korrik të vitit 2012, me një kohëzgjatje prej 20 muajsh.

*Ekspozita e Bankës së Shqipërisë "100 vjet Pavarësi: Pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare"*

Shqipëria kremtoi këtë vit 100-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së saj. Në kuadër të këtij viti jubilar, Banka e Shqipërisë organizoi ekspozitën lëvizëse me temë "100 vjet Pavarësi: Pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare", e cila u zhvillua në Tiranë, në datë 25 tetor 2012, në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar.

Në këtë ekspozitë u shpalosën koleksione të monedhave dhe kartëmonedhave që i përkasin periudhave të ndryshme historike të vendit. Ndryshimet historike që ka kaluar shteti shqiptar janë reflektuar në simbolet e monedhave dhe kartëmonedhave, duke bërë kështu që monedha kombëtare të vlerësohet jo vetëm për vlerën e saj monetare, por edhe për vlerën historike që ajo mbart.

Gjatë kësaj ekspozite, u prezantua edhe seria e monedhave përkujtimore me tematikë "100 vjetori i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë", që Banka e Shqipërisë ka emetuar me këtë rast. Në kuadër të kësaj ngjarjeje të shënuar të historisë së vendit, është shtypur dhe Medalioni i Bankës së Shqipërisë "100 vjetori i Shpalljes së Pavarësisë". Medalioni paraqet një stilizim të shqiponjës dykrenore, në krahët e së cilës valëvitet flamuri shqiptar që mban të shkruar vitet 1912-2012.

Kjo ishte ekspozita e gjashtë që Banka e Shqipërisë organizoi në kuadër të festimeve të 100 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. Ekspozita e parë u zhvillua në qytetin e Beratit, për të vijuar më pas në qytetin e Gjirokastrës, Korçës, Elbasanit e Shkodrës.

*Inaugurohet ndërtesa e re e Qendrës së Emisionit të Monedhës*

Në kuadër të përmirësimit të standardeve infrastrukturore dhe teknologjike, në datën 26 tetor 2012, Banka e Shqipërisë zhvilloi ceremoninë e inagurimit të Qendrës së Emisionit të Monedhës.

Në këtë ceremoni merrnin pjesë guvernatorë dhe përfaqësues të lartë të bankave qendrore të rajonit e më gjerë, si dhe të institucioneve financiare brenda e jashtë Shqipërisë. Prerja e shiritit u krye nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, dhe Ministri i Financave, z. Ridvan Bode.

Kjo ceremoni shënoi përfundimin e një prej tre projekteve madhore ndërtimore të Bankës së Shqipërisë, të ndërmarra në këto tre vitet e fundit.

Ndërtesa e Qendrës së Emisionit të Monedhës është ndërtuar në frymën e një arkitekture moderne, ku spikasin dy skajet rrethore të saj të cilat simbolizojnë monedhën.

Ajo karakterizohet nga një nivel i lartë infrastrukture dhe është e pajisur me sisteme teknologjie të përparuara që do të përdoren për përpunimin e parasë. Duke shfrytëzuar lehtësirat e ofruara nga ndërtesa e re, ky proces do të kryhet me sisteme të automatizuar të shpejtësisë së lartë, duke garantuar kontroll të shpejtë të monedhës përsa i përket autenticitetit, gjendjes fizike dhe sigurisë së saj.

Me përfundimin e kësaj ndërtese të re, përpunimi i monedhave dhe kartëmonedhave në Bankën e Shqipërisë do të kryhet sipas standardeve të simotrave evropiane.

*Mbi zhvillimin e Konferencës së 10-të Ndërkombëtare me temë: "Politika monetare nga e shkuara në të ardhmen"*

Në datën 26 tetor 2012, Banka e Shqipërisë organizoi Konferencën e 10-të Ndërkombëtare me temë "Politika monetare nga e shkuara në të ardhmen", e cila këtë vit përkoi me festimin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Fjala e hapjes u mbajt nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, ndërkohë që punimet e kësaj konference u përshëndetën dhe nga Kryeministri i vendit z. Sali Berisha.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin guvernatorë të bankave qendrore: z.Kemal Kozaric, Guvernator i Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës, z.Grigory Marchenko, Guvernator i Bankës Kombëtare të Republikës së Kazakistanit, z.Gani Gërguri, Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, z.Dimitar Bogov, Guvernatori i Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë, z. Dorin Dragutanu, Guvernator i Bankës Kombëtare të Moldavisë si dhe z. Radoje Zugic, Guvernator i Bankës Qendrore të Malit të Zi, si dhe përfaqësues të lartë të bankave qendrore të Azerbajxhanit, Belgjikës, Çekisë dhe Italisë.

Gjithashtu në këtë konferencë merrnin pjesë dhe drejtues të bankave të nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri, përfaqësues nga bota akademike ekonomike dhe financiare, përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Shqipëri, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare financiare, si dhe shumë personalitete të tjera të vendit dhe të huaja.

*Mbi aktivitetin e zhvilluar në shkollën e mesme të përgjithshme "Partizani"*

Edhe këtë vit, Banka e Shqipërisë ka ofruar për gjimnazistët modulin me zgjedhje të lirë "Financat personale në duart tuaja", i cili është një nga lëndët me zgjedhje të lirë të kurrikulës mësimore të arsimit të mesëm, për vitin shkollor 2012-2013. Kjo lëndë është përzgjedhur nga 10 mijë gjimnazistë në gjithë vendin, për të cilët libri ofrohet falas nga Banka e Shqipërisë.

Këtë vit, Shoqata Shqiptare e Bankave në kuadër të një bashkëpunimi të nisur me Bankën e Shqipërisë mundësoi printimin e 4.000 kopjeve të modulit "Financat personale në duar tuaja". Gjithashtu, Shoqata Shqiptare e Bankave mundësoi zhvillimin e orëve praktike të nxënësve të shkollave të mesme që do të ndjekin modulin në degët e bankave tregtare në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit.

Me këtë rast, në datën 30 tetor 2012, u zhvillua një takim prezantues në ambientet e gjimnazit "Partizani", si një ndër gjimnazet që ka shënuar numrin më të lartë të zgjedhjes së këtij moduli. Të pranishëm kanë qenë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Ardian Fullani dhe kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave, z.Seyhan Pencabligil.

Gjatë këtij takimi, Guvernatori Fullani theksoi rëndësinë që mbart edukimi financiar i publikut, duke e konsideruar atë si një shtyllë të tretë të Bankës së Shqipërisë, po aq të rëndësishme si ajo e politikës monetare dhe e ruajtjes së stabilitetit financiar.

Teksti i modulit "Financat personale në duart tuaja", është hartuar gjatë vitit 2010 nga Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe mësues të lëndës së ekonomisë me qëllim përfshirjen për herë të parë në kurrikulën e arsimit të mesëm të vendit. Nëpërmjet këtij teksti, i cili është shkruar me një gjuhë dhe didaktikë të përshtatshme, nxënësit mund të mësojnë mbi administrimin e drejtë të parasë dhe produktet e ndryshme financiare, sjelljen konsumatore dhe rëndësinë e planifikimit financiar për mirëqenien e secilit dhe sistemin financiar në përgjithësi.

Duke filluar nga viti 2011, ky libër është shpërndarë dhe vazhdon të shpërndahet pa pagesë prej Bankës së Shqipërisë në të gjithë gjimnazet e vendit që kanë përzgjedhur këtë lëndë.

*Takimi i gjashtë rajonal: "Kërkimet ekonomike në Evropën Juglindore"*

Departamenti i Kërkimeve organizoi në datat 19-20 nëntor 2012, takimin e gjashtë rajonal të Kërkimeve për Evropën Juglindore. Në të morën pjesë mbi 20 përfaqësues nga Banka e Shqipërisë dhe bankat qendrore të rajonit, ku përmendim: Bankën e Italisë, Bankën e Kroacisë, Bankën e Maqedonisë, Bankën e Kosovës, Bankën e Turqisë etj. Në vazhdën e një tradite të konsoliduar, qëllimi i këtij takimi ishte zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërmjet kërkuesve, jo vetëm në këndvështrimin rajonal por edhe më gjerë. Tematikat e trajtuara në këtë takim mbuluan një gamë të gjerë çështjesh dhe problematikash kryesisht mbi; politikat fiskale dhe monetare në një kuadër ekonomik të paqëndrueshëm, krizën globale dhe mekanizmat e transmisionit, identifikimin e çekuilibrave në sistemet bankare, vlerësimin e densiteteve në seritë e të dhënave ekonomike etj.

*Ekspozita lëvizëse e Bankës së Shqipërisë në kuadër të festimeve për 100-vjetorin e Pavarësisë ndal udhëtimin e saj në Prishtinë*

Në vigjilje të 100-vjetorit të Pavarësisë, ekspozita lëvizëse e Bankës së Shqipërisë "100 vjet Pavarësi: Pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare" ndali udhëtimin e saj në datë 23 nëntor 2012, në Prishtinë, në ambientet e Muzeut Kombëtar. Kjo ishte hera e parë që Banka e Shqipërisë organizon një ekspozitë numizmatike jashtë vendit.

Ekspozita vjen në qytetin e Prishtinës si një nderim për të gjithë ata rilindës e patriotë shqiptarë që dhanë kontributin e tyre në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Ekspozita bashkë me historinë e monedhës dhe të kartëmonedhës shqiptare, synon të sjellë për publikun edhe zhvillimin e bankës qendrore në Shqipëri, e cila zë fill pas Pavarësisë me përpjekjet e Ismail Qemalit për krijimin e saj nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje me grupe financiare austro-hungareze dhe italiane.

Në ceremoninë e mbajtur me këtë rast, morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, z.Gani Gërguri, Zv.Ministri i Kulturës, z.Hajdin Abazi, dhe shumë personalitete të tjera kosovare.

Me këtë rast Guvernatori Gërguri, Zv. Ministri Abazi dhe Guvernatori Fullani mbajtën një fjalë përshëndetëse për të pranishmit.

Në ekspozitë, përveç koleksionit numizmatik, publiku i gjerë pati mundësinë të shikojë nga afër edhe serinë e monedhave përkujtimore që Banka e Shqipërisë ka emetuar me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. Udhëtimi në Prishtinë ishte ndalesa e tetë e ekspozitës lëvizëse, ndërkohë që ajo është organizuar edhe në shtatë qytete të ndryshme të Shqipërisë, si në qytetet e: Beratit, Gjirokastrës, Korçës, Elbasanit, Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës.

*Mbi takimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, me gazetarë, analistë dhe drejtues të mediave*

Në datën 18 dhjetor 2012, me rastin e mbylljes së vitit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani zhvilloi një takim me publicistë të njohur, analistë të politikës dhe të ekonomisë, gazetarë të njohur të shtypit të shkruar dhe medias elektronike. Organizimi i këtij takimi është kthyer tashmë në një traditë për Bankën e Shqipërisë.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, Guvernatori Fullani, iu përcolli të pranishmëve urimet për një vit të ri të mbarë për ta dhe familjet e tyre. Ai vlerësoi punën e bërë nga media për transmetimin në kohë reale të mesazheve mbi vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë tek publiku, si dhe vlerësoi analizat e komentet e bëra në këtë drejtim. Guvernatori bëri edhe një ekspoze të ekonomisë shqiptare, duke e cilësuar vitin 2012, si një vit të ngarkuar me ngjarje ekonomike, ku vuri në dukje dhe masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për ruajtjen dhe garantimin e stabilitetit makroekonomik të vendit, si dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të sistemit bankar.

Në këtë takim, z.Fullani prezantoi dhe kalendarin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2013, i cili trajton momentet kyçe të zhvillimit historik të bankës qendrore në Shqipëri, duke filluar me vitin 1913 i cili shënon krijimin e Bankës Kombëtare të Shqypërisë e deri në ditët e sotme kur Banka e Shqipërisë gëzon atributet e një banke qendrore moderne, të pavarur, transparente dhe të përgjegjshme. Nga ana artistike, kalendari prezanton vizatime të shkëputura nga kartëmonedhat shqiptare të emetuara ndër vite si dhe dy vizatimet e ndërtesave (ndërtesa e parë në Durrës dhe projekti i rikonstruksionit), për të sjellë rrugëtimin historik të bankës qendrore.

Edhe gjatë këtij viti, Banka e Shqipërisë ka vazhduar strategjinë e saj të edukimit financiar të publikut. Guvernatori u shpreh se gjatë viteve në vijim, Banka e Shqipërisë do të vijojë të jetë e angazhuar në edukimin financiar të të rinjve. Si pjesë e kësaj strategjie, Guvernatori Fullani, shpalli edhe fituesit e konkursit "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë", për vitin 2012.

*Seminari i së Premtes*

Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë organizon dy herë në muaj të ashtuquajturin "Seminari i së Premtes". Kjo iniciativë fton nëpunësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare, kërkimore dhe shkencore, të prezantojnë dhe të diskutojnë materialet e tyre kërkimore teorike dhe empirike.

Gjatë 6-mujorit të dytë të 2012, në serinë e “Seminareve të së Premtes”, janë prezantuar 5 punime nga punonjësit e Bankës së Shqipërisë. Tematika e materialeve të prezantuara në aktivitetin kërkimor "Seminaret e së Premtes", gjatë periudhës korrik-dhjetor të vitit 2012, kanë të bëjnë kryesisht me kreditimin dhe përcaktuesit e tyre kryesorë, perceptimet e bizneseve ndaj instrumenteve të pagesës, elasticitetin e të ardhurave dhe çmimeve, ndikimin e krizës greke etj. Në rubrikën më poshtë do të gjeni një përmbledhje më të detajuar të këtyre materialeve.

Seminari i së Premtes për 6-mujorin e dytë të vitit 2012, u hap me një punim të Gerti Shijakut dhe Irini Kalluci nga Departamenti i Mbikëqyrjes me temë: "Përcaktuesit e kredisë bankare për sektorin privat-rasti i Shqipërisë". Ky material fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e përcaktuesve afatgjatë të kredisë së bankave për sektorin privat në rastin e Shqipërisë, duke përdorur një Mekanizëm të Vektorit të Korrigjimit të Gabimit (VECM), bazuar në tregues të kërkesës dhe ofertës. Studimi fokusohet në të dhëna tremujore përgjatë periudhës 2001-2011. Rezultatet tregojnë se ekziston një mekanizëm korrigjimi që e kthen kreditimin drejt nivelit ekuilibër, si dhe një lidhje pozitive mes kreditimit dhe rritjes ekonomike.

Prezantimi tjetër i mbajtur në këtë seminar ishte ai me temë: "Raport i anketimit mbi përdorimin e instrumenteve të pagesës-biznesit, shkurt-mars 2012", nga Kliti Ceca, Alban Pllaha, nga Departamenti i Kërkimeve dhe Valentina Semi nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave. Ky anketim synon identifikimin e karakteristikave të bizneseve, të cilat ndikojnë pozitivisht ose negativisht në përdorimin e instrumentave të pagesave nga ana e tyre. Anketimi u mundësua nga Banka e Shqipërisë, u konceptua dhe u përpunua nga Departamenti i Kërkimeve, mbështetur nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe nga Departamenti i Statistikës si dhe u realizua në terren nga INSTAT. Anketimi mbulon zonën Tiranë–Durrës dhe iu drejtua gjithsej 400 bizneseve, ku gjysma e tyre pranojnë pagesa nëpërmjet instrumenteve bankare jo-*cash* dhe gjysma tjetër nuk pranojnë pagesa me instrumente të tilla.

Një material tjetër i prezantuar në serinë e "Seminareve të së Premtes" është ai me temë: "Efektiviteti i taksës daneze me bazë peshë mbi produktet e paketimit: Rasti i paketimeve prej letre dhe kartoni", nga Enian Çela nga Departamenti i Kërkimeve. Qëllimi i këtij artikulli është analizimi i efektivitetit të taksimit mjedisor zbatuar mbi produktet e paketimit prej letre dhe kartoni në rastin e Danimarkës. Përmes një analize ekonometrike me të dhëna në panel, analiza përqendrohet mbi ndikimin e taksimit në importet e produkteve në fjalë. Modeli gravitacional i regresionit përfshin importet në vlerë si variabël të varur, ndërkohë që ndikimi i taksimit përfaqësohet nëpërmjet një variabli binar mes variablave shpjegues. Rezultatet tregojnë se taksimi ka qenë efektiv në pakësimin e kërkesës për importe të produkteve në fjalë. Arsyet se përse një gjë e tillë ka ndodhur theksohen në funksion të zbatimeve të ardhshme të kësaj politike për këto produkte.

"Roli i kursit të këmbimit në modelet e tregtisë ndërkombëtare: A qëndron kushti M-L në Shqipëri?", nga Bledar Hoda nga Departamenti i Kërkimeve ishte materiali i radhës i prezantuar në serinë e "Seminareve të së Premtes". Materiali ka për qëllim vlerësimin e masës së transmetimit të aktivitetit real nga vendet partnere tregtare. Ngadalësimi ekonomik i vendeve të avancuara së fundmi është kthyer në një shqetësim për ritmet ekonomike edhe të vendeve në zhvillim. Një interes të veçantë ka roli i eksporteve, si promotor alternativ i rritjes ekonomike si dhe vlerësimi i kushtit Marshall-Lerner në rastin e një ekonomie në zhvillim me eksporte më të ulëta se importet. Kjo e fundit vlerëson efektivitetin e kursit të këmbimit në rritjen e prurjeve monetare nga tregtia e jashtme dhe përmirësimin e balancës së jashtme të një ekonomie nëpërmjet

matjes së elasticitetit të flukseve tregtare reale. Rezultatet tregojnë se ndërsa rritja e të ardhurave për frymë është nxitësi kryesor i flukseve tregtare, kursi i këmbimit luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e ritmeve të eksporteve dhe zëvendësimit të importeve.

Materiali përmbyllës i serive të "Seminarit të së Premtes" për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012 ishte ai me temë: "Kriza ekonomike e Greqisë dhe impakti i saj në Shqipëri", nga Enkela Gaçaj, nga Departamenti i Kërkimeve. Ky studim ka si qëllim kryesor evidentimin e shkaqeve të krizës ekonomike të Greqisë përtej etiketimit të saj si krizë e borxhit. Ai analizon kanalet kryesore si: shpenzimet e mëdha qeveritare, evazionin fiskal, praninë e ekonomisë informale (e cila përbën rreth 25% të PBB-së) dhe korrupsionin, si plagët kryesore të ekonomisë së Greqisë. Gjithashtu, ky studim fokusohet në propozimin e disa zgjidhjeve si: reformimi institucional të sistemit gjyqësor dhe fiskal; dhe shkurtimi i administratës publike, duke theksuar nevojën e ndërthurjes së politikave fiskale me ato të rritjes në mënyrë që të mundësohet dalja nga rrethi vicioz i deficiteve buxhetore dhe recesionit.

# VENDIME TË POLITIKËS MONETARE

25 korrik 2012

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të ulë me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interest, në 4.00%.

28 gusht, 26 shtator, 31 tetor, 27 nëntor, 20 dhjetor 2012

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interest në 4.00%.

# NGJARJET JURIDIKE, GJASHTËMUJORI II 2012

## POLITIKA MONETARE

Në datën 25.07.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 46 "Deklaratën e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012". Në deklaratë vlerësohet se ekonomia shqiptare ka vijuar të ruajë parametrat e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të saj gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Inflacioni i çmimeve të konsumit, treguesit e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik, bilanci i pagesave dhe gjendja financiare e sistemit bankar rezultuan të qëndrueshme apo në përmirësim. Gjatë kësaj periudhe, ekonomia shqiptare është përballur me disa goditje të ofertës dhe me një kërkesë të ngadaltë të brendshme e të huaj. Këto zhvillime ndikuan në rënien e PBB-së gjatë tremujorit të parë të vitit dhe njëkohësisht vështirësuan veprimin e politikave stabilizuese mbi kërkesën agregate. Me uljen e pritur të tensioneve në pjesën e mbetur të vitit, ekonomia shqiptare pritet të regjistrojë norma pozitive rritjeje. Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 1.9% në tremujorin e dytë të vitit, duke u rritur me 0.8 pikë përqindje kundrejt tremujorit të parë. Zhvillimet e pritshme brenda dhe jashtë vendit janë tregues për një rritje të ngadaltë të çmimeve të konsumit në të ardhmen.

Në datën 25.07.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 47 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". Pas miratimit të këtij vendimi, norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes bëhet 4,00%, nga 4.25% që ishte, duke u ulur kështu me 0.25 pikë përqindje. Ky vendim synon të krijojë kushte të përshtatshme monetare për përmbushjen e objektivit të inflacionit në afat të mesëm dhe të ofrojë mbështetjen e duhur për stimulimin e kërkesës agregate.

Në datën 31.10.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 61 "Raportin e politikës monetare për tremujorin e tretë të vitit 2012". Sipas vlerësimeve të reflektuara në raport, pavarësisht ndikimit negativ të ambientit në ritmet e rritjes ekonomike, stabiliteti financiar dhe makroekonomik i vendit rezultoi i qëndrueshëm. Inflacioni mesatar vjetor i çmimeve të konsumit rezultoi 2.7% në tremujorin e tretë të vitit, duke shënuar një rritje graduale gjatë vitit. Ekspansioni i mjeteve monetare ka shfaqur shenja ngadalësimi gjatë tremujorit të tretë, si pasojë e reduktimit të kërkesës së brendshme për para. Në një situatë të tillë ekonomike të ngadalësuar, politika monetare thelloi natyrën e saj stimuluese në tremujorin e tretë, duke e ulur normën e interesit me 0.25 pikë përqindje, në nivelin minimal historik prej 4.0%. Bazuar në ecurinë e deritanishme të faktorëve përcaktues

të inflacionit, me një probabilitet prej 90%, inflacioni pritet të luhatet në intervalin 1.2% – 3.4% pas 12 muajsh.

## MBIKËQYRJA BANKARE

Në datën 28.08.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 51 "Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin e 100% të pjesëmarrjes influencuese në kapitalin aksioner të Bankës Emporiki sh.a, nga IUB Holding S.A". Me këtë vendim, IUB Holding S.A. i jepet miratimi paraprak për zotërimin e 100% të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit aksioner të Bankës Emporiki sh.a.

Në datën 12.09.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 55 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre". Ndryshimet e miratuara me këtë vendim prekin ato nene të rregullores që rregullojnë procedurat që duhen ndjekur për miratimin apo refuzimin e kërkesës për licencë, pezullimin dhe revokimin e licencës, si dhe bashkimin e shoqërive të licencuara të kursim-kreditit.

Në datën 12.09.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 54 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare". Ndryshimet e parashikuara në këtë vendim, prekin një sërë pikash të paraqitura në shtojcat 1, 2, 3 dhe 4, bashkëngjitur rregullores në fjalë. Ato kanë të bëjnë kryesisht me palët që duhet të njoftohen në lidhje me vendime të ndryshme që merren në përmbushje të funksionit mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

## EMISIONI

Në datën 28.08.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 52 "Për shtypjen e monedhave metalike për qëllime numizmatike, në vitin 2013". Sipas këtij vendimi, në vitin 2013 do të shtypen monedha metalike për qëllime numizmatike, pa kurs ligjor, me tematikën "135-vjetori i Lidhjes së Prizrenit (1878-2013)" dhe "105-vjetori i Kongresit të Manastirit (1908-2013)". Për secilën tematikë parashikohet të shtypen monedha metalike me vlerë nominale 100 dhe 50 lekë, në metalet argjend dhe metal i thjeshtë.

Në datën 14.11.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 63 rregulloren "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i parimeve dhe rregullave bazë për një drejtim efektiv të bankave dhe degëve të bankave të huaja, si dhe përcaktimi i kërkesave për një sistem efektiv të administrimit të rrezikut përfshirë edhe rrezikun e përputhshmërisë. Përmes neneve të saj, synohet gjithashtu të përcaktohen kriteret që duhet të përmbushin administratorët e

bankave dhe degëve të bankave të huaja, si dhe dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e tyre nga Banka e Shqipërisë.

Në datën 27.11.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 67 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a". Sipas këtij vendimi, Bankës Intesa Sanpaolo sh.a. i jepet miratimi paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë të shërbimit të kasave të sigurimit.

Në datën 17.10.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 59 "Për ekspozimin e monedhave me metal të çmuar në ekspozitat që organizon Banka e Shqipërisë". Me miratimin e këtij vendimi sigurohet ekspozimi i monedhave prej ari dhe argjendi nga fondi numizmatik, në ekspozitat që do të organizojë Banka e Shqipërisë në qytetet Tiranë dhe Vlorë, në kuadrin e festimeve për 100-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë.

## STABILITETI FINANCIAR

Në datën 12.09.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 53 "Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012". Sipas këtij raporti, gjatë periudhës në analizë, gjendja dhe ecuria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar në përgjithësi u paraqit e qëndrueshme. Pavarësisht mjedisit tepër sfidues, sektori bankar ka gjeneruar fitim dhe treguesit e kapitalizimit e të likuiditetit të veprimtarisë vlerësohen në nivele të mira. Sistemi financiar zgjeroi më tej veprimtarinë e tij, ndonëse me ritme të ngadalësuara. Gjithashtu, vlerësohet se rreziku i drejtpërdrejtë dhe ai i tërthortë i kreditit përfaqësojnë rreziqet kryesore për sistemin bankar. Kështu, duke patur parasysh që cilësia e kredisë tregon ritme rënëse si për kredinë në lekë, ashtu dhe për atë në valutë, Banka e Shqipërisë nxit bashkëpunimin mes autoriteteve publike dhe sektorit bankar, për të ndërmarrë masa që ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të këtij problemi.

## OPERACIONET MONETARE

Në datën 27.11.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 68 udhëzimin "Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore". Nëpërmjet miratimit të këtij udhëzimi synohet të përcaktohen qartë rregullat dhe procedurat që lidhen me mënyrën dhe formën e raportimit që kryejnë subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, në lidhje me veprimet e tyre valutore.

## STRATEGJIA AFATMESME

Në datën 12.12.2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 69 "Strategjinë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015". Në këtë dokument pasqyrohen sfidat

kryesore me të cilat institucioni pritet të përballet gjatë periudhës trevjeçare në vijim. Strategjia afatmesme ka për qëllim të ofrojë një përgjigje proaktive ndaj sfidave në mjedisin në të cilin operon banka qendrore; të promovojë bashkëpunimin brenda institucionit; të nxisë përdorimin eficient të burimeve; si dhe të promovojë llogaridhënien e Bankës.

## POLITIKA EKONOMIKE

Në datën 04.07.2012, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 423 "Projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm, 2013-2015". Ky dokument përbën finalizimin e fazës së parë të procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore për periudhën në fjalë. Ai është një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent thelbësor i sistemit të planifikimit të integruar. Në të paraqiten në mënyrë të detajuar qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të secilës prej ministrive të linjës.

Në datën 11.07.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 442 "Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 011576 të Fondit Suedez të Mirëbesimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBDR), që vepron si administratore e fondeve të siguruara nga Suedia, për të financuar projektin e përmirësimit të administrimit të burimeve natyrore". Në përmbajtje të marrëveshjes së miratuar me këtë vendim, parashikohet që Suedia të vërë në dispozicion të palës shqiptare një fond me vlerë jo më të madhe se 2 716 027.50 USD. Objektivi i projektit është dhënia e mbështetjes së vazhdueshme për administrimin e përmirësuar, të burimeve natyrore në zonat e larta dhe malore me tendencë erozioni, përmes investimeve dhe planifikimit të shërbimeve mjedisore.

Në datën 11.07.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 445 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi". Me miratimin e këtij vendimi, paga minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person fizik apo juridik, bëhet 21 000 lekë. Ajo jepet për 174 orë pune në muaj dhe paga minimale orare është 121 lekë.

Në datën 10.07.2012, Këshilli i Ministrave miratoi udhëzimin nr. 1 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara". Ky udhëzim përcakton procedurat që duhet të ndiqen dhe autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e procesit të dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara. Tokat që i përkasin kësaj kategorie janë ato toka të regjistruara në regjistrat kadastralë si toka bujqësore dhe që kanë qenë në përbërje të ish-kooperativave bujqësore e nuk janë ndarë ende; si dhe sipërfaqet e tokave në pronësi të komunave dhe bashkive, të regjistruara në kategorinë e resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë e livadh, dhe sipërfaqet e tokave të pafrytshme.

Në datën 18.07.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 465 "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm". Me anë të këtij vendimi, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohen të përcaktojnë të paktën një objektiv të politikës gjinore në kërkesat e programit buxhetor afatmesëm 2013-2015. Gjithashtu, duke filluar nga viti 2013, në procesin e buxhetimit gjinor do të përfshihen të gjitha ministritë e linjës. Prej tyre pritet të vendosin tregues të përshtatshëm dhe të matshëm gjinorë për objektivat e secilit program, për të cilin do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim.

Në datën 18.07.2012, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 468 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së San Marinos, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve". Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, dy shtetet synojnë të zgjerojnë bashkëpunimin ekonomik, mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë, duke krijuar kushte të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e secilës palë në territorin e palës tjetër. Kjo marrëveshje gjen zbatim për të gjitha investimet e bëra nga investitorët e çdo pale, qofshin ato ekzistuese ose të bëra pas datës së hyrjes së saj në fuqi.

Në datën 25.07.2012, Ministria e Financave miratoi udhëzimin nr. 16 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 5, datë 30.6.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar". Shtesat dhe ndryshimet e parashikuara në këtë udhëzim prekin pikat dhe nenet, që rregullojnë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave dhe të dhënat që duhet të përmbajë ajo, të dhënat për të ardhurat bruto, mbajtjen e dokumentacionit, shkallën tatimore, tatimin që do të paguhet etj.

Në datën 25.07.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 476, "Për një ndryshim në vendimin nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", të ndryshuar". Nëpërmjet këtij ndryshimi që i bëhet vendimit të mëparshëm, kërkohet nga subjektet që janë të detyruara të deklarojnë dhe të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të dorëzojnë në organet tatimore, brenda afateve ligjore dhe në formë shkresore, listë-pagesat dhe të dhënat për ndryshimin e numrit të punonjësve për të gjitha periudhat tatimore të vitit 2012.

Në datën 26.07.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 78/2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8873, datë 29.3.2002 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar". Ndryshimet dhe shtesat e parashikuara me këtë ligj, kanë të bëjnë kryesisht me ato nene që rregullojnë Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, fondin themeltar të saj, qëllimin e përdorimit të mjeteve financiare dhe administrimin e tyre, si dhe kontabilizimin e kontributeve dhe të primeve.

Në datën 01.08.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 544 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 60, datë 18.1.2012 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2013-2015". Sipas ndryshimeve të miratuara me këtë vendim, norma e inflacionit mesatar pritet të jetë 3%, gjatë periudhës 2013-2015. Rritja reale e PBB-së

parashikohet të jetë 3% për vitin 2012, duke u rritur nga 4% në 2013 deri në 4.5% në fund të periudhës në fjalë. Ndërkohë që nivelet e papunësisë priten të ulen nga 13.5% në 2012, në 10.9% në vitin 2015.

Në datën 22.08.2012, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 567 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunim ekonomik". Dy shtetet nënshkruese të marrëveshjes synojnë të forcojnë marrëdhëniet e tyre miqësore dhe të zhvillojnë bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik ndërmjet tyre, mbi bazën e barazisë dhe përfitimit reciprok. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët angazhohen të intensifikojnë bashkëpunimin në sektorin e tregtisë, industrisë, bujqësisë, transportit, turizmit etj.

Në datën 29.08.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 570 "Për miratimin e raportit vjetor "Për ndihmat shtetërore të vitit 2011"". Në këtë raport paraqitet informacion i detajuar mbi shpenzimet nga ana e dhënësve të ndihmës, si dhe progresi i arritur në aktivitetin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe të strukturës shtetërore lidhur me kontrollin e ndihmës shtetërore në Shqipëri. Në të reflektohen të dhëna të plota lidhur me dhënësin, përfituesin dhe vlerën totale të ndihmës për sektorë të ndryshëm, duke përjashtuar sektorin e peshkimit, i cili është jashtë fushës së zbatimit të ligjit të ndihmës shtetërore.

Në datën 05.09.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 612 "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për akcizat"". Nëpërmjet neneve dhe paragrafëve të këtij vendimi, përcaktohen në mënyrë të detajuar përkufizimet; përfaqësuesit fiskalë dhe roli i tyre; deklarimi dhe pagesa e akcizës; kushtet dhe procedurat për përjashtimin nga ky detyrim; rastet kur zbatohet rimbursimi për produkte të ndryshme dhe menaxhimi i kërkesave etj.

Në datën 05.09.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 589 "Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2012". Në këtë vendim, përcaktohen një sërë masash që duhet të ndërmerren që shpenzimet buxhetore të përdoren në mënyrë të disiplinuar. Kështu, ndër të tjera, në vendim parashikohet që çdo funksion në njësitë e qeverisjes, i miratuar në organikë dhe i paplotësuar ende, të ngrijë deri në fund të vitit. Ndërsa trajnimet jashtë vendit për nëpunësit, të parashikuara për t'u mbuluar nga fondet buxhetore, bllokohen.

Në datën 18.09.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 84/2012 "Marrëveshjen e huasë ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBDR) për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale". Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, IBDR-ja bie dakord t'i akordojë vendit tonë shumën prej 38 000 000 eurosh, për të ndihmuar në financimin e projektit. Objektivi i këtij projekti është të mbështesë zbatimin e reformave për përmirësimin e barazisë dhe efikasitetit të programeve të ndihmës sociale.

Në datën 26.09.2012, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 658 "Metodologjinë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë". Objekti i kësaj metodologjie është përcaktimi i metodave, rregullave dhe procedurave për përllogaritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme. Qëllimi i këtij dokumenti është garantimi dhe zgjedhja e drejtë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme për efekt të kompensimit të pronave ose gjatë proceseve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme në tërësi.

Në datën 11.10.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 94/2012 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Maqedonisë, lidhur me shlyerjen e shumave në llogarinë e shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë". Sipas kësaj marrëveshje, shuma përfundimtare e shlyerjes ndërmjet dy vendeve, duke përfshirë interesin e zakonshëm, arrin në 1 788 478.82 dollarë amerikanë.

Në datën 17.10.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 706 "Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për bashkëpunim ekonomik". Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, dy shtetet angazhohen të kontribuojnë në zhvillimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik me fitim reciprok. Kështu, palët do të bëjnë përpjekje për rritje të bashkëpunimit ekonomik në fusha të tilla si industria, bujqësia, pylltaria, transporti, telekomunikacioni etj.

Në datën 18.10.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me ligjin nr. 98/2012 "Buxhetin faktik të Shtetit për vitin 2011". Me këtë ligj miratohet buxheti faktik i vitit 2011 së bashku me burimet e tij financiare. Kështu, ndër të tjera, në ligj, të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin në fjalë përcaktohen në nivelin 275 479 000 000 lekë, ndërsa shpenzimet në nivelin 309 297 000 000 lekë.

Në datën 08.11.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 105/2012 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)". Pas miratimit të këtij ligji, Republika e Shqipërisë aderon në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së FMN-së, në lidhje me reformën e bordit ekzekutiv, si dhe pranon rritjen e kuotave të anëtarësimit në të.

Në datën 15.11.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 110/2012 "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare". Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve, procedurave dhe pasojave juridike të një bashkimi ndërkufitar ndërmjet shoqërive shqiptare dhe atyre evropiane, si dhe parashikimi i masave mbrojtëse për punëmarrësit dhe kreditorët e këtyre shoqërive. Ky ligj nuk zbatohet për bashkimet ndërkufitare që përfshijnë shoqëri objekti i aktivitetit të të cilave është investimi kolektiv i kapitalit të dhënë nga publiku, që veprojnë në bazë të parimit të shpërndarjes së rrezikut dhe titujt e të cilave riblihen ose shlyhen nëpërmjet aktiveve të kësaj shoqërie.

Në datën 15.11.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". Nëpërmjet miratimit të këtij ligji synohet të mbrohet dhe të përmirësohet mjedisi ujor, si dhe të shfrytëzohen në mënyrë racionale burimet ujore të domosdoshme për jetën dhe zhvillimin social e ekonomik të vendit. Ky ligj përcakton kuadrin institucional, në nivel kombëtar dhe vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe në përputhje me interesat e vendit.

Në datën 16.11.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 777 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 693, datë 10.10.2012 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e garancisë qeveritare, që lëshohet në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania dhe Intesa Sanpaolo sh.a., Albania, në kuadër të kontratave përkatëse ndërmjet këtyre bankave dhe KESH sh.a."". Nëpërmjet ndryshimit në vendim, miratohet garancia qeveritare, që lëshohet në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania, në kuadër të kontratës së huasë ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a., për shumën ekuivalente në lekë, të shumës 50 000 000 euro.

Në datën 12.12.2012, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr. 6 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin në vitin 2012". Këto ndryshime, ndër të tjera, përcaktojnë që të ardhurat e buxhetit për vitin 2012 janë 332 758 000 000 lekë, ndërsa shpenzimet janë 382 296 000 000 lekë. Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 49 538 000 000 lekë, nga i cili 900 000 000 lekë do të financohen nga të ardhurat e privatizimit.

Në datën 12.12.2012, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 898 "Protokollin e bisedimeve, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim ekonomik për zhvillim, për vitin 2012". Qëllimi i këtij bashkëpunimi është që prej tij të mund të përfitojë e gjithë popullata shqiptare, të nxitë bashkëpunimin rajonal dhe të mbështesë Shqipërinë në procesin e afrimit të mëtejshëm me Bashkimin Evropian. Kështu, Qeveria e Republikës Federale Gjermane angazhohet që për periudhën 2012-2013 të vërë në dispozicion të Republikë së Shqipërisë një shumë të re prej 31 100 000 eurosh për bashkëpunimin teknik e financiar.

Në datën 17.12.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013". Sipas këtij ligji, të ardhurat e buxhetit për vitin 2013 parashikohen të jenë 360 661 000 000 lekë, ndërsa shpenzimet 409 594 000 000 lekë. Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 48 933 000 000 lekë, nga i cili 500 000 000 lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit.

Në datën 19.12.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 874 "Për dhënien e asistencës ekonomike të menjëhershme, personave që përfitojnë pension". Në këtë vendim parashikohet dhënia e asistencës ekonomike të menjëhershme, në shumën 2 000 lekë të patatueshme për kategoritë e ndryshme të qytetarëve që përfitojnë pension. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 170 000 000 lekë, përballohen nga

buxheti i vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Në datën 20.12.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 122/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar". Ndryshimet e parashikuara në këtë ligj, prekin një sërë nenesh të ligjit ekzistues. Kështu, ndryshime pësojnë nenet që rregullojnë të ardhurat e përjashtuara, shpenzimet e njohura, mbartjen e humbjes, si dhe dispozitat kalimtare.

Në datën 25.12.2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 125/2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar". Ndryshimet që i bëhen ligjit ekzistues prekin nenet që rregullojnë importin e mallrave dhe furnizimet e përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Ligjit i shtohet gjithashtu, edhe një nen që përcakton rastet kur hekuri dhe çimentoja konsiderohen si mallra të përjashtuara.

# DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË, 31 DHJETOR 2012

## KËSHILLI MBIKËQYRËS

| | |
|---|---|
| ARDIAN FULLANI | Kryetar |
| ELISABETA GJONI | Zëvendëskryetare |
| ADRIAN CIVICI | Anëtar |
| ARJAN KADAREJA | Anëtar |
| DHORI KULE | Anëtar |
| ELA GOLEMI | Anëtare |
| ERMELINDA MEKSI | Anëtare |
| HALIT XHAFA | Anëtar |
| PETRAQ MILO | Anëtar |

## GUVERNATORI

ARDIAN FULLANI

## ZËVENDËSGUVERNATORËT

ELISABETA GJONI — Zëvendësguvernator i Parë

## INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

ELIVAR GOLEMI

## KABINETI I GUVERNATORIT

GENC MAMANI

## DREJTUES PËR KOORDINIMIN PRANË KABINETIT TË GUVERNATORIT

GRAMOZ KOLASI

## DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

| | |
|---|---|
| *DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE* | *Roden Pajaj* |
| *DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE* | *Erald Themeli* |
| *DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE* | *Altin Tanku* |
| *DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE* | *Marjan Gjermeni* |
| *DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES* | *Indrit Banka* |
| *DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR* | *Klodion Shehu* |
| *DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT* | *Xhilda Deliana* |
| *DEPARTAMENTI I STATISTIKËS* | *Diana Shtylla* |
| *DEPARTAMENTI I EMISIONIT* | *Dorian Çollaku* |
| *DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE FINANCËS* | *Fatos Ibrahimi* |
| *DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE* | *Dashmir Halilaj* |
| *DEPARTAMENTI JURIDIK* | *Altin Naqe* |
| *DEPARTAMENTI I KONTROLLIT* | *Elivar Golemi* |
| *DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE I KOMUNIKIMIT* | *Oneda Andoni* |
| *DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT* | *Agron Skënderaga* |
| *DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES* | *Eduard Sinani* |

## DEGËT

| | |
|---|---|
| *Shkodër* | *Ermira Istrefi* |
| *Elbasan* | *Valentina Dedja* |
| *Gjirokastër* | *Anila Thomaj* |
| *Korçë* | *Liljana Zjarri* |
| *Lushnje* | *Shpresa Meço* |

# BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË, DERI NË 30 QERSHOR 2012

*1. BANKA RAIFFEISEN SH.A.*
*Licenca Nr. 2/1998, datë 11.01.1999.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998.*
*Certifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Christian CANACARIS*
*Adresa:* *Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Tregtare Evropiane, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2274 910*
*Faks:* *+355 4 2275 599*
*E – mail:* *info@raiffeisen.al*
*Website:* *www.raiffeisen.al*

*2. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.*
*Licenca Nr. 3/1998, datë 11.01.1999.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998.*
*Certifikata nr. 3 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Hikmet GÜLER*
*Adresa:* *Rruga e Durrësit, sheshi tek Zogu i Zi, Godina Teknoprojekt, P.O. BOX 128, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 240 45 75 / 76 / 77*
*Faks:* *+355 4 240 45 58*
*E- mail:* *info@ubaal.com*
*Website:* *www.uba.com.al*

*3. VENETO BANKA SH.A.*
*Licenca Nr. 5/1998, datë 11.01.1999.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 11.12.1998.*
*Certifikata nr.4 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Lucio Luigi GAITA*
*Adresa:* *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Ndërtesa Kullat Binjake, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2280 555*
*Faks:* *+355 4 2280 356*
*E – mail:* *info@venetobanka.al*
*Website:* *www.venetobanka.al*

*4. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.*
*Licenca Nr. 6/1998, datë 11.01.1999.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999.*
*Certifikata nr.5 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Seyhan PENCABLIGIL*
*Adresa:* *Bulevardi "Zhan Dark" Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2250 955*
*Faks:* *+355 4 2250 956*

*E – mail:* *info@bkt.com.al*
*Website:* *www.bkt.com.al*

*5. BANKA TIRANA SH.A.*
*Licenca Nr. 07,datë 12.09.1996.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996.*
*Certifikata nr.6 "Për sigurimin e depozitave".*
*Zv.Drejtori:* *Bedri ÇOLLAKU*
*Adresa:* *Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2269 616 / 7 / 8, 2233 441*
*Faks:* *+355 4 2233 417 / 2369 707*
*E – mail:* *info@tiranabank.al*
*Website:* *www.tiranabank.al*

*6. BANKA NBG ALBANIA SH.A*
*Licenca Nr. 08, datë 25.11.1996.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4. datë 14.03.1996.*
*Certifikata nr.7 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Ioannis KOUGIONAS*
*Adresa:* *Rruga e Durrësit, Godina Comfort, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2274 802 / 2274 822*
*Faks:* *+355 4 2233 613*
*E – mail:* *nbgalbania@icc-al.org*

*7. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.*
*Licenca Nr.09, datë 20.02.1997.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 30.04.1996.*
*Certifikata nr.8 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Gideon van den BROEK*
*Adresa:* *Qendra e Biznesit, Rruga "Murat Toptani", Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2254 372 / 2256 254*
*Tel/faks:* *+355 4 2254 368*
*E – mail:* *info@icbank-albania.com*

*8. BANKA ALPHA ALBANIA SH.A.*
*Licenca Nr.10, datë 07.01.1998.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.01/03/96, datë 27.12.1997.*
*Certifikata nr.9 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Periklis DROUGKAS*
*Adresa:* *Rruga e Kavajës, G – KAM Business Center, kati II, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2278 500*
*Tel/faks:* *+355 4 2232 102*
*E – mail:* *tiranabranch@alpha.gr*

*9. BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.*
*Licenca Nr.11, datë 10.08.1998.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 10.08.1998.*
*Certifikata nr.10 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Alexander RESCH*
*Adresa:* *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27, P.O. BOX 8319, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2248 753 / 4 / 5 / 6, 2276 000.*

*Faks:* *+355 4 2248 762*
*E – mail:* *info@intesasanpaolobank.al*
*Website:* *www.intesasanpaolobank.al*

*10. BANKA PROCREDIT SH.A.*
*Licenca Nr. 12, datë 15.03.1999.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 03.03.1999.*
*Certifikata nr.11 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Flutura VEIPI*
*Adresa:* *Rruga "Dritan Hoxha", Nr. 92, H. 15, Njësia Bashkiake nr. 11, Kodi Postar 1026 , Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2 389 300*
*Faks:* *+355 4 2 233 918*
*E mail:* *info@procreditbank.com.al*
*Website:* *www.procreditbank.com.al*

*11. BANKA CREDIT AGRICOLE SHQIPËRI SH.A.*
*Licenca Nr. 14, datë 28.10.1999.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.*
*Certifikata nr.13 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Luc BEISO*
*Adresa:* *Rruga e Kavajës, nr. 59, "Tirana Tower", Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2258 755 / 56 / 57 / 58 / 59 / 60*
*Faks:* *+355 4 2258 752*
*E – mail:* *headoffice@emporiki.com.al*
*Website:* *www.emporiki.com.al*

*12. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.*
*Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 28. 08. 2002.*
*Certifikata nr.14 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Sherine KAMEL*
*Adresa:* *Rruga "Perlat Rexhepi", Al-Kharafi Group Administration Building, Kati 1&2, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2272 168, 2272 162*
*Faks:* *+355 4 2272 162*
*E-mail:* *creditbkalb@icc-al.org*

*13. BANKA CREDINS SH.A.*
*Licenca nr. 16, datë 31.3.2003.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 26.03.2003.*
*Certifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Artan SANTO*
*Adresa:* *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2234 096.*
*Faks:* *+355 4 2222 916*
*E –mail:* *info@bankacredins.com*
*Website:* *www.bankacredins.com*

*14. BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.*
*Licenca nr. 17, datë 16.02.2004.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 06, datë 11.02.2004.*

*Certifikata nr. 16 " Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori: Hubert de SAINT JEAN*
*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 9-të, Tiranë.*
*Telefon: +355 4 2280 442 / 3*
*Faks: +355 4 2280 441*
*E-mail: info@societegenerale.al*
*Web site: www.societegenerale.al*

*15. BANKA UNION SH.A.*
*Licenca nr. 18, datë 09.01.2006.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 101, datë 28.12.2005.*
*Certifikata nr. 17 " Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori: Gazmend KADRIU*
*Adresa: Bulevardi "Zogu I", pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë.*
*Telefon: +355 4 2250 653 / 2258 081*
*Faks: +355 4 2272 880*
*E – mail: info@unionbank.com.al*
*Website: www.unionbank.com.al*

*16. BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.*
*Licenca nr. 19, datë 06.07.2007*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 35, datë 27.06.2007.*
*Certifikata nr. 12 " Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori: Bozhidar TODOROV*
*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14&15, Tiranë.*
*Telefon: +355 4 2276 702 / 3*
*Faks: +355 4 2280 210*
*website: www.fibank.al*

*Përveç bankave dhe degëve të bankave të huaja, Banka e Shqipërisë ka licencuar deri më 31 Dhjetor 2012 edhe subjektet e mëposhtme:*

| Nr. | Subjekte |
|---|---|
| 21 | SUBJEKTE JOBANKA |
| 322 | ZYRA TË KËMBIMIT VALUTOR |
| 2 | UNIONE TË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT |
| 126 | SHOQËRI TË KURSIM-KREDITIT |
| 1 | ZYRË E PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA |

# PUBLIKIME TË BOTUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË GJATË GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2012

Kjo listë përpilohet për të informuar lexuesit mbi botimet e Bankës së Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2012. Duke vizituar faqen tonë zyrtare të internetit(www.bankofalbania.org) mund të plotësoni e dërgoni formularin në public@bankofalbania.org ose në faks + 355 4 2419408 dhe të regjistroheni për t'u bërë pjesë e listës së shpërndarjes së botimeve të Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, ju mund të përfitoni nga shërbimi i njoftimeve automatike të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet këtij shërbimi, çdo mesnatë, sistemet e Bankës do t'ju njoftojnë në postën tuaj elektronike rreth ndryshimeve apo të rejave në argumentet që keni përzgjedhur.

Më poshtë mund të gjeni titujt e publikimeve të Bankës së Shqipërisë të botuara gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2012. Kjo listë nuk përfshin vrojtimet e kryera nga Banka e Shqipërisë, të cilat publikohen vetëm në formë elektronike (http://www.bankofalbania.org/web/vrojtime_3405_1.php).

## RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR:

Raporti i Stabilitetit Financiar, Gjashtëmujori i parë 2012

## RAPORTET PERIODIKE TË POLITIKËS MONETARE:

Raporti i politikës monetare për tremujorin e dytë 2012
Raporti i politikës monetare për tremujorin e tretë 2012
Raporti i politikës monetare për tremujorin e katërt 2012

## BOTIME PËR STATISTIKAT:

Raporti Mujor Statistikor (Botohet çdo muaj të vitit).

## BULETINI ZYRTAR:

Buletini Zyrtar – Vëllimi 14, nr. 6
Buletini Zyrtar – Vëllimi 14, nr. 7
Buletini Zyrtar – Vëllimi 14, nr. 8
Buletini Zyrtar – Vëllimi 14, nr. 9
Buletini Zyrtar – Vëllimi 14, nr. 10
Buletini Zyrtar – Vëllimi 14, nr. 11
Buletini Zyrtar – Vëllimi 14, nr. 12

## BULETINI I BANKËS SË SHQIPËRISË:

Buletini i Bankës së Shqipërisë - Gjashtëmujori i dytë 2012

## MATERIALE DISKUTIMI:

Hulumtimi empirik i pasigurisë së parashikimit me simulimin Monte Carlo.
- Altin Tanku, Elona Dushku, Kliti Ceca

Vlerësimi i performancës parashikuese: Pasiguritë në parashikimin e inflacionit
- Evelina Çeliku, Gent Hashorva

Niveli optimal i rezervave valutore - Një vlerësim empirik në rastin e Shqipërisë
- Gerti Shijaku

Kursi ekuilibër i këmbimit në një ekonomi në zhvillim - Bledar Hoda

Qëndrueshmëria e politikës fiskale: Rasti i Shqipërisë - Gerti Shijaku

Marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe integrimi tregtar midis vendeve të Evropës Juglindore: Vlerësime të modelit të Gravitetit - Alban Pllaha (19 korrik)

Sjellja e kreditimit në Shqipëri: Një shenjë konvergjence apo devijim nga tendenca e vet afatgjatë? - Irini Kalluci

Një model për rrezikun e kredisë në Shqipëri duke përdorur të dhënat e bankave - Hilda Shijaku, Kliti Ceca

## TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË:

Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë, Nr.8
Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë, Nr.9

## BOTIME TË TJERA:

Broshura"Si dizenjohet një monedhë shqiptare?!"
Broshura"Si prodhohet një monedhë shqiptare?"
Libri "Financat personale në duart tuaja"
Libri i ushtrimeve "Financat personale në duart tuaja"
Fletëpalosje informative mbi monedhën numizmatike "Kodiku i purpurtë i Beratit - Beratinus 1"
Fletëpalosje informative mbi monedhat numizmatike "100 vjetori i shpalljes së Pavarësisë"